

PROGRAMI POLITIK  
**2020 - 2024**

---

SHTET për  
të GJITHË

# SHTET PËR TË GJITHË

PROGRAMI ZGJEDHOR 2020-2024

I KOALICIONIT

**ALEANCA PËR SHQIPTARËT & ALTERNATIVA**

**Tash**<sup>🕒</sup>  
*është Koha!*

# Përmbajtja

<b>SHTET PËR TË GJITHË</b> .....	<b>6</b>
<b>PËR BARAZINË E PLOTË</b> .....	<b>10</b>
Ligji për përfaqësim të drejtë dhe adekuat .....	14
Eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit .....	15
Zyrtarizimi i plotë i gjuhës shqipe .....	17
Avancimi i kulturës shqiptare si dhe i të gjitha bashkësive tjera .....	18
<b>PËR SHTETIN E SË DREJTËS</b> .....	<b>25</b>
Një mision këshillimor dhe monitorues europian për shtetin e së drejtës .....	26
Një gjyqësor i pavarur, efikas dhe i drejtë.....	27
Çrrënjësia e korrupsionit .....	30
Një administratë publike e depolitizuar, meritokratike dhe efikase.....	34
Qytetarë të mirinformuar dhe të inkurajuar për debate publike .....	37
<b>PËR SHTET QË KULTIVON DHE RUAN KAPITALIN NJERËZOR</b> .....	<b>39</b>
<b>Arsim cilësor, i arritshëm dhe në përputhje me nevojat e tregut</b> .....	<b>41</b>
Përmirësimi i mundësisë për arsim cilësor për të gjithë. ....	43
Avancimi i mësimin në distancë në një sistem të integruar arsimor .....	46
Forcimi i qeverisjes në sistem arsimor .....	52
Rritja e përputhshmërisë midis arsimit dhe nevojave të tregut të punës .....	54
<b>Shëndetësia</b> .....	<b>57</b>
Masat për përballjen me pandeminë COVID-19 dhe situata te ngjashme .....	59
Reforma për qasje të barabartë dhe cilësi në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor publik .....	59
Më tepër burime njerëzore të kualifikuara dhe përfaqësuese.....	60
Një infrastrukturë shëndetësore që u përgjigjet nevojave të pacientit. ....	62
Financimi i sistemit në përputhje me nevojat e pacientit dhe masa shtesë për një sistem më të drejtë dhe efektiv .....	63
<b>Një politikë bashkëkohore e punës dhe e çështjeve sociale</b> .....	<b>64</b>
<b>Barazia gjinore</b> .....	<b>66</b>
<b>Fuqizimi i të rinjve</b> .....	<b>67</b>
<b>PËR ZHVILLIM TË BARABARTË EKONOMIK DHE TERRITORIAL</b> .....	<b>70</b>
Për një politikë buxhetore zhvillimore.....	74
Forcimi i ndërmarrësisë.....	78
Lehtësira tatimore .....	78
Përkrahja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme .....	79
Decentralizimi fiskal funksional.....	82
Zhvillimi i barabartë rajonal.....	84
Nxitja e investimeve të huaja dhe nga mërgata .....	86
Ndërmarrje publike fitimprurëse .....	88
<b>PËR SHTET ZHVILLIMOR TË GJELBËR DHE TË DIGJITALIZUAR</b> .....	<b>91</b>
Adresimi i menjëhershëm i emergjencës mjedisore .....	92
Bujqësia dhe zhvillimi rural - sektorë themelorë të zhvillimit ekonomik dhe territorial .....	95
<b>Infrastrukturë cilësore për të gjithë</b> .....	<b>98</b>
Rritja e konektivitetit rrugor të brendshëm dhe rajonal.....	99
Avancimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale .....	100
Një energji e ripërtëritshme dhe përballueshme për qytetarin.....	102
<b>E-Qeverisja</b> .....	<b>103</b>
<b>PËR SHTET TË INTEGRUAR NË RAJON, EUROPË DHE BOTË</b> .....	<b>109</b>
Komunikimi strategjik rreth përfitimeve dhe detyrimeve të anëtarësimit.....	112
Një plan veprimi për ta përsheptuar integrimin europian.....	112
<b>Integrimi europian në mbështetje të zhvillimit socio-ekonomik dhe territorial barazitar</b> .....	<b>112</b>
<b>Marrëdhënie të mira fqinjësore dhe bashkëpunim rajonal</b> .....	<b>113</b>
Një politikë të jashtme pro-europiane .....	114
Një politikë e jashtme në funksion të integritetit të mërgatës në shtet .....	114
Shteti që prodhon paqe dhe siguri .....	115

# SHTET PËR TË GJITHË

## Deklarata politike e Koalicionit “Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA”

Po bëhen gati tridhjetë vjet që Maqedonia e Veriut, si shtet i pavarur, nuk ka arritur të bëhet shtet i barabartë dhe i drejtë për të gjithë qytetarët e saj. Në vend të kohezionit brendashoqëror, shteti vazhdon të kultivojë diskriminim strukturor ndaj shqiptarëve dhe disa bashkësive të tjera, duke i kufizuar mundësitë e barabarta dhe duke ushqyer pabarazinë në të gjitha fushat e jetës publike. Për fat të keq, pjesa dërrmuese e shqiptarëve vazhdojnë të ndjehen të diskriminuar për shkak të përkatësisë së tyre etnike, kjo edhe përkundër retorikës pa përmbajtje të viteve të fundit për “një shoqëri për të gjithë”.

Duke ndjerë diskriminimin sistematik dhe nevojën e kthimit të mirëbesimit ndaj shtetit dhe ndërtimin e shtetit të barabartë ndaj të gjithëve, si dhe duke besuar se shteti është i të gjithëve dhe, ashtu siç i kryejnë detyrimet ndaj tij, duhet t'i gëzojnë edhe të mirat e tij, partitë politike Aleanca për Shqiptarët dhe AlternAtivA kanë vendosur që t'i bashkojnë forcat e tyre për të ofruar një program inkluziv, përmbajtësor dhe objektivisht të realizueshëm, që përfaqësohet me titullin “Shtet për të gjithë”.



- Programi “Shtet për të gjithë” bazohet në platformat politike të Aleancës për Shqiptarët dhe Alternativës, në qindra dëgjime publike me qytetarë gjatë muajve të fundit në çdo lagje, çdo fshat dhe çdo qytet, si dhe në mijëra kontribute qytetare rreth prioriteteve të qeverisjes së ardhshme, të paraqitura përmes platformës elektronike “E Ardhmja”, si dhe fushatave “Kthehu” dhe “Vatra jonë”, që të gjitha këto të përmbledhura dhe të harmonizuara në një program gjithëpërfshirës dhe konsistent nga ekspertë të fushave përkatëse.
- Programi “Shtet për të gjithë” është sintezë e veprimeve dhe politikave që do të zbatohen nga koalicioni “Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA” gjatë qeverisjes 2020-2024, për të ndërtuar shtet ku të gjithë qytetarët do të ndjehen të barabartë para ligjit, duke i gëzuar të drejtat dhe mundësitë e barabarta, si dhe duke i shijuar të mirat publike të garantuara me Kushtetutë.
- Programi “Shtet për të gjithë” ka për synim kryesor që secilit qytetar t’ia kthejë vetëbesimin dhe dinjitetin, si dhe besimin në Maqedoninë e Veriut si shtet i ri i të gjithë qytetarëve, si shtet modern i mundësive të barabarta dhe i aftë për t’u përballur me sfidat e ekonomisë globale, ndryshimit klimatik dhe tranzicionit teknologjik.
- Programi i koalicionit Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA synon të ndërtojë “shtet për të gjithë”, shtet të bazuar në barazinë e plotë të bashkësive shtetformuese, në të cilin sundon shteti i së drejtës, shtet të prosperitetit dhe zhvillimit të barabartë ekonomik, të integruar në botën shqiptare, në rajon dhe në botë, duke qenë prodhues e jo vetëm konsumues i sigurisë dhe stabilitetit.

- Programi “Shtet për të gjithë” gjykon se kushti themelor i kohezionit social është barazia e plotë e të gjithë qytetarëve, pavarësisht përkatësisë etnike, sociale, religjioze e kulturore.
- Programi “Shtet për të gjithë” është i bindur se çlirimi i shtetit nga kapja, vendosja e shtetit të së drejtës, si dhe lufta kundër korrupsionit dhe të gjitha veseve të tjera shoqërore, janë parakusht për ta materializuar perspektivën europiane të vendit dhe për ta mbajtur rininë tonë në vendlindje.
- Programi “Shtet për të gjithë” synon ndërtimin e shtetit të mirëqenies që kultivon dhe ruan kapitalin njerëzor, si parakusht për një ekonomi konkurruese në Europë dhe në botë.
- Programi “Shtet për të gjithë” synon gjithashtu rimëkëmbjen e plotë ekonomike dhe adresimin e pasojave socio-ekonomike të dala nga pandemia Covid-19 dhe menaxhim i saj katastrofik nga qeveria në ikje.
- Programi “Shtet për të gjithë” mëton arritjen e zhvillimit të barabartë ekonomik, sidomos nëpërmjet zhvillimit të barabartë territorial, që nënkupton rritje ekonomike prej 5%, ulje të papunësisë në 10%, si dhe transformimin e modelit ekonomik të vendit përmes rritjes së investimeve kapitale dhe shpenzimeve produktive.
- Programi “Shtet për të gjithë” insiston në avancimin e shtetit zhvillimor të gjelbër dhe të digjitalizuar, që do ta eliminojë ndotjen e mjedisit jetësor, do të zhvillojë burime alternative dhe të pastra të energjisë dhe do ta përkrahë bujqësinë si sektor themelor të zhvillimit ekonomik dhe territorial.
- Programi “Shtet për të gjithë” angazhohet për shtet të integruar në rajon, në Europë dhe në botë, kjo si alternativa e vetme për të ardhmen e vendit dhe garanci për paqe, siguri, stabilitet dhe integrim të brendshëm.

Koalicioni “Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA” do të jetë garantues i funksionimit të mirë të institucioneve të afta, që këtë vizion ta shndërrojë në veprime konkrete, për t’ia kthyer secilit qytetar dinjitetin e nëpërkëmbur nga shteti.

Falë përkrahjes për programin e koalicionit “Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA”, shteti i kapur dhe diskriminues do t’i takojë historisë, për t’ia lënë vendin “shtetit për të gjithë”.

Tash është koha për ndryshim!

**Aleanca për Shqiptarët**

Ziadin Sela, kryetar

**AlternAtivA**

Afrim Gashi, kryetar

## PËR BARAZINË E PLOTË

Maqedonia e Veriut vazhdon të mbetet e karakterizuar me një diskriminim strukturor dhe të rrënjosur thellë ndaj shqiptarëve dhe disa bashkësive të tjera, i cili kufizon mundësitë e barabarta dhe ushqen pabarazinë në të gjitha fushat e jetës publike ndaj një pjese të konsiderueshme të popullatës së vendit.

Sipas një barometri të OSBE-së për mundësi të barabarta (2019), qytetarët e perceptojnë diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike dhe atë politike si një ndër format më të përhapura të diskriminimit në Maqedoninë e Veriut. Në të vërtetë, diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike perceptohet si më i përhapur nga shqiptarët (63%) sesa maqedonasit (45%) dhe më tepër nga qytetarët që jetojnë në rajonin e Pollogut dhe në verilindje të vendit (nga 59% në 70%) sesa ata që jetojnë në rajonin lindor të vendit (34%).

Edhe më shqetësues është fakti se qytetarët besojnë se, në vend se të ulëj, diskriminimi është bërë më i përhapur në pesë vitet e fundit, kjo në kontrast të rreptë me retorikën boshe të qeverisë në largim për një "shoqëri për të gjithë".

Ky diskriminim strukturor konfirmohet nga shifrat e fundit të përfaqësimit të shqiptarëve në administratën publike dhe në institucionet tjera buxhetore. Sipas raportit vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2018, publikuar në shtator 2019, përfaqësimi i shqiptarëve në sektorin publik është vetëm 19%. Më keq se kaq, për herë të parë që nga miratimi i Marrëveshjes Kornizë së Ohrit, përfaqësimi i shqiptarëve po përballet me një trend në rënie gjatë dy viteve të fundit.

Maqedonasit vazhdojnë të jenë të mbipërfaqësuar në institucionet buxhetore, ndërsa të gjitha bashkësitë e tjera janë të nënpërfaqësuar. Shqiptarët vazhdojnë të qëndrojnë dukshëm të nënpërfaqësuar si në nivel lokal, ashtu edhe në pozicione menaxheriale në të gjitha nivelet, si dhe në shumë ministri, agjenci dhe organe gjyqësore të rëndësishme dhe të ndjeshme, që lidhen drejtpërdrejt me funksionet sovrane të



TË GJITHË  
JEMI  
TË BARABARTË

shtetit, veçanërisht në Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Shoqërisë Informativë dhe Administratës, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave. Për shembull, shqiptarët përbëjnë vetëm 10.9% të të punësuarve në Ministrinë e Financave, ndërsa shumica prej tyre janë në pozita të bashkëpunëtorëve të rinj dhe referentëve dhe pa mundësi avancimi. Shqiptarët mbajnë vetëm 5.9% të pozicioneve menaxheriale edhe në Ministrinë e Shoqërisë Informativë dhe Administratës, krahasuar me 88.2% që u takojnë maqedonasve. Në Ministrinë e Mbrojtjes, nga 15 këshilltarë shtetërorë, vetëm dy janë shqiptarë (13.3%) dhe nga 17 drejtues të sektorëve, vetëm 2 janë shqiptarë (11.8%). Edhe në gjyqësor përfaqësimi i shqiptarëve mbetet larg pritjeve: në disa institucione themelore, siç është Gjykata Supreme, nuk ka asnjë nëpunës shqiptar. As në ndërmarrjet publike gjendja nuk është më e mirë, pasi që deri tani nuk ka pasur vullnet politik që ato të miratojnë politika të përfaqësimit të drejtë.

Veç kësaj, një numër i konsiderueshëm i administratorëve nga bashkësitë jomaqedonase ende nuk janë integruar në institucione, por kanë mbetur për vite të tëra pjesë e një mase brenda ish-Sekretariatit për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë së Ohrit (tash Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie mes Bashkësive), duke qëndruar në shtëpie në pritje të akomodimit në vende të punës në institucionet përkatëse.

Mungesa e theksuar e përfaqësimit

të drejtë nuk është një problem i izoluar dhe pa pasoja. Institucionet të cilat e shkelin këtë rregull kushtetues janë zakonisht po ato që nuk e respektojnë statusin zyrtar të gjuhës shqipe, ndërsa zbatojnë buxhete dhe politika diskriminuese dhe segragacioniste, si edhe shërbime publike të diferencuara në baza gjeografike ose të publikut. Ndërkaq, sa i përket gjyqësorit, drejtësia është selektive – varësisht nga përkatësia kombëtare ose politike e palëve. Gjithë kjo, natyrshëm, ndikon drejtpërdrejt në mungesën e besueshmërisë së institucioneve të shtetit dhe në cenimin e kohezionit social.

Korniza e re ligjore për punësimin e shërbyesve civilë, e miratuar nga qeveria në largim, sjell disa përmirësime metodologjike në lidhje me përfaqësimin e drejtë, por ajo vazhdon t'i ketë disa mangësi dhe nuk zbatohet për të gjitha institucionet, kjo për shkak të konsideratave politike dhe një sërë pengesash ligjore. Për shembull, nuk ka të dhëna të besueshme për përfaqësimin e bashkësive në Ministrinë e Punëve të Brendshme, kjo për shkak të kategorizimit të vendeve të punës të parashikuara në Ligjin për punë të brendshme, i cili mundëson përjashtimin e rregullave për rekrutim dhe promovim të bazuar në merita për nëpunësit e administratës së Ministrisë. Një rrethanë tjetër rënduese, që pamundëson përfaqësim të drejtë dhe adekuat, është Ligji për punonjësit e administratës publike, konkretisht neni 3, paragrafi 3 i ligjit që përcakton se për personelin ushtarak dhe civil të Armatës të Maqedonisë së Veriut zyrtarë të autorizuar në Ministrinë e Mbrojtjes,

Ministrinë e Brendshme dhe në organet e administratës shtetërore të Ministrisë së Brendshme, si dhe në agjencinë e inteligjencës, nuk zbatohen dispozitat që e rregullojnë planifikimin dhe përgatitjen e planeve vjetore të punësimit për përfaqësim të drejtë.

Rregulla të tilla janë antikushtetuese dhe bien ndesh me amendamentin VI të Kushtetutës, i cili parasheh përfaqësimin e drejtë të bashkësive në organet publike në çdo nivel dhe në fushat e tjera të jetës publike. Ato duhet të korrigjohen urgjentisht dhe kjo duhet të bëhet në përputhje me rekomandimet e njëpasnjëshme të BE-së, OSBE-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA vlerëson se Kushtetuta në fuqi është e mangët, e kufizuar dhe në shumë pjesë të saj nuk i përfaqëson realitetet e sotme politike, sociale dhe etnike në vend. Andaj, është bërë i domosdoshëm ndryshimi dhe plotësimi i saj. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA e sheh Kushtetutën si një akt juridik që kërkon ndryshime dhe plotësime të shumta në përputhje me rrethanat politike, në mënyrë që kushtetuta e re ta reflektojë karakterin shumetnik dhe shumëkulturore të shoqërisë dhe shtetit, tolerancën dhe bashkëjetesën. Në këtë drejtim, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA konsideron se një kushtetutë e re demokratike duhet të ridefinojë vendin si shtet të barabartë i dy bashkësive më të mëdha, gjithsesi me të drejta të garantuara edhe përbashkësitë e tjera etnike.

Ridefinimi i shtetit nënkupton që, në kushte të paqes dhe pa presione, të diskutohet për funksionalizimin e shtetit dhe vendosjen e simetrisë mes shtetit dhe shoqërisë, gjithnjë duke pasur parasysh që shoqëria shumetnike të reflektohet edhe në ndërtimin e shtetit shumetnik. Kjo duhet të arrihet përmes dialogut ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve me lehtësim ndërkombëtar dhe me përfshirje edhe të qytetarëve të tjerë të vendit.

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të vazhdojë të angazhohet për Parlament dydhomësh: Dhomën e Bashkësive Etnike dhe Dhomën e Përfaqësuesve, që do të jenë plotësisht të barabarta mes vete në përpilimin e ligjeve dhe në ushtrimin e kompetencave të tjera kushtetuese të Parlamentit.

Në rrafshin e zhvillimit të mëtutjeshëm të sistemit politik të vendit, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të angazhohet që "Tryeza e përbashkët e partive politike shqiptare" të jetë mekanizmi kryesor i ndërtimit të konsensusit brendashqiptar për zbatimin e Deklaratës së përbashkët të partive politike shqiptare (2016).

Gjatë qeverisjes së tij, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do t'i fokusojë përpjekjet e tij në shtet për të gjithë dhe barazi të plotë në fushat prioritare në vijim: përfaqësimi i drejtë dhe adekuat në të gjitha fushat e jetës publike, eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit, zyrtarizimi i plotë i gjuhës shqipe dhe avancimi kulturor i të gjitha bashkësive.

## Ligji për përfaqësim të drejtë dhe adekuat

Edhe pse nuk ekziston një definicion i dakorduar shkencërisht për “përfaqësimin e drejtë dhe adekuat”, sipas të gjitha dokumenteve politike qeveritare dhe ndërkombëtare qëllimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat në vendin tonë është proporcionaliteti. Pra, përfaqësimi i drejtë dhe adekuat duhet kuptuar si politikë afirmative, e bazuar në sistemin e kuotave, pra duke bazuar në përqindjen e bashkësive etnike në raport me popullsinë e përgjithshme.

Ligji për përfaqësim të drejtë dhe adekuat do të futet në procedurë parlamentare në 100-ditëshin e parë të qeverisjes sonë dhe do të ketë për qëllim kryesor arritjen e barazisë së plotë dhe eliminimin e diskriminimit strukturor në institucionet buxhetore në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat e tjera të jetës publike. Ligji do t'i ketë për synim kryesor masat në vijim.

- **Zbatimi i metodologjisë për përfaqësim të drejtë dhe adekuat në të gjitha institucionet shtetërore pa përjashtime.** Metodologjia e paraparë në Ligjin për administratën publike do të kompletohet dhe do të zbatohet në tërësi dhe në të gjitha institucionet publike, duke i evidentuar dhe eliminuar paraprakisht të gjitha përjashtimet, pengesat dhe inkonsistencat ligjore që pamundësojnë përfaqësim të drejtë dhe adekuat.
- **Ndërtimi i një gjyqësori përfaqësues, të paanshëm dhe joselektiv, në të cilin besojnë të gjithë qytetarët.** Do të ndërmerren masa afirmative për të siguruar përfaqësim të drejtë dhe të barabartë, për ta rritur kështu qasjen e qytetarëve në drejtësi, ndërsa do të zbatohen edhe politika të reja, si ajo e “karriges së zbrazët” deri në rekrutimin e kandidatëve nga bashkësitë jomaqedonase përderisa kjo nuk ndikon negativisht në efektivitetin dhe efektshmërinë e gjyqësorit, si dhe masa të tjera, siç janë: valorizimi i gjuhës shqipe dhe gjuhëve të bashkësive tjera, si dhe kurse të gjuhës juridike shqipe dhe asaj maqedonase për ta rritur numrin e kandidatëve të kualifikuar për gjyqtarë dhe prokurorë.
- **Zbatimi i parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat në gjithë sferën publike, duke përfshirë kompanitë me licenca shtetërore që ofrojnë shërbime për qytetarët.** Do ta zgjerojmë detyrimin ligjor për përfaqësim të drejtë të të gjitha bashkësive për kompanitë e mëdha me rëndësi shtetërore dhe shërbimet publike (si: uji, shërbimet postare dhe ato audivizuale, energjia elektrike, telekomunikacioni, etj.), kjo si pjesë e kushteve të licencimit, certifikimit dhe qasjes në prokurimet publike.
- **Stimulimi fiskal i ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha private për të arritur përfaqësimin e drejtë dhe adekuat.** Do të krijohen lehtësi tatimore,

siç janë lirimi nga kontributet e punëdhënësit ose nga një përqindje e tatimit në fitim për ndërmarrjet e mesme (50-249 nëpunës) dhe atyre të mëdha (250 ose më shumë nëpunës), që miratojnë dhe zbatojnë strategji efektive dhe plane veprimi të ndërmarrjeve për arritjen graduale të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, kjo bazuar në standardet europiane.

- **Zbatimi i plotë i ligjit për nëpunësit administrativ.** Në periudhën e mandatit tonë 4-vjeçar do të avancohen të gjithë të punësuarit administrativë që i plotësojnë kushtet për avancim në përputhje me ligjet e vendit.

## Eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit

Disa nga problemet kryesore që i pengojnë veprimet efektive kundër diskriminimit strukturor janë mosharmonizimi i legjislacionit relevant të Maqedonisë së Veriut me atë të BE-së, mungesa e kapaciteteve të institucioneve që punojnë kundër diskriminimit dhe atyre gjyqësore, mungesa e vullnetit politik për t'i zbatuar dispozitat mbi gjuhën e urrejtjes dhe krimin të urrejtjes, mungesa e programeve të synuara për t'i çrrënjësuar pabarazitë në tregun e punës, përfshirë pabarazinë gjinore dhe të personave me aftësi të kufizuara, si dhe vonesat në miratimin e një ligji që i rregullon të drejtat e invalidëve dhe familjeve të të rënëve gjatë konfliktit të vitit 2001.

Gjatë qeverisjes së tij, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & Alternativa do të ndërmarrë një sërë masash prioritare për t'i eliminuar të gjitha format e diskriminimit.

Zbatimi i regjistrimit të drejtë dhe të besueshëm të popullsisë, që është si gurthemel i Ligjit për përfaqësim të drejtë dhe adekuat. Një kujdes i veçantë do t'i kushtohet regjistrimit të të gjithë qytetarëve që jetojnë dhe punojnë jashtë Maqedonisë së Veriut gjatë procesit të rregullt dhe përfshirjes së tyre në numrin e përgjithshëm të popullsisë.

Evidentimi i librave shkollorë dhe materialeve akademike që promovojnë gjuhë të urrejtjes dhe paragjykime, që krijojnë përçarje ose i ofendojnë ndjenjat kombëtare të bashkësive. Brenda 100 ditëve të para të qeverisjes sonë do të bëjmë një evidentim të materialeve të tilla, mes tjerash përmes një thirrjeje publike drejtuar qytetarëve e ekspertëve dhe krijimit të një portali për t'i mbledhur kontributet e tyre. Bazuar në këtë evidentim, do të jemi pjesëmarrjes aktivë në mekanizmat ndërqeveritare për zbatimin e Marrëveshjes së Prespës dhe Traktatit të Miqësisë me Bullgarinë, ku po ashtu trajtohet kjo çështje.

Zbatimi i Ligjit për mbrojtjen dhe parandalimin e diskriminimit, duke siguruar harmonizimin e ligjeve të tjera me të, forcimin e organeve që veprojnë në mbrojtjen kundër diskriminimit dhe promovimin e drejtave të njeriut, si Komisioni për Mbrojtje



kundër Diskriminimit dhe Avokati i Popullit, duke i rritur burimet dhe kompetencat e tyre dhe duke miratuar legjislacion në përputhje me parimet e Parisit, përfshirë krijimin e shërbimeve të Sekretariatit për Komisionin për Mbrojtje kundër Diskriminimit. Një kujdes i veçantë do t'i kushtohet heqjes së pabarazive për qasje në tregun e punës dhe sigurimit të të dhënave të detajuara që kanë të bëjnë me kohezionin social për grupe të caktuara të cenushme, duke përfshirë bashkësitë e ndryshme etnike, gratë dhe personat nga zonat rurale.

Zbatimi i dispozitave ekzistuese rreth gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes. Dotë shqyrtohet ndryshimi i përkufizimeve të Kodit Penal dhe ndëshkimi, si dhe Ligji për shërbime audio dhe audiovizuale, për të siguruar kështu autorizimin e agjencisë përgjegjëse për ta përcaktuar gjuhën e urrejtjes në këto shërbime dhe për të shqiptuar masa paraprake, vërejtje ose gjoba, si dhe për t'i pezulluar licencat e transmetimit pas gjobave të përsëritura disa herë. Do të bëjmë forcimin e kapaciteteve të policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit për ta adresuar saktë diskriminimin, krimet dhe gjuhën e urrejtjes.

- **Amendamenti i Ligjit për shtetësi për ta rregulluar situatën e shumë qytetarëve të cilëve u mohohet e drejta e shtetësisë.** Këto ndryshime nënkuptojnë ndryshimin dhe plotësimin e ligjit në përputhje me standardet europiane, për t'i definuar kështu kriterete qarta dhe transparente, që të mundësohet automatizëm në njohjen e së drejtës për shtetësi për qytetarët që kanë lindur në Maqedoninë e Veriut, që kanë jetuar së paku 5 vje në mënyrë të ligjshme aty ose që janë martuar me shtetas të këtij shteti.
- **Amendamenti i kornizës ligjore zgjedhore për ta garantuar dhe zgjeruar të drejtën e votës së mërgimtarëve në çdo nivel zgjedhor.** Përveç votimit në ambasada dhe konsullata, votimi i diasporës do të mundësohet edhe përmes postës ose në mënyrë elektronike, kjo në pajtim me standardet europiane.
- **Themelimi i zyrave të veçanta për mërgimtarët në njësitë e qeverisjes lokale** për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të tyre për informata, asistencë dhe këshillim në lidhje me çështje të gjendjes civile, aktivitete kulturore dhe arsimore, si dhe për mundësitë për investim në vendlindje.
- Zgjidhje ligjore për dëmshpërblimin e të persektuarve politikë shqiptarë të periudhës së komunizmit.


## Zyrtarizimi i plotë i gjuhës shqipe

Edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri për përdorimin e gjuhëve, disa institucione nuk i përfillin detyrimet ligjore dhe e shkelin të drejtën kushtetuese të anëtarëve të bashkësive për përdorimin e gjuhës së tyre amtare në raportet e tyre me shtetin.

*Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & Alternativa do të angazhohet për zbatim të menjëhershëm dhe të tërësishëm të Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe, ndërkohë, do të vazhdojë të angazhohet që gjuha shqipe të jetë gjuhë e barabartë me atë maqedonase në Kushtetutë e jo të definohet si “gjuhë që e flasin mbi 20% e popullsisë e që është e ndryshme nga gjuha maqedonase”.*

Gjatë qeverisjes sonë do të zbatohet disa masa për të garantuar zyrtarizimin e plotë të gjuhës shqipe:

- **Rritja e mbështetjes financiare dhe institucionale për Agjencinë dhe Inspektoratin për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve,** me qëllim të informimit të saktë dhe të drejtë të qytetarëve për të drejtat e tyre gjuhësore, por edhe krijimin e një politike gjithëpërfshirëse gjuhësore, duke nënkuptuar përsheptimin dhe monitorimin e zbatimit të ligjit, si dhe ndëshkimin efektiv të shkelësve të ligjit.
- **Investime adekuate në krijimin e kapaciteteve të përkthimit, që janë të nevojshme për zbatimin e plotë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.** Sistemi aktual i përdorimit të gjuhëve krijon nevoja të mëdha për përkthyes të kualifikuar në çdo sektor dhe nivel të qeverisjes, gjyqësorit dhe shërbimeve publike. Prandaj do të ndërmerim iniciativë për ta rritur interesimin për profesionin e përkthyesit dhe për ta siguruar cilësinë e përkthimit dhe interpretimit. Do të organizohen, gjithashtu, programe për trajnime të specializuara të përkthimit dhe interpretimit brenda kurrikulës së rregullt në Fakultetin e Filologjisë, ndërsa do të përkrahet edhe profilizimi i një kuadri të lartë me studime pasuniversitare në Universitetin Europës



Juglindore, Universitetine Tetovës dhe Universitetin "Nënë Tereza". Do të organizohet, po ashtu, **certifikimi i përkthyesve** të specializuar, si dhe do të përkrahët zhvillimi i mundësive për karrierë brenda administratës.

- **Mbështetja e qeverive lokale për të zbatuar Ligjin për përdorimin e gjuhëve.** Do të krijohen qendra rajonale të përkthyesve dhe interpretuesve për t'i mbështetur autoritetet lokale nga distanca (përmes e-qeverisë). Do të organizohet trajnim profesional për përkthyes në nivelin e mesëm brenda strukturave ekzistuese arsimore, në mënyrë që të krijohet një masë e gjerë, efektive dhe funksionale e përkthyesve të përgjithshëm, veçanërisht për zyrtarizimin e gjuhës në nivel lokal. Komunitet me më shumë se një gjuhë zyrtare do të përkrahën duke paraparë linja të veçanta në buxhetin shtetëror ose duke e alokuar një pjesë të TVSH-sësë mbledhur në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

## Avancimi i kulturës shqiptare si dhe i të gjitha bashkësive tjera

Diversiteti kulturor është një nga vlerat themelore europiane dhe luan rol thelbësor në kultivimin dhe ruajtjen e dialogut, barazisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Larmia kulturore e Maqedonisë së Veriut është dhe duhet të jetë një nga forcat kryesore të vendit. Një vend i cili ka për synim strategjik integrimin në BE, ku motoja kryesore është "të bashkuar në diversitet", nuk guxon t'i shtypë identitetet e ndryshme kulturore përmes politikave shoviniste dhe segregacioniste, siç ka qenë rasti në gjithë historinë e ndërtimit të shtetit. Përkundrazi, shteti duhet ta luajë rolin kryesor në ruajtjen e interkulturalizmit, shpërfaqjen e identiteteve kulturore të të gjitha bashkësive, mbrojtjen dhe promovimin e hapësirave kulturore dhe në shkëmbimet kulturore si mjete të fuqishme për dialog dhe ndryshime pozitive.

Teoritë dhe analizat bashkëkohore të interkulturalizmit tregojnë se dallimet më të rëndësishme mes njerëzve nuk janë politike ose ekonomike, por janë kulturore. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA beson se rruga në të cilën duhet të ecë Maqedonia e Veriut është rrugë e bazuar në ngritjen e respektit ndaj dallimeve kulturore dhe krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë. Interkulturalizmi nuk është vetëm respekt për dallimet kulturore, por edhe nxitës i perceptimit të dallimeve etnike, fetare, ekonomike, sociale etj. Interkulturalizëm nuk është pranimi pasiv i dallimeve kulturore, por krijimi aktiv i kushteve për zhvillimin e kulturave të ndryshme.

Për të avancuar këtë koncept, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të zbatojë një numër masash përgjatë qeverisjes së saj.



- **Ndarja adekuate e buxhetit për kulturë.** Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të kujdeset që, përveç projekteve qendrore, të krijohet edhe, kultura shqiptare të jetë e barabartë si pjesë e pandashme e identitetit kulturor të Maqedonisë së Veriut dhe të ketë një fond të vecantë për zhvillimin e kulturës së bashkësive të tjera, që do të mundësojë mbrojtjen e identitetit tonë kulturor kombëtar, mes tjerash, përmes investimit strategjik në kujdesin për institucionet kulturore dhe objektet e trashëgimisë kulturore, si dhe në përkrahjen e punës së organizatave joqeveritare të kulturës shqiptare.
- **Rritja e autonomisë organizative dhe financiare të institucioneve kulturore** në krijimin e programeve të tyre që do të kontribuojë në ruajtjen e vlerave dhe traditave kulturore shqiptare dhe do të rrisë pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitetet kulturore.
- **Krijimi i Bashkësisë së Komunave ku Gjuha Shqipe është Zyrtare,** që do

ta këtë mision kryesor bashkërendimin e aktiviteteve vendore nga fusha e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve dhe atyre rajonale, të iniciuara nga bashkësitë e komunave në Shqipëri dhe Kosovë.



- **Decentralizimi i institucioneve të kulturës.** Do të angazhohemi për krijimin e sektorëve të veçantë për secilën bashkësi etnike brenda Ministrisë së Kulturës dhe për kalimin e shumë institucioneve kulturore nën ombrellën e komunave, duke siguruar buxhet adekuat për këto institucione përmes ndarjes së buxheteve adekuate për kulturë bashkësive etnike dhe të komunave. Në këtë rrafsh koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të kujdeset për rinovimin e tërësishëm të Pallatit të Kulturës në Gostivar që t'i ndihmojë teatrit të qytetit për funksionim cilësor.
- **Zhvillimi e bashkëpunimit kulturor me Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës.** Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të sigurojë që të jemi gjithmonë pjesë e barabartë e projekteve mbarëkombëtare kulturore në rajon. Për shembull, Teatri Shqiptar në Shkup, Teatri Kombëtar në Tiranë si dhe Teatri Kombëtar në Prishtinë do të krijojnë platformën e Festivalit Kombëtar të Teatrit. Në të njëjtën logjikë do të stimulohet edhe bashkëpunimi në mes institucioneve tjera shtetërore kulturore të këtyre shteteve dhe OJQ -ve nga sfera e kulturës. Kështu do krijohet unifikimi i vlerave kulturore.
- **Rritja e fondit të librave shqip në bibliotekat publike.** Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të ndajë një fond financiar për rritjen e numrit të titujve të librave shqip në bibliotekat publike, në bashkëpunim me Shqipërinë dhe Kosovën.
- **Zhvillimi i bashkëpunimit kulturor me mërgatën shqiptare.** Mendojmë se është i nevojshëm bashkëpunimi më i gjerë me qytetarët shqiptar të

Maqedonisë së Veriut të cilët jetojnë dhe punojnë në shtetet tjera, po aq sa ka bashkëpunim ose prezantim të projekteve kulturore me mërgatën maqedonase. Le të theksohet se nga Maqedonia e Veriut gjatë një periudhe të gjatë kohore ka pasur mërgim, jo vetëm ekonomik, por edhe migrim nga represioni politik. Në shumicën e rasteve të tilla kanë migruar intelektualë nga sfera të ndryshme, me të cilët duhet patjetër ta kthejmë bashkëpunimin dhe të stimulojmë krijimtarinë e tyre e cila do të ndihmojë në zhvillimin tonë kulturor. Për shembull, veprat letrare të autorëve shqiptar nga Maqedonia e Veriut të përkthehen në gjuhët e mëdha perëndimore me ndihmën e angazhimit të intelektualëve tanë në mërgatë, si dhe botimin e krijuesve të mërgatës te ne. Do të fokusohemi gjithashtu në prezantimin e projekteve kulturore nga shteti në mërgatë, si turne të ansambleve kulturore artistike, shfaqjeve teatrore, ekspozitave, etj.



- **Kujdesin për muzetë dhe objektet e trashëgimisë kulturore.** Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të angazhohet për themelimin e muzeve rajonale për ruajtjen e vlerave tradicionale, që do të jenë nën kompetencat e pushtetit lokal. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të angazhohet në veçanti për gërmime të mëtutjeshme arkeologjike dhe restaurimin e objekteve dhe siteve të rëndësishme së veçantë trashëgimore siç janë **Shkupi antik** ("Scupi"), **Kalaja e Tetovës**, **Kalaja e Orashës** dhe **xhamija e Tabanocit**, pa anashkaluar edhe **rindërtimin exhamive të Prilepit dhe të Manastirit**, të shkatërruara gjatë konfliktit të vitit 2001. Një prioritet i

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA ,në këtë rrafsh, është edhe **shpallja e shtëpisë së Kongresit të Manastirit si objekt i rëndësisë së veçantë trashëgimore** për shqiptarët. Ky objekt, hëpërhë, vetëm shërben pjesërisht si Muze i Alfabetit të Gjuhës Shqipe, kjo për shkak të mosangazhimit të qeverive të deritanishme dhe konteksteve pronësore, ndërsa një pjesë e tij është shndërruar në shitore private, duke e cenuar kështu vlerën trashëgimore e shpirtërore të gjithë objektit. Zgjidhja e kontesteve pronësore dhe shpallja e tij si objekt i rëndësisë së veçantë trashëgimore do të jetë hapi i parë drejt një kujdesi shtetëror të dinjitetshëm për këtë objekt, që është ndër më të rëndësishmit në historinë moderne të kombit shqiptar.



- **Rritja e fondit të librave shqip në bibliotekat publike.** Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të ndajë një fond financiar për rritjen e numrit të titujve të librave shqip në bibliotekat publike, kjo në bashkëpunim me Shqipërinë dhe Kosovën.
- **Konsolidimi kalendarik dhe financiar i festivaleve.** Në vend të festivaleve të çakorduara me buxhete gjysmake, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të angazhohet për konsolidimin e tyre kalendarik dhe financiar, duke promovuar krijimin e festivaleve të mëdha tradicionale, si për shembull: Java Kulturore e Nëntorit në Shkup ose festivali veror në Strugë, si dhe të

festivaleve shëtitëse me buxhete të mëdha dhe të koordinuara me Shqipërinë dhe Kosovën.

- **Themelimi i Muzeut të Historisë dhe Kulturës Shqiptare.** Shqiptarët në Maqedoninë Veriut akoma nuk kanë asnjë muze, ku do të tubohen dhe ruhen artefakte që dëshmojnë për autoktoninë shqiptare në këto treva, por edhe të periudhave më të vonshme të historisë. Gjithashtu aty do të duhet të konservohen edhe artefaktet e jetës kulturore e shpirtërore të shqiptarëve në këtë shtet.
- **Botimi i veprave të letërsisë shqipe në gjuhën maqedonase.** Është për keqardhje që maqedonasit nuk kanë gati asnjë informacion për shqiptarët dhe për kulturën e tyre. Jemi të bindur se botimi i letërsisë shqiptare në gjuhën maqedonase, veçmas i letërsisë së traditës, do të ndihmojë në njohjen e ndërsjellë mes dy kombeve dhe, përveç kësaj, në mirëkuptimin dhe komunikimin e tyre.
- Themelimi i Institucionit shtetëror Teatri Uskana (Kërçovë).
- Përmbyllja e punimeve të teatrit dhe bibliotekës së qytetit në Tetovë.



PA DALLIME,  
DREJTËSI  
PËR TË GJITHË

## PËR SHTETIN E SË DREJTËS

Demokracia, barazia dhe respektimi i të drejtave të njeriut e i shtetit të së drejtës janë ndër vlerat themelore të Bashkimi European, ku Maqedonia e Veriut aspiron të aderojë. Respektimi dhe zbatimi i përpiktë i këtyre vlerave është thelbësor për të ardhmen e vendit. Përbushja e standardeve themelore të qeverisjes demokratike, transparenca në çështjet publike, garantimi i lirisë së mediave dhe lufta kundër korrupsionit duhet të shndërrohen në synimet kryesore të qeverisjes së vendit.

Shteti i së drejtës ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e çdo qytetari: ai është parakusht për të siguruar trajtim të barabartë para ligjit dhe për mbrojtjen e të drejtave individuale dhe kolektive, por edhe për parandalimin e abuzimit të pushtetit nga autoritetet publike dhe për llogaridhënie nga vendimmarrësit dhe përfaqësuesit e popullit. Shteti i së drejtës është jetik për krijimin e besimit të qytetarëve në institucionet publike. Shoqëritë demokratike nuk mund të funksionojnë pa një besim të tillë.

Në shtetin e së drejtës, pushtetet publike veprojnë gjithmonë brenda kufizimeve të përcaktuara me ligj, në përputhje me vlerat e demokracisë dhe të drejtat themelore, si dhe nën kontrollin e gjykatave të pavarura dhe të paanshme. Kjo nënkupton se ligji vlen për të gjithë, se ligjet nuk janë sekrete ose arbitrare, se ato zbatohen me drejtësi dhe se sistemi i drejtësisë është i drejtë dhe joselektiv.

Edhe përkundër retorikës pa përmbajtje të pushtetit në ikje, Maqedonia e Veriut është larg nga shteti funksional i së drejtës. Përkundrazi, nga institucionet e specializuara ndërkombëtare, përfshirë Komisionin European, i cili kishte dhënë një nga vlerësimet më të ashpra deri më tani në Raportin e Progresit të vitit 2016, vendi cilësohet si "shtet i kapur".

Sipas definicionit të Bankës Botërore, kapja e shtetit ndodh kur elita e pushtetarëve dhe / ose biznesmenë të fuqishëm manipulojnë formulimin e politikave dhe ndikojnë në rregullat e lojës në dobi të tyre. Kapja e shtetit është një formë e korrupsionit të

nivelit të lartë, që karakterizohet me nivele të larta sekreti dhe merr dy forma: kapja e shtetit nga korporatat, me ç'rast pushteti publik ushtrohet kryesisht për përfitime private të oligarkëve, dhe kapja partiake e shtetit, me ç'rast partitë e politizojnë shtetin dhe institucionet duke ndjekur monopol politik. Në Maqedoninë e Veriut, siç është vërejtur me skandalin e përgjimeve dhe rastin "Zhvatja", këto dy forma të kapjes së shtetit bashkëjetojnë me njëra-tjetrën: vijat ndarëse midis politikanëve të korruptuar dhe oligarkëve thuajse nuk ekzistojnë, ndërsa interesat e tyre shumë herë janë në përputhje të plotë.

Adresimi i kapjes së shtetit dhe vendosja e shtetit të së drejtës dhe mirëqeverisjes mbeten çështjet më urgjente për Maqedoninë e Veriut. Ato janë të domosdoshme për materializimin e perspektivës europiane, për tërheqjen e investimeve dhe, ndoshta më e rëndësishmja, rikthimin e besimit të qytetarëve në institucione publike transparente dhe të përgjegjshme, kjo si parakusht për ta mbajtur rininë tonë në vendlindje.

Katër prioritetet e koalicionit Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA në këtë fushë janë: ndërtimi i një gjyqësori të pavarur, efektiv dhe të drejtë; çrrënjësja e korrupsionit; një administratë e depolitizuar dhe meritokratike; si dhe mbështetja e qytetarëve për t'u përfshirë në debatin publik përmes qasjes universale në informacion.

## Një mision këshillimor dhe monitorues europian për shtetin e së drejtës

Duke marrë parasysh falimentimin e shtetit të së drejtës dhe nevojën urgjente për të dëshmuar përkushtim politik në përmbushjen e kushteve të qershorit 2018 të Këshillit Europian për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE, **në 100 ditët e para të qeverisjes së re qeveria e koalicionit Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të kërkojë nga Komisioni Europian dhe disa shtete anëtare të BE-së, si Franca, Gjermania dhe Holanda, përkrahje urgjente në fushën e shtetit të së drejtës** përmes të gjitha mjeteve në dispozicion të BE-së dhe shteteve të tjera anëtare. Kërkesa do të ketë këto pika:

- **Një Raport Priebe III.** Do të kërkojmë riangazhimin e Grupit të Pavarur të ekspertëve të lartë për çështje sistimore të shtetit të së drejtës për të bërë një analizë të situatës pas skandalit "Zhvatja", një vlerësim për progresin bërë në adresimin e konkluzioneve të tyre të vitit 2015 dhe 2017, si dhe për të dhënë rekomandime shtesë adresimin e dështimeve sistimore në fushat themelore të shtetit të së drejtës. Një rëndësi e veçantë do t'u kushtohet edhe reformave të sistemit të sigurisë publike dhe të inteligjencës, duke u mbështetur në standardet e NATO-s.

- **Misionete rishikimit të rasteve nga gjyqtarë dhe prokurorë europianë (peer review).** Ky mekanizëm do të rishikojë procedurat gjyqësore në lidhje me rastet e montuara politike, ato të korrupsionit të nivelit të lartë dhe rastin e sulmit terrorist të 27 prillit 2017 mbi Kuvendin e Maqedonisë, gjithë me synim të transparencës së plotë dhe adresimin e llogaridhënies politike.
- **Një mision monitorues dhe këshillimor europian pranë institucionit pasues të Prokurorisë Speciale Publike.** Ky ekip i prokurorëve europianë do të ketë rol këshillimor dhe monitorues për të siguruar hetime proaktive, ndjekje penale dhe dënime përfundimtare në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë dhe të krimin të organizuar. Ky mision do të mund të ishte iniciativë e përbashkët e BE-së me një vend anëtar si Franca, e cila ka ndërmarrë angazhime të rëndësishme në këtë drejtim në strategjinë franceze për Ballkanin Perëndimor (2019).

## Një gjyqësor i pavarur, efikas dhe i drejtë

Pavarësia e gjyqësorit është thelbësore për ta siguruar drejtësinë dhe për ta ruajtur përgjegjësinë në pushtetin ekzekutiv dhe atë legjislativ. Ky është parakusht për çdo shoqëri demokratike të bazuar në shtetin e së drejtës dhe për zhvillimin ekonomik.

Në letër, posaçërisht pas miratimit të strategjisë për reformën në drejtësi (2017-2022) dhe planit të saj të veprimit, Maqedonia e Veriut ka një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse, e cila po të zbatohet plotësisht, do të duhej të siguronte funksionimi i duhur i sistemit gjyqësor me një standard të lartë. Gjyqësori dhe Prokuroria Publike do duhej të ishin në gjendje të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme jo t'i trajtojnë rastet në mënyrë selektive dhe të pabalancuar.

Megjithatë, standardet e shtetit të së drejtës shpesh lihen nën menjanenë praktikë, veçanërisht në rastet që kanë dimension politik ose etnik ose që përfshijnë interesa personale të politikanëve. Për më tepër, brenda sistemit gjyqësor, thellësisht të politizuar pas shumë viteve të ndërhyrjes politike, sjellja bllokuese, joetike dhe, shpeshherë, korruptive e disa gjyqtarëve dhe prokurorëve, është një nga pengesat më të mëdha për zbatimin e reformave. Kjo u dëshmuar më së miri me skandalin "Zhvatja" në Prokurorinë Speciale Publike, që ishte padyshim një nga skandalet më të mëdha politike në historinë e Maqedonisë së Veriut, dhe sinjalizoi falimentimin e vetë parimit të gjyqësorit të pavarur dhe shtetit të së drejtës, duke bllokuar në të njëjtën kohë rrugëtimin europian të vendit, që si dëm kolateral i faturohet qytetarëve.

Ndërhyrja politike në sistemet e emërimit, avancimit, disiplinimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve mbetet një dukuri e përhapur. Kjo vihet re nga institucionet e specializuara ndërkombëtare, përfshirë Komisionin Europian, në Raportin e Progresit

2019, ku theksohet politizimi i thellë i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë. Edhe në Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, ku do të duhej siguruar që gjyqtarët dhe prokurorët e ardhshëm të rekrutohen për të studiuar në Akademi në bazë të meritave, parimet dhe procedurat e meritokracisë nuk respektohen.

Prokurori Publik Shtetëror vazhdon të ushtrojë një rol hierarkik mbi sistemin e prokurorisë në kundërshtim me standardet e BE-së, ndërsa fuqia e tij e minon pavarësinë e Këshillit të Prokurorëve Publikë, i cili në vetë është thellësisht i politizuar dhe kontribuon në drejtësinë selektive.

Një rishikim nga Ministria e Drejtësisë, i bërë rishtazi ndaj sistemit informativ për menaxhim të automatizuar të rasteve të gjykatave në Gjykatën Themelore Shkup I, në Gjykatën e Apelit të Shkupit dhe në Gjykatën Supreme, dëshmon se caktimi i automatizuar i rasteve nuk respektohet në mënyrë sistematike, duke ngritur dyshime për manipulim të sistemit bazuar në ndikime politike.

Gjyqësori, gjithashtu, përballet me sfida të rëndësishme në zbatimin e gjykimeve dhe vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), duke shkelur kështu detyrimin e vendit me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Numri i gjykimeve të GJEDNJ-së, që janë në pritje të zbatimit, ishte prej 51 në fund të marsit 2019 në 4 prej tyre në procedurë të zgjeruar të monitorimit. Ekzistojnë një numër arsyesh për këtë, por kryesoret janë mungesa e vullnetit politik për adresimin e rasteve të ndjeshme dhe mungesa e burimeve dhe kapaciteteve në Byronë për Përfaqësim pranë GJEDNJ-së.

Gjatë qeverisjes së tij koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternativA do të zbatojë një numër masash prioritare për të ndërtuar një gjyqësor të pavarur, efikas dhe të drejtë, si:

- **Vetingu i gjyqtarëve dhe prokurorëve.** Ky proces i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve do të kryhet nga një organ i pavarur, i themeluar enkas për këtë arsye dhe në përputhje me standardet evropiane. Ai do të ngrihet mbi bazën e **tre kriterëve kryesore, siç janë: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.** Procesi i vetingut do të kryhet duke respektuar parimin e procesit të rregullt ligjor, proporcionalitetin, barazinë, paanshmërinë dhe efektivitetin, gjithë kjo bazuar në standardet evropiane.
- **Riorganizimi i gjykatave themelore dhe të apelit në bazë të rajoneve planore,** kjo me synim të rritjes së efikasitetit dhe uljes së ndërhyrjeve politike, por edhe me synim e një gjyqësori më të afërt me qytetarin, më përfaqësues dhe më të besueshëm.
- **Reformimi i rolit dhe procedurës së emërimit të Prokurorit Publik Shtetëror** për t'i miratuar ato në përputhje me standardet evropiane.

- **Reformimi i sistemeve për emërimin, avancimin, disiplinimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve** për të siguruar që pavarësia e sistemit gjyqësor të respektohet dhe promovohet në të gjitha nivelet, duke e mbrojtur në të njëjtën kohë gjyqësorin nga ndërhyrjet politike. Një ndër masat do të jetë miratimi i një strategjie të burimeve njerëzore të sistemit gjyqësor, që siguron transparencë të plotë në emërimin, avancimin, disiplinimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe në avancimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat.
- **Zbatimi i drejtësisë në së balancuar etnike.** Trupi i jurisë, që do të merret me procedimin e lëndëve në të gjitha nivelet e institucioneve të drejtësisë, në një të tretën e tij do të përbëhet nga pjesëtarë të bashkësisë etnikesë cilës i takon i pandehuri.
- **Përmirësimi i sistemit informativ për menaxhim të automatizuar të rasteve të gjykatave** për të siguruar funksionalitet dhe besueshmëri të plotë, pa ndërhyrje politike dhe me mundësi të nxjerrjes së të dhënave në nivelin qendror.
- **Rritja e transparencës së gjykatave.** Sistemet e brendshme të gjykatave për menaxhim të rasteve janë shumë të limituara në aspekt të funksioneve dhe raporteve që gjenerohen. Me qëllim të mbledhjes dhe publikimit të të gjitha informatave me interes publik, që procedohen në gjykata në nivel të shtetit, do të ngremë një agregator të integruar.
- **Ndryshimi i Ligjit për noterë dhe Ligjit për përmbarrim, për ta rritur kështu konkurrencën dhe për ta liberalizuar tregun me qëllim të rritjes së qasjes në drejtësi.** Kostoja e përgjithshme e zbatimit dhe kohëzgjatja e procedurës vazhdojnë ta pengojnë efikasitetin e sistemit. Kjo, së bashku me praninë e detyrueshme të një avokati në procedurat para noterëve (përfshirë në çështje trashëgimore), e pengon qasjen në drejtësi. Prandaj duhet të përmirësohet monitorimi i veprimtarisë së përmbarruesve nga dhoma përgjegjëse dhe Ministria e Drejtësisë.
- **Ekzekutimi i shpejtë i të gjitha gjykimeve të GJEDNJ-së** kundër vendit, duke hartuar lista të masave praktike dhe efektive në secilin rast ose kategori rastesh, si dhe duke i forcuar kapacitetet financiare dhe njerëzore të Byrosë për Përfaqësim pranë GJEDNJ-së.
- **Përmirësimi i situatës në burgje** dhe vendet e tjera të mbajtjes, duke adresuar rekomandimet e papërmblushura të Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Degradues, si dhe duke marrë masat e duhura për të gjitha rastet e keqtrajtimit.

- **Përshtatja Planit të Veprimit të Shengenit të 2008 me legjislacionin e ri të BE-së** dhe forcimi i kapaciteteve financiare dhe njerëzore të Qendrës Koordinuese për Menaxhim të Integruar të Kufijve për të siguruar koordinim efikas, shkëmbim të të dhënave, shkëmbim të informacionit dhe efikasitet më të madh.
- **Avancimi i kuadrit ligjor për emërimet në polici nga ana e këshillave komunalë**, që – krahas zgjedhjes së kryeshefit të policisë në stacionet policore – të rregullohet edhe zgjedhja e udhëheqësit të krim-technikës dhe udhëheqësit të administratës policore.



## Çrrënjësja e korrupsionit

Çdo pushtet, në dy dekadat e fundit, e ka shpallur luftën kundër korrupsionit si prioritet të vetin themelor. Megjithatë, në praktikë, veprimet e qeverive të njëpasnjëshme kanë qenë mjaft korruptive. Megjithëse është arritur përparim në krijimin e kornizës ligjore dhe institucionale për taluftuar korrupsionin, zbatimi i ligjeve kundër korrupsionit dhe trajtimi i pavarur i çështjeve të korrupsionit nga organet përkatëse mbikëqyrëse dhe gjykatat mbetet një sfidë e madhe.

Korrupsioni politik i nivelit të lartë, i manifestuar përmes abuzimit të pushtetit, konflikteve të interesit dhe praktikave të dyshimta të financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore, është shumë i përhapur, ndërsa ndërhyrjet politike në të gjitha sferat e qeverisjes kanë rezultuar në kapje të shtetit, duke e bërë kështu të

pamundur zbatimin e reformave anti-korrupsion. Ndërkaq, një korrupsion i tillë u mundëson rrjeteve të krimit të organizuar, të përfshirë në trafikimin me genie njerëzore, drogë dhe armë, që të forcohen dhe të infiltrohen në sistemet politike dhe ekonomike, duke i rritur kështu edhe më tej konfliktet e interesit.

Logjikisht, Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit të “Transparency International” për vitin 2019 rendit Maqedoninë e Veriut në vendin e 106-të nga gjithsej 180 vendet e anketuara, madje me një trend të përkeqësimit nga viti në vit dhe në grup me vetëm Moldavinë, Ukrainën dhe Rusinë, që shënojnë rezultat më të keq në kontinentin evropian.

Është dëshmuar se korrupsioni ka një efekt thellësisht të dëmshëm në financat publike, pasi që qeveritë mbledhin më pak të ardhura tatimore dhe mbipaguajnë për mallra dhe shërbime ose projekte investuese. Korrupsioni i nivelit të lartë, që mbizotëron në Maqedoninë e Veriut, zakonisht shoqërohet me projekte ndërtimore e infrastrukturore të kushtueshme dhe të komplikuar, ku kapaciteti për manipulime është i lartë. Por, kostoja e korrupsionit, në fakt, është më e madhe se shuma e parave të humbura: shtrembërimet në prioritetet buxhetore e dëmtojnë aftësinë e shtetit për të promovuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, duke zvogëluar burimet publike të investuara në arsim, shëndetësi, infrastrukturës efektive dhe prioritetet e tjera sektoriale, që mund ta përmirësojnë performancën ekonomike, produktivitetin dhe standardin e jetesës për qytetarët. Fondi

Monetar Ndërkombëtar ka llogaritur se në ekonomitë e tregjeve të brishta, siç është Maqedonia e Veriut, proporcioni i buxhetit shtetëror kushtuar arsimit dhe shëndetësisë është për një të katërtën më i ulët në vendet më të korruptuara. Pra, është e dëshmuar shkencërisht se sa më shumë që ka korrupsion në një vend, aq më pak ka investime në arsim e në shëndetësi.

Kostoja sociale e korrupsionit është gjithashtu shumë e theksuar në Maqedoninë e Veriut. Në shumicën e sondazheve ndërkombëtare qytetarët e veçojnë korrupsionin si një nga tre problemet kryesore me të cilat përballet vendi, gjë që e shpjegon, në masë të madhe, apatinë, emigrimin masiv dhe ikjen e trurit në vitet e fundit.

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do ta dedikojë tërë kapitalin e tij politik për çrrënjësinë e korrupsionit nga jeta publike, duke mbështetur, në nivelin më të lartë politik, institucione pro-aktive, të fuqishme dhe të pavarura, që do ta luftojnë korrupsionin duke marrë sanksione parandaluese dhe duke kryer hetime dhe ndjekje të efektshme, që çojnë në vendime gjyqësore të formës së prerë dhe të zbatuara.

Gjatë qeverisjes së tij, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të sigurojë zbatimin e plotë të rekomandimeve të organeve të specializuara anti-korrupsion, siç janë **Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO)** dhe institucioneve ndërkombëtare, si Bashkimi Europian, dhe do të ndërmarrë një reformë gjithëpërfshirëse të kornizës institucionale dhe legjislative, me qëllim



të forcimit të institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Prioritetet tona kryesore do t'i përfshijnë masat në vijim.

- **Avancimi i kuadrit ligjor** për deklaratat e interesave dhe pasurive të personave që mbajnë funksione publike për të siguruar që institucionet anti-korrupsion të jenë në gjendje të sigurojnë integritet në ushtrimin e funksioneve publike dhe në parandalimin e korrupsionit institucional. Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit do të përkrahët me më shumë kapacitete njerëzore dhe financiare, por edhe me kompetenca, metodologji dhe mjete që janë proporcionale me kryerjen e duhur dhe efektive të detyrave të tij. Pas kësaj, Komisionit do t'i zgjerohen kompetencat në zhvillimin e një mekanizmi adekuat për verifikimin e deklaratave dhe kryerjen e hetimeve.
- **Fuqizimi i strukturave të specializuara të Prokurorisë Publike për ta luftuar korrupsionin, krimin e organizuar, si dhe fuqizimi i organeve gjyqësore.** Kjo do ta përfshijë krijimin e njësisë speciale të policisë në zyrat e Prokurorisë.
- **Themelimi i një zyre shtetërore për rikuperimin e pasurive,** për ta rritur kështu efektivitetin e sistemit shtetëror të rikuperimit të pasurive. Kjo do të kërkojë miratimin e normave të reja legjislative, veçanërisht kthimin mbrapsht të ngarkesës së provës për mbajtjen e disa llojeve të pasurive dhe konfiskimin paraprak (në mungesë të dënimit) në rastet e pasurisë së pashpjegueshme në përputhje me "acquis communautaire" të BE-së.
- Përforcimi i kompetencave dhe burimeve të Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar, për të lejuar sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive kriminale, duke përfshirë ngrirjen paraprake të të ardhurave kriminale në fazat e hershme të hetimeve penale.
- Fuqizimi i institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit mund të jetë efektiv vetëm nëse shoqërohet me masa të fuqishme për të zhvilluar dhe promovuar një kulturë të transparencës, moralit dhe integritetit publik, në mënyrë që të rindërtohet besimi i qytetarëve në institucionet shtetërore dhe shërbimet publike. Prandaj, duhet të shkojmë më tej në fushën e transparencës, për të përmbushur ashtu pritjet e qytetarëve. Gjatë qeverisjes sonë do të miratojmë dhe zbatojmë një paketë të politikave të transparencës.
- **Gjeneralizimi i prokurimit elektronik (e-prokurim) transparent dhe tëkapshëm për publikun.** Administrimi i fondeve publike në të gjitha fazat e prokurimit publik është një sektor veçanërisht i prirë për korrupsion, ku kontrata të mëdha jepen ende përmes procedurave konfidenciale dhe pa tender publik. Përmes e-prokurimit të detyrueshëm për institucionet

buxhetore dhe ndërmarrjet publike do të sigurohet transparencë e plotë dhe qytetarët do të jenë në gjendje ta shohin qartë se si shpenzohen taksat e tyre, që nga faza e tenderimit e deri në ekzekutimin përfundimtar të kontratave.

- **Transparenca e plotë e veprimtarisë së qeverisë dhe ndërveprimeve me lobistë dhe palë të treta.** Rregullat e qeverisë do të ndryshohen për të siguruar që emrat dhe funksionet e të gjithë pjesëmarrësve në seancat qeveritare, nënkomisioneve dhe grupeve punuese, përfshirë palët e treta, të jenë publike në internet. Me rregulla shtesë do të rregullohet edhe ndërveprimi i bartësve të funksioneve të larta ekzekutive dhe legjislative me lobistë dhe palë të treta, që kërkojnë të ndikojnë në proceset e vendimmarrjes publike. Do të kërkohet, po ashtu, publikimi i një regjistri publik të kontakteve të tilla, përfshirë çështjet e diskutuara dhe identitetin e personave që marrin pjesë dhe / ose të përfaqësuar në takime të tilla.
- **Miratimi i rregullave të reja për përcaktimin e konflikteve të interesit dhe veting të integritetit të këshilltarëve dhe zyrtarëve të ngjashëm, të punësuar me diskrecion të zyrtarëve qeveritarë.** Emrat dhe përfitimet kontraktuale (pagat etj.) të atyre që punësohen për poste të tilla do të bëhen publike në internet. Në rast të angazhimit me orar të pjesshëm, vullnetar, me financim të ndonjë donatori ose në forma ad hoc, aktiviteti i tyre kryesor dhe burimi i financimit gjithashtu do të publikohet për të anashkaluar konfliktet e interesit.
- **Vendosja e një mbikëqyrjeje të jashtme të policisë nga Kuvendi, Avokati i Popullit dhe Prokurori Publik Shtetëror.** Një mbikëqyrje e tillë do të jetë plotësisht transparente në lidhje me çështjet e trajtuara, ndërsa statistikat përkatëse do të sigurohen në interval të rregullt.
- **Rritja e transparencës së policisë, duke rritur qasjen e publikut në raportim,** mes tjerash duke publikuar në internet raporte mbi rezultatet e aktiviteteve dhe vendimmarrjen, por edhe buxhetet e policisë, procedurat administrative, përfshirë raportet e prokurimit publik, statistikat, rregulloret dhe informacionet ngjashme. Ankesat kundër stafit të policisë do të pasqyrohen në statistika gjithëpërfshirëse, duke mbuluar procedurat disiplinore dhe penale dhe ato do të bëhen publike.
- **Zbulimi i plotë i pronësisë së kompanive.** Identiteti i pronarëve të vërtetë ("pronarët përfitues") të ndërmarrjeve kryesore që fitojnë tenderë publik shpesh është i panjohur, i fshehur prapa një zinxhiri korporatash vështirë të identifikueshme. Ky problem e ushqen sekretin, korrupsionin dhe evazionin tatimor. Transparenca rreth pronësisë përfituese të kompanive do të ndihmojë në përmirësimin e klimës së investimeve, zvogëlimin e rreziqeve të reputacionit dhe atyre financiare, parandalimin e korrupsionit dhe flukseve

financiare të paligjshme, forcimin e shtetit të së drejtës, rritjen e besimit dhe llogaridhënies, si dhe përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave tatimore.

## Një administratë publike e depolitizuar, meritokratike dhe efikase

Strategjia për reformën e administratës publike 2018-2022 dhe plan i saj i veprimit i adresojnë fushat kryesore të administratës publike, duke përfshirë depolitizimin dhe profesionalizimin e administratës publike. Megjithatë, si me shumicën e reformave të pushtetit në ikje, angazhimet mbesin vetëm retorike dhe zbatimi ka ngecur, ndërsa praktikrat e së kaluarës vazhdojnë të mbizotërojnë, pavarësisht se reforma e administratës publike është një nga tre kriteret kryesore për të fituar hapjen e negociatave për anëtarësim në BE.

Një nga kritikrat e përsëritura vazhdimisht nga Komisioni Europian dhe Këshilli i BE-së në lidhje me reformën e administratës publike është moszbatimi i parimit të meritës. Derisa Ligji për nëpunësit administrativë dhe Ligji për nëpunësit e sektorit publik, në parim, sigurojnë rekrutim, avancim, disiplinim dhe shkarkim të bazuar në merita, këto ligje nuk zbatohen në praktikë.

Kriteret për emërime në pozicione të larta drejtuese nuk janë të rregulluara qartë. Ekzistojnë dispozita kontradiktore në Ligjin për punë të brendshme, i cili mundëson që nëpunësit të përjashtohen nga zbatimi i Ligjit për nëpunësit administrativë. Procedurat për punësime të përkohshme ose kontrata mbi vepër me kriteret më të ulëta përdoren gjerësisht për të punësuar ashtu militantë partiakë, duke anashkaluar në këtë mënyrë kriteret meritokratike të përcaktuara në Ligjin për nëpunësit administrativë. Qëndrueshmëria financiare e reformës së administratës ngre, gjithashtu, pyetje serioze, sepse administrata përmbetet nga militantë partiakë, veçanërisht në kohë fushatash zgjedhore. Një numër i madh shkarkimesh dhe mijëra punësime të administratorëve të rinj dhe nëpunësve civilë u bënë pikërisht para zgjedhjeve lokale të vitit 2017, ashtu si edhe tash – në prag të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 12 prillit 2020. Ky veprim cilësohet si abuzim klasik i burimeve publike për objektiva elektorale në një shtet të kapur.

Gjatë qeverisjes së tij, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & Alternativa do të ndërmarrë një numër masash kritike për të siguruar një administratë publike efikase, të depolitizuar dhe meritokratike, e cila u përgjigjet qytetarëve dhe jo partive në pushtet.



- **Krijimi i masave mbrojtëse shtesë, që do të futen në proceset e rekrutimit në institucionet publike për t'i bërë ato më transparente dhe meritokratike.** Kjo është bërë një domosdoshmëri pas konkluzioneve të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në rastin e emërimeve të anëtarëve të familjes nga zyrtarët e qeverisë paraprake dhe asaj në ikje.
- **Mapimi i administratës publike dhe kapaciteteve njerëzore për çdo institucion shtetëror,** për të krijuar në pasqyrë të qartë të strukturës organizative, kapaciteteve njerëzore dhe përshkrimeve të vendeve të punës. Ky mapim i strukturës organizative të administratës do të shndërrohet në plan veprimi për të ndërtuar struktura dhe kapacitete administrative të përgatitura për të dhënë shërbime më cilësore dhe për ta kthyer besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore.
- **Analiza e kalkulatorit BalancER.** Kalkulatori BalancER është një sistem i cili nga çdo institucion shtetëror kërkon të japë informata rreth strukturës së kapaciteteve njerëzore dhe planifikimin e punësimeve të reja. Siç dihet, ky sistem nuk ka dhënë rezultate të kënaqshme ose është abuzuar nga institucionet shtetërore. Në 100-ditëshin e parë të qeverisjes sonë do të behet analizë e detajuar e këtij kalkulatori dhe e të dhënave që i ka baza e këtij kalkulatori për çdo institucion shtetëror. Ai do të përkthehet edhe në gjuhën shqipe dhe do tapërkufizojë indeksine prioritetitë gjinisë femërore. Me

qëllim të shmangiesse abuzimeve në sistem do të formohet edhe një sistem kaskadë, i cili do të bëjë kontrollimin e informatave para se të procedohen ato nga kalkulatori.

- **Konkurset do të jenë të hapura për të gjitha rekrutimet publike** për ta ndaluar përdorimin e tepërt të rekrutimeve të përkohshme, kontratave mbi vepër dhe llojete tjera të rekrutimit që e anashkalojnë parimin e meritës.
- **Kalkulatori për pagat e punonjësve në sektorin publik.** Për një pjesë të sektorit publik, që ka numër të madh të të punësuarve në një sektor, siç janë Ministria e Punëve të Brendshme, ajo e Mbrojtjes ose Ministria e Arsimit, e drejta për pagë përcaktohet me ligje të veçanta. Mënyra e llogaritjes së pagës, si dhe sasi të shtesë, rregullohen nëpërmjet kontratave kolektive. Ky sistem është jokonsistent dhe shkakton disproporcionalitet në rroga edhe kur bëhet fjalë për profil të njëjtit të punës në sektorë të ndryshëm. Për t'i sinkronizuar politikat që kanë të bëjnë me lartësinë e pagave, kalkulatori i pagave do të mundësojë gjenerimin e një kornize të pagave në bazë të përshkrimit të punës.
- **Rritja e transparencës së arsyeve të pushimit nga puna.** Pushimit nga puna gjithashtu duhet t'u jepet më tepër përmbajtje për të siguruar ashtu drejtësi dhe proces të rregullt.
- **Funksionalizimi i Akademisë së Administratës Shtetërore.** Maqedonia e Veriut nuk ka një sistem të integruar, ku administrata shtetërore trajnohet, testohet dhe certifikohet në vazhdimësi. Sistemi i trajnimeve online të Ministrisë së Shoqërisë Informativë dhe Administratës është shumë i limituar dhe nuk ka dhënë rezultate të kënaqshme. Akademia nuk e ka definuar edhe sot listën e ekspertëve që janë të punësuar aty ose që japin shërbime për Akademinë. Funksionalizimi i Akademisë do të jetë prioritet në 100 ditët e para të qeverisjes sonë, kjo si hap i rëndësishëm për profesionalizimin e administratës shtetërore.
- **Sistemi elektronik për zhvillim profesional të zyrtarëve shtetërorë ("Portofoli administrativ").** Do të ndërtohet një sistem elektronik në nivel operacional, që i ndihmon institucionet shtetërore që të ofrojnë trajnime (LLL) me qëllim të përmirësimit të performancës të nëpunësve shtetërorë. Ky sistem do të mundësojë përgatitje efektive dhe efektive të zhvillimit profesional për çdo zyrtarë administrativë. Hapat që do të ndërmerren janë: ndërtimi i portofolit për çdo vend pune në administratën shtetërore, data entry e portofolit për çdo punonjës në administratë, krijimi i modulit për krahasim ndërmjet portofolit dhe CV-së së administratorit, përkufizimi i kurseve që duhet të ndiqen në bazë të analizës paraprake, zhvillimi i moduleve për trajnim për çdo kategori dhe

krijimi i data-bazës me trajner për çdo kategori.

- **Rritja e qëndrueshmërisë financiare të reformës së administratës publike,** duke bërë analizë sistematike të kostos së saj në buxhetin shtetëror dhe kornizën afatmesme të shpenzimeve për të shmangur abuzimet për objektivat elektorale.

## Qytetarë të mirinformuar dhe të inkurajuar për debate publike

Liria e shprehjes dhe liria e informacionit janë parime themelore për qeverisje të mirë dhe shtet të së drejtës. Pushteti i katërt ose mediat e pavarura luajnë rol të rëndësishëm në kontrollin e pushteteve të tjera dhe në fuqizimin e qytetarëve për t'u bërë aktorë aktivë të jetës publike. Teknologjitë e reja mund të sigurojnë përfitime të mëdha në këtë drejtim, por ato duhet të mbështeten nga masa që i inkurajojnë qytetarët të kenë qasje në informim të drejtë dhe cilësor në gjuhën e tyre.

Si në shumë fusha të tjera, Maqedonia e Veriut ka një kornizë ligjore të konsoliduar për sa përket lirisë së shprehjes, lirisë së mediave dhe informacionit, por problemi qëndronte zbatimi i tyre praktik. Problemet kryesore përfshijnë ndërhyrjet nga ana e politikës dhe biznesit në sektorin e mediave, duke kompromentuar gazetarinë e pavarur, përfshirë edhe kontrollin politik të pushtetit ndaj shërbimit publik, pronësinë e paqartë të mediave, sidomos të atyre elektronike, si dhe presionet ndaj gazetarëve.

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & Alternativa do të përqendrohet në përmirësimin e kushteve për gazetari të pavarur dhe profesionale, si dhe në inkurajimin e qytetarëve për t'u përfshirë në debat publik përmes zbatimit të masave në vijim.

- **Shërbimi publik në gjuhën shqipe.** Do ta riorganizojmë Radiotelevizionin e Maqedonisë së Veriut duke i kushtuar rëndësi të veçantë pavarësisë editoriale dhe trajtimit të barabartë të qytetarëve në aspektin e së drejtës për informim.
- **Rishikimi i financimit të mediave dhe reklamimit qeveritar.** Do të marrim masa për të inkurajuar zhvillimin e një mjedisi të shëndoshë për lirinë e mediave, duke promovuar raportim objektiv dhe të saktë, duke përfunduar financimin selektiv publik të mediave dhe kontratat arbitrare të qeverisë për reklamim sipas preferencave politike.

## KAPITALI NJERËZOR DHE RINIA

## PËR SHTET QË KULTIVON DHE RUAN KAPITALIN NJERËZOR

Në ekonominë botërore moderne, të bazuar në dituri, aftësitë, arsimimi, shëndeti dhe atributet e tjera të njerëzve ose kapitali i tyre njerëzor, janë bërë aset më i madh i shteteve. Kapitali njerëzor është thelbësor për produktivitetin individual të njerëzve, por edhe për rritjen ekonomike të shtetit. Kapitali njerëzor është, pra, një shtytës kryesor i rritjes së qëndrueshme. Hulumtimet më të reja shkencore tregojnë se kapitali njerëzor i shteteve shpjegon gati dy të tretat e diferencave të të ardhurave në botë.

Shtetet e Bashkimit Europian po i rrisin investimet në kapitalin e tyre njerëzor, për t'u bërë sa më konkurrues në ekonominë e globalizuar dhe po punojnë në mënyrë strategjike drejt një ekonomie të mirëqenies, të fokusuar në njerëzit e tyre. Ekonomia e mirëqenies i ka katër shtylla kryesore:

1. **Arsimimi dhe kompetencat profesionale.** Kompetencat janë shtytësi më i rëndësishëm i rritjes afatgjate ekonomike. Vlerësohet se një vit shkollimi shtesë në gjithë shoqërinë e rrit produktin bruto vendor për rreth 12% për kokë banori.
2. **Shëndeti.** Hulumtimet shkencore dëshmojnë se shëndeti i mirë nxit rritjen ekonomike, produktivitetin dhe të ardhurat individuale. Për shembull, kostoja totale e shëndetit të dobët vlerësohet se kushton vendeve të BE-së mbi 4% të produktit bruto vendor ose më shumë 600 miliardë euro në vit.
3. **Mbrojtja sociale dhe rishpërndarja e parasë publike.** Të dyja këto luajnë një rol të rëndësishëm në zvogëlimin e paqëndrueshmërisë ekonomike dhe rritjen e rezistencës së njerëzve ndaj vështirësive ekonomike. Sipas Organizatës për

Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), sa më e vogël që është pabarazia në një vend, aq më e lartë është rritja e produktit bruto vendor.

**4. Barazia gjinore.** Rritja e punësimit dhe e orarit të punës së grave gjithashtu sjell rritje të produktivitetit dhe të produktit bruto vendor. Barazia gjinore e ul pabarazinë në të ardhura dhe kontribuon në konsolidimin e klasës së mesme.

Maqedonia e Veriut ka një bilanc katastrofik në të gjitha fushat e mësipërme, kjo sipas shumicës së matjeve ndërkombëtare. Indeksi i Kapitalit Njerëzor të Bankës Botërore, i cili llogarit kontributet e shëndetit dhe arsimimit në produktivitetin e punëtorëve dhe e mat produktivitetin e ardhshëm të fëmijës së lindur sot në raport me standardin e shëndetit dhe arsimimit të plotë, e rendit Maqedoninë e Veriut në vendin e 88-të nga gjithsej 157 shtete (2018). Ky rezultat është më i dobëti në tërë kontinentin evropian. Sipas Indeksit për Zhvillimin Njerëzor të Programit të OKB-së për Zhvillim (UNDP), i cili e matë zhvillimin njerëzor afatgjatë sa i përket jetës së gjatë dhe të shëndetshme, qasjes në njohuri dhe standard të mirë të jetesës, vendi ynë është përsëri një nga performuesit më të dobët në Europë, duke u renditur në vendin e 82-të nga 189 shtete (2019). Dhe, në fund, sipas Forumit Ekonomik Botëror, Maqedonia e Veriut është një nga ekonomitë më pak konkurruese në Europë. Indeksi Global i Konkurrencës, i cili e matë aftësinë e shteteve për të siguruar nivele të larta prosperiteti për

qytetarët e tyre, e radhit vendin tonë në pozitën e 82-të nga 141 shtete, që përsëri është një nga performansat më të dobëta në rajon dhe në Europë.

Kjo performansë e dobët në zhvillimin njerëzor e shpjegon një masë të madhe valën masive të emigracionit me të cilin po përballlet vendi. Sipas Bankës Botërore (2018), më shumë se 25% e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut kanë emigruar në periudhën 1995 – 2015. Edhe më shqetësues është studimi i Institutit të Kosovës për Politika Europiane (2019), i cili dëshmon se numri i përgjithshëm i qytetarëve që kanë emigruar nga Maqedonia e Veriut drejt vendeve të BE-së në periudhën 2008 - 2018 është 258,000 ose 12% e popullsisë. Majat më të larta të kësaj vale të re emigrimi vërehen më 2017 dhe 2018, kur janë regjistruar 27,000 dhe 33,000 qytetarë të shpërngulur, gjë që flet për një trend në rritje.

Kjo gjë dëshmohej edhe nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, i cili në Barometrin Ballkanik (2019) konstaton se 43% e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut mendojnë të emigrojnë për të punuar jashtë vendit. Të gjitha organizatat e specializuara konstatojnë se emigrantët janë kryesisht të rinj, në moshë pune dhe më të arsimuar se mesatarja e popullsisë.

Mungesa e kohezionit social dhe pabarazia veprojnë në plan afatshkurtër, si pengesa në integrimin e vendit në BE, sepse qeveritë e BE-së po bëhen gjithnjë e më rezistuese karshi integritit të shteteve që qëndrojnë larg BE-së. Rreziku, në plan afatgjatë, është që fuqia jonë punëtore më e kualifikuar,

përfshirë profesionet e mjekësisë, akademikët, studentët dhe teknikët e kualifikuar, do të humbin shpresën dhe durimin dhe ata do të zgjedhin të integrohen vetë në BE, duke ikur masovikisht drejt vendeve që ofrojnë mundësi më të mira për ata dhe familjet e tyre. Kjo do të ishte shkatërrimtare për të ardhmen e vendit.

Emergjenca sociale me të cilën po përballemi si shtet kërkon një përgjigje politike të fortë dhe të menjëhershme për t'iu përgjigjur shqetësimeve të qytetarëve tanë rreth papunësisë, varfërisë dhe pabarazisë. Ndryshe, vendi do të zbrazet dhe pabarazia e lartë do të çojë, në mënyrë të pashmangshme, drejt shkatërrimit të përhershëm të besimit në institucionet e shtetit, duke krijuar kushte të favorshme për rritjen e popullzimit dhe të destabilizimit social dhe politik.

Vizioni që koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternativA do të avancojë gjatë katër viteve të ardhshme është ky: shtet që kultivon dhe e ruan kapitalin njerëzor për t'u shndërruar në një ekonomi të mirëqenies dhe konkurruese në Europë dhe në botë. Gjatë qeverisjes së tij, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternativA do t'i rrisë investimet në kapitalin tonë njerëzor, duke u përqendruar në katër shtylla kryesore: arsimit, shëndetësia, mbrojtja sociale, barazia gjinore dhe fuqizimi i të rinjve.

## Arsim cilësor, i arritshëm dhe në përputhje me nevojat e tregut

Dëshmitë shkencore flasin se frekuentimi më i lartë në arsimin parashkollor, autonomia më e madhe e institucioneve të arsimit, ulja e boshllëkut midis arsimit të lartë dhe atij profesional, si dhe rritja e investimeve në arsimin e lartë, e rrisin dukshëm edhe kapitalin njerëzor, ndërkohë që këto e përmirësojnë edhe efikasitetin e sistemeve arsimore. Për më tepër, ulja e pabarazive në arsim dhe ofrimi i mundësive të barabarta janë thelbësore për të promovuar rezultate më të mira arsimore.

Në Maqedoninë e Veriut përfshirja në arsim mbetet e pabarabartë, veçanërisht në edukimin parashkollor dhe në arsimin e lartë.

Edukimi parashkollor është veçanërisht problematik – vetëm 30% të fëmijëve janë regjistruar në institucionet e licencuara parashkollore në vitin shkollor 2018/2019. BE-ja në objektivat e saj për arsim dhe aftësim synon pjesëmarrjen e 95% të fëmijëve në edukimin parashkollor. Shkalla e regjistrimit dhe e përfundimit në ciklin fillor dhe të mesëm (rreth 87% të nxënësve e përfundojnë ciklin e mesëm) mbetet nën mesataren e BE-së. Kur bëhet fjalë për arsimin e lartë, strategjia e BE-së "Europa 2020" synon ta rrisë proporcionin e 30-34-vjeçarëve që kanë mbaruar arsim të lartë në minimum 40% deri në vitin 2020, synim ky që në BE është tejkaluar qysh në vitin 2018. Në vendin tonë shkalla e përgjithshme e regjistrimit të studentëve në institucionet e arsimit të



lantë ishte mbi 40% në vitin akademik 2018/2019, por shkalla e përfundimit të studimeve mbetet shumë e ulët –vetëm 33%. Maqedonia e Veriut gjithashtu qëndron shumë prapa në pjesëmarrje të rritur në arsimit joformal dhe aftësimin profesional. Statistikat e Eurostatit flasin se vetëm 2.4% e personave të moshës 25-64 vjeç marrin pjesë në mësim të tillë, krahasuar me një mesatare të BE-së prej 11.1%.

Mundësia e pabarabartë në nivele të ndryshme të arsimit, kjo si pasojë e diskriminimeve të shumfishta, është një shqetësim serioz për vendin tonë. Diskriminimi i parë është ai etnik, që është shumë i qartë kur analizohen shifrat e Zyrës Shtetërore të Statistikave (2014). Derisa 30,107 fëmijë ishin gjithsej të regjistruar në çerdhe, 26,664 prej tyre ishin maqedonas (ose 88.56%), vetëm 1,976 ishin shqiptarë (ose 6.56%) dhe

1.467 nga bashkësitë të tjera (ose 4.87%). Ky nënpërfaqësim i skajshëm i fëmijëve shqiptarë vjen për shkak të mungesës së strukturave në vendbanimet ku jetojnë shqiptarët dhe formave tjera të diskriminimit që ndërliken me shpërndarjen e padrejtë të buxhetit të shtetit. Diskriminimi i dytë kryesor është ai ekonomik. Sipas Databazës së Pabarazisë Arsimore në Botë nxënësit që i takonin 20-përqindëshit më të varfër në Maqedoninë e Veriut merrnin pjesë në edukimin parashkollor në shkallë prej vetëm 2%, ndërsa ata që i takonin 20-përqindëshit më të pasur merrnin pjesë në shkallë prej 29%.

Ky diskriminim strukturor në arsim natyrisht që lë pasojë të shumta, sepse privimi nga arsimi cilësor dhe i përballeshëm jo vetëm që i pengon mundësitë e fëmijëve për zhvillim dhe trashëgon një rreth vicioz të pabarazisë,

por gjithashtu i ndëshkon prindërit, veçanërisht nënat, të cilave u vështirësohet pjesëmarrja në tregun e punës, kjo për shkak të mungesës së kujdesit parashkollor.

Edhe pse shpenzimet publike për arsim në Maqedoninë e Veriut janë rreth 4% të prodhimit bruto vendor, pra thuhet në nivelin e mesatares së vendeve të BE-së, rezultatet arsimore të nxënësve tanë janë shumë më të dobëta se ato të bashkëmoshatarëve të tyre nga rajoni dhe, po ashtu, janë në mospërputhje me investimet publike. Pra, problemi i cilësisë në arsim në të gjitha nivelet vjen jo aq nga mungesa e investimeve në terma absolutë, por nga mënyra e investimit, e cila është thellësisht e ndikuar nga politika dhe në esencë është korruptive.

Gjendja e cilësisë në arsimin tonë u dëshmuar më së miri nga rezultatet e Programit të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (PISA), ku Maqedonia e Veriut u rendit dy herë me radhë si një nga performueset më të dobëta në botë. Sipas Bankës Botërore, bazuar në llogaritjet e të dhënave PISA, me ritmin e tanishëm të përparimit, Maqedonisë së Veriut do t'i duhen tre dekada për ta arritur mesataren e aftësisë për të lexuar të vendeve të BE-së. Një tjetër tregues i rëndësishëm i cilësisë së dobët të arsimit është mospërputhja e theksuar midis kompetencave të fituara nga nxënësit e ciklit të mesëm dhe studentët e ciklit të lartë dhe, në anën tjetër, aftësive të kërkuara nga kompanitë, gjë që e komplikon tranzicionin nga shkolla në punë dhe sjell papunësi strukturore në tregun e punës. Kjo mospërputhje aftësish e dëmton konkurrueshmërinë, investimet e huaja dhe rritjen ekonomike, ndërsa kjo pritet të jetë edhe më e theksuar për shkak të emigrimit masiv të punëtorëve të kualifikuar.

## Përmirësimi i mundësisë për arsim cilësor për të gjithë.

Me qëllim të përmirësimit të mundësisë për arsim dhe cilësisë së arsimit në përgjithësi, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do t'i zbatojë masat në vijim.

- **Ngritja e kapaciteteve për fëmijët në ciklin parashkollor (vende të reja në ciklin parashkollor).** Do të hartojmë një strategji për rritjen e kapaciteteve të edukimit parashkollor me vende të reja deri në fund të mandatit qeveritar të koalicionit Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA, kjo me qëllim të afrimit me objektivat e BE-së për edukim parashkollor deri në vitin 2030.
- **Modernizimi i objekteve mësimore** (meremetimi dhe ndërtimi i plotë i tyre) dhe pajisja e objekteve shkollore me mjetet e nevojshme për arsim cilësor.
- **Gjimnazet për teknologji dhe shkenca digjitale.** Gjimnaze të tilla do të themelohen në Shkup (ekzistues), Tetovë dhe Manastir, ku do të ofrohet

kurrikulë për teknologji dhe shkenca digjitale, kjo si nevojë e kohës dhe bazuar në përvojat e vendeve të zhvilluara, ku këto institucione japin rezultate të suksesshme. Këto shkolla duhet të jenë qendra ekselence për fëmijë të talentuar, që e prodhojnë elitën shkencore të së ardhmes. Mësimi do të mbahet nga profesorë universitarë dhe numri i nxënësve në klasa nuk duhet do të jetë më i lartë se 15 për klasë.

- **Klasterë në arsimin fillor dhe të mesëm.** Në të kaluarën mësimi kabinetik jepte rezultate pozitive në disa aspekte, si organizimi i orëve praktike, menaxhimi dhe mirëmbajtja më e lehtë e materialeve dhe mjeteve të punës, si dhe bashkëpunimi ndërmjet ligjëruesve të së njëjtës lëmi. Krijimi i klasterëve në nivel të lëndës/lëndëve do të mundësojë ngritjen e performansës, cilësisë dhe infrastrukturës në shkolla. Çdo klaster do të ketë kabinet të furnizuar me mjete për mësim dhe program vjetor për t'u realizuar jashtë programit vjetor të definuar nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit.
- **Krijimi i klubeve për inovacion në shkollat fillore dhe të mesme.** Në arsimin fillor dhe të mesëm e kemi lëndën e inovacionit, por përvojat e deritanishme tregojnë se nuk kemi arritur rezultate të mjaftueshme, kjo për shkak se është ky proces është menaxhuar vetëm në pjesën teorike, pa praktika të mira ose mundësi për pune praktike. Krijimi i klubeve për inovacion, me mbështetje të ndërmarrjeve lokale të vogla dhe të mesme, do të japë rezultate shumë pozitive. Kompanive të interesuara për të bërë donacione në shkollat fillore dhe të mesme do t'u mundësohet me ligj që të krijojnë entitet juridik në shkollë, ndërsa gjatë themelimit të klubit do të kërkohet program vjetor nga kompania. Ministria e Ekonomisë do t'i subvencionojë kompanitë që krijojnë klube nëpër shkolla. Klubi do të ketë bord udhëheqës, ndërsa në përbërje të tij do të jetë detyrimisht një nga drejtuesit e menaxhmentit të shkollës dhe arsimtarë të interesuar për të punuar me fëmijë në këtë klub. Arsimtarëve do t'u kalkulohet puna në klub me 0.5 të orëve të mësimi.
- **Rikthimi i shkollave verore dhe dimërore.** Shkollat verore dhe dimërore, në të kaluarën, kishin efekt shumë pozitiv. Ato do të rikthehen duke i detyruar komunitat që të krijojnë mundësi për realizimin e shkollave verore dhe dimërore, duke ndarë për çdo vit, bashkë me shkollat, një buxhet për mbajtjen e aktiviteteve përkatëse. Pjesëmarrësit do të certifikohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e cila do të jetë përgjegjëse për akreditimin paraprak të programit të punës së shkollave verore dhe dimërore.
- **Një mjedis më i shëndoshë arsimor.** Do të angazhohemi për eliminimin e bullizmit dhe dhunës psikike, si dhe kundër përdorimit të substancave narkotike eseksizmit në të gjitha nivelet e sistemit arsimor.



- **Rritja e inkluzivitetit për nxënësit me nevoja të veçanta.** Ligji për arsim fillor ngërthen masa për inkluzivitet tek nxënësit me nevoja të veçanta, por të cilat janë të porealizueshme në praktikë, sepse mungojnë hapësirat dhe kuadri. Do të identifikohen shkollat ku mund të realizohet inkluziviteti progresiv dhe masat e tjera që duhet të ndërmerren që këta nxënës ta ndjekin mësimin, duke përfshirë këtu edhe transportin falas.
- **Aftësimi profesional i kuadrit mësimor në trajnime të ndryshme në vend dhe jashtë.** Meqë procesi mësimor është një punë dinamike, do të angazhohemi që kuadri mësimor t'i ndjekë trendet më të reja të zhvillimit profesional, qofshin trajnime që organizohen brenda ose jashtë vendit.
- **Hartimi i teksteve të reja shkollore dhe eliminimi i gjuhës diskriminuese në tekstet shkolle.** Problemi i gjuhës së urrejtjes nëpër tekste mësimore është një dukuri që disa vite me radhë shfaqet dhe krijon përplasje shoqërore. Angazhimi jonë do të jetë që tekstet mësimore të pastrohen nga gjuha e urrejtjes çfarëdo qoftë ajo. Nuk mund të lejojmë që nxënësit të krijojnë paragjykitime dhe stereotipa për shkak të njësive mësimore që përfshijnë përmbajtje me gjuhë të urrejtjes.
- **Gjuha shqipe si lëndë fakultative në mërgatë.** Në bashkëpunim me autoritetet e Shqipërisë dhe Kosovës, do ta rrisim përkrahjen për mësimin e gjuhës shqipe si lëndë fakultative në mërgatë, kjo bazuar në programet e përpiluara nga Shqipëria.
- **Arsimimi dhe aftësimi profesional në burgje.** Duke synuar risocializimin e

personave të privuar nga liria dhe punësimin e shpejtë në tregun e punës pas lirimit të tyre, do të zhvillojmë një sistem të trajnimit dhe (ri)arsimit profesional në burgje. Veprimet konkrete që do t'i ndërmarrim për ta zbatuar këtë projekt janë aplikimi për donacione për pajisje teknike, përkufizimi i trajnimeve sipas hulumtimit të tregut të punës dhe profesionet deficitare, si për shembull: bukëpjekës, kopshtarë, etj., si dhe definimi i komponentëve bazë për realizimin e projektit.

- Optimizimii proceseve administrative për arsimtarët e shkollave fillore dhe të mesme.
- Zgjidhja e çështjes së godinës për gjimnazin "Sami Frashëri" në Kumanovë.
- Rregullimii statusit juridik të shkollave të mesme fetare.

## Avancimi i mësimin në distancë në një sistem të integruar arsimor

Situata me të cilën ballafaqohet bota sot, për shkak të korona-virusit, ka hapur shumë dilema dhe pyetje në lidhje me sistemet arsimore në botë, për strukturat e mësimin, organizmit dhe format e mundësitë e mënyrave alternative të edukimit, veçanërisht për mësimin në distancë. Fatkeqësisht, në shtetin tonë sistemi i mësimin në distancë nxori në pah shumë mangësi, si në aspektin teknik e organizativ, ashtu edhe në aspektin e kompetencave dhe përgatitjes së profesorëve për të ligjëruar në distancë. Gjithashtu, edhe mungesa e internetit dhe pajisjeve kompjuterike ishte arsye që një numër i madh i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme, si edhe studentët të mos mund ta ndjekin mësimin në distancë. Si rrjedhojë, **shteti e ka thyer rëndë të drejtën e çdo qytetari për arsim fillor, të mesëm dhe sipëror.**

Duke mos pasur një platformë të centralizuar, MASH-i bëri që secili profesor të përdor platforma të ndryshme për mësim në distancë. Kështu tashmë është bërë e qartë se është shumë e rëndësishme që një koncept i ri si ky për mësim në distancë ta ketë një ekosistem për të gjitha fazat e realizimit të mësimin që nga faza e përgatitjes së materialeve, krijimit të klasave virtuale, menaxhimit interaktiv, e deri në evaluimin e njohurive. Gjithashtu ky proces kërkon që gjatë fazës së krijimit të platformës shtetërore për mësim në distancë theks i veçantë të vendoset në krijimin e një platforme që do të mundësojë qasje kompatible **didaktiko-metodologjike** të ndryshme për arsimin fillor, të mesëm dhe atë universitar. Prandaj qeveria jonë do të krijojë tri platforma shtetërore për mësim në distancë, si:

- Platformë shtetërore për mësim në distancë për shkollat fillore;
- Platformë shtetërore për mësim në distancë për realizimin e mësimin në shkollat e mesme si dhe
- Platformë e avancuar shtetërore për mësim në distancë për realizimin e mësimin në universitete.



Këto platforma do të jenë të lehta për t'u përdorur, me veçori të disponueshme për përdorim në platforma të ndryshe, si dhe me shpejtësi optimale të aksesit në internet. Këto platforma do të jenë të sigurta, do të integrohen me sisteme për filtrim të përmbajtjeve, si dhe me nivel të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale të përdoruesve.

Këto platforma shtetërore do të jene plotësisht të integruara me të gjitha sistemet e tjera që lidhen me procesin arsimor (ditari elektronik, librat elektronikë, sistemet e bibliotekave, video biblioteka arsimore, sistemet e testimit, si dhe sistemi i menaxhimit me procesin arsimore në nivel shtetëror).

Për t'u arritur një integrim i tillë në sistem duhet të përmirësohet dukshëm **sistemi për identifikim elektronik**, përkatësisht të bëhet operacionalizimi i një **Qendër Shtetërore për Autentifikim dhe Autorizim**. Në këtë mënyrë secili pjesëmarrës në këtë proces, qoftë nxënës, student ose arsimtar, do të ketë një identifikues të vetëm



për t'u përdorur dhe për të hyrë në të gjitha sistemet e integruara.

**Kështu mësimi në distancë nuk duhet të jetë vetëm një opsion rezervë, që do të shfrytëzohet** në rrethanat të jashtëzakonshme, por ai do të duhet të jetë pjesë e integruar e sistemit arsimor në RMV. Për këtë qëllim qeveria jone do t'i krijojë sistemet e lartpërmendura për mësim në distancë, ndërsa ato do të përdoren dhe do të jenë pjesë integruese edhe gjatë procesit arsimor tradicional. Më saktë, orët plotësuese dhe ato shtuese do të jenë të detyrueshme të realizohen në distancë dhe ato do të notohen dhe evaluohen nga Qendra Shtetërore për Mësim në Distancë. Pra, mësimi në distancë gjatë qeverisjes sonë do të jetë **një proces paralel që e plotëson mësimin klasik dhe i përgatit nxënësit dhe studentët për shoqërinë e re digjitale**. Këtë janë arsyet se pse është në interes kombëtar të ndërtojmë një platformë të tillë shtetërore dhe të fillojmë përdorimin e saj rregullisht edhe gjatë mësimin klasik (tradicional). Kështu do të mundësojmë që kalimi nga mësimi klasik në mësim në distancë të mos jetë një proces stresues dhe kompleks, si dhe do të lejojë që arsimit të funksionojë pa probleme edhe në raste urgjente.

Një platformë e tillë kërkon investim serioz, si në aspektin financiar, ashtu edhe në aspektin e analizës dhe optimizimit të të gjitha zgjidhjeve ekzistuese dhe sistemeve që duhet të integrohen në këto platforma. Për më tepër, një zgjidhje e tillë shtetërore sigurisht se do të kërkojë mbështetje të vazhdueshme, duke pasur parasysh që është një numër i madh i përdoruesve. Për këtë arsye do ta krijojmë **Qendrën Shtetërore për Mësim në Distancë**.

- **Platforma shtetërore për mësim në distancë për shkollat fillore.** Duke pasur parasysh moshën dhe qasjen didaktiko-metodologjike, në vitin e parë të qeverisjes do të ngrihet një platformë shtetërore për realizimin e mësimin nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Kjo platformë do të mundësojë qasje të nxënësve dhe arsimtarëve në materialet multimediale dhe menaxhimin e sistemit mësimor nëpërmjet Sistemit për Menaxhimin e Mësimin (LMS), ndërsa do të jetë kanal edhe për krijimin e klasave virtuale. Kjo platformë do të jetë e sigurt, e lehtë për përdorim dhe me veçori të disponueshme për shfrytëzim në platforma të ndryshme. Përveç sigurisë, ajo që do ta garantojë kjo platforme është sistemi i integruar për filtrim të përmbajtjeve, si dhe një nivel i lartë i mbrojtjes së të dhënave personale të përdoruesit. Kjo platformë do të jetë plotësisht e integruar edhe me sistemet e tjera që lidhen me procesin arsimor për shkollat fillore, si: ditari elektronik, librat elektronike, sistemet e bibliotekave, video-biblioteka arsimore, sistemet e testimit, si dhe sistemi i menaxhimit me procesin arsimor në nivel shtetëror.
- **Platforma shtetërore për mësim në distancë për realizimin e mësimin në shkollat e mesme.** Kjo platformë shtetërore do të mundësojë realizimin e mësimin në distancë për shkollat e mesme. Ky sistem shtetëror do të mundësojë jo vetëm mësimin në distancë, por edhe personalizimin e

mësimin për çdo nxënësi dhe përdorues të regjistruar në sistem, me qëllim të personalizimit të dinamikës së mësimin. Kjo platformë do të mundësojë edhe testimin e njohurive në kohë reale, si dhe realizimin e provimit të maturës. Kjo platformë do të mundësojë qasje të nxënësve dhe arsimtarëve në materialet multimediale dhe menaxhimin e sistemit mësimor nëpërmjet Sistemit për Menaxhimin e Mësimin (LMS), ndërsa do të jetë kanal edhe për krijimin e klasave virtuale. Kjo platformë do të jetë e sigurt, e lehtë për përdorim dhe me veçori të disponueshme për shfrytëzim në platforma të ndryshme. Përveç sigurisë, ajo që do ta garantojë kjo platforme është sistemi i integruar për filtrim të përmbajtjeve, si dhe një nivel i lartë i mbrojtjes së të dhënave personale të përdoruesit. Kjo platformë do të jetë plotësisht e integruar edhe me sistemet e tjera që lidhen me procesin arsimor për shkollat e mesme, si: ditari elektronik, librat elektronike, sistemet e bibliotekave, video-biblioteka arsimore, sistemet e testimit, si dhe sistemi i menaxhimit me procesin arsimor në nivel shtetëror.



- **Platforma e avancuar shtetërore për mësim në distancë për realizimin e mësimin në universitete.** Platforma shtetërore për mësim në distancë për arsimin universitar do të mundësojë që universitetet, si ato shtetërore, ashtu edhe ato private, ta shfrytëzojnë këtë platformë si resurs për menaxhim me proceset akademike, që lidhen drejtpërdrejt me mësimin në distancë në ciklin deridiplomik, posdiplomik dhe shkollën e doktoratës. Ky sistem do të mundësojë personalizimin e mësimin për çdo përdorues të regjistruar me qëllim të personalizimit të dinamikës së mësimin, si dhe krijimin e folderit personal për çdo lëndë dhe material shkencor. Kjo platformë do të ofrojë

gjithashtu mundësi për testim dhe evaluim të njohurive të studentëve, si dhe verifikimin e plotë të plagjiaturës për punime të diplomave, punimeve master dhe të doktoratave. Platforma shtetërore do të mundësojë qasje të studentëve dhe profesorëve në materialet multimediale dhe menaxhimin e sistemit mësimor nëpërmjet Sistemit për Menaxhim të Nësimit (LMS), si dhe kanal për krijimin e klasave virtuale. Kjo platformë do të jetë e sigurt, e lehtë për përdorim dhe me veçori të disponueshme për shfrytëzim në platforma të ndryshme. Përveç sigurisë, ajo që do ta garantojë kjo platforme është sistemi i integruar për filtrim të përmbajtjeve, si dhe një nivel i lartë i mbrojtjes së të dhënave personale të përdoruesit. Platforma shtetërore do të jetë plotësisht e integruar edhe me sistemet e tjera që lidhen me proceset arsimore universitare, siç janë: baza shtetërore dhe intershtetërore me libra elektronikë, sistemet e bibliotekave shtetërore dhe intershtetërore, qasja në baza të ndryshme profesionale etj., video-biblioteka shtetërore për mbrojtje të magjistraturës dhe doktoratës, sistemet e testimit, si dhe sistemi i rangimit shtetëror për institucionet e larta arsimore në RMV.



- **Qendra Shtetërore për Autentifikim dhe Autorizim.** Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës ka krijuar një sistem shtetëror për identifikim elektronik, por ai lë shumë për të dëshiruar. Prandaj ne, në dy vitet e para, do ta krijojmë qendrën shtetërore për autentifikim dhe autorizim. Nëpërmjet kësaj qendre secili pjesëmarrës në proceset digjitale do të pajiset me një identifikues të vetëm. Nëpërmjet këtij identifikuesi do të mund të përdoren të gjitha sistemet shtetërore. Ky sistem do të ndihmojë edhe në gjenerimin, në kohë reale, të raporteve dhe të dhënave për secilin sektor shtetëror në RMV, me çka do të lehtësohet dukshëm krijimi i politikave shtetërore në përputhshmëri me nevojat dhe kërkesat reale.
- **Kompetencat bazike për ligjërime në distancë.** Në vitin e parë të qeverisjes do të krijohet një bazë me module për ligjërime në distancë. Çdo mësimdhënës, si në nivelin e arsimit fillor, të mesëm dhe universitar, do të duhet të certifikohet për ligjërime në distancë. Qëllimi i këtyre dhuntive është që ligjëruesit të aftësohen për përdorim të platformave shtetërore për mësim në distancë, si dhe krijimin e syllabuseve në pajtim me kërkesat dhe standardet botërore për mësim në distancë.
- **Edukimi digjital.** Në vitin e parë të qeverisjes do të krijohet një platforme shtetërore për edukim digjital për secilin qytetar të RMV-së deri në moshën 70-vjeçare. Do të krijohen disa module për edukim qytetare, në mënyrë që secili qytetar t'i ndjekë ato në distancë ose në qendrat për trajnim në çdo qytet. Varësisht nga mosha dhe shkollimi secilit qytetar do t'i definohen module që do të duhet të ndiqen. Pas çdo moduli do të ketë testim me çka pas kalimit me sukses të këtij testi qytetari do të pajiset me certifikatë për edukim digjital.

- **Qendra Shtetërore për Mësim në Distance:** Gjatë vitit të parë të qeverisjes do ta formojmë Qendrën për Mësim në Distance, e cila do të ketë strukturë të ngjashme si Byroja për Zhvillimin e Arsimit, por me fokus të veçantë në mësimin në distancë. Kjo qendër shtetërore për mësim në distancë do t'i menaxhojë dhe koordinojë proceset, format, strukturën dhe metodologjinë për mësim në distancë për të gjitha nivelet arsimore në shtet, që nga ai fillor, i mesëm dhe universitar. Kjo qendër, përveç administratës, do të ketë edhe inspektor shtetëror (ekspert) për mësim në distancë, të cilët do të bëjnë trajnime permanente për të gjithë të punësuarit në sektorin e arsimit në RMV. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj qendre, do të menaxhohen trajnimet në masë për qytetarët me qëllim të edukimit të tyre joformal me dhunti bazike për menaxhim me procese digjitale.
- **Internet për çdo nxënës të shkollës fillore dhe të mesme EduIN.** Gjatë vitit të parë të qeverisjes, në bashkëpunim me sektorin privat dhe Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, do ta krijojmë pakon për qasje në internet për të gjithë të punësuarit në shkollat fillore dhe të mesme dhe nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme. Ideja është të krijohet një paket EduIN për qasje stabile dhe me performansa optimale të qasjes në internet për këto dy kategori.
- **Video-biblioteka arsimore.** Krijimi i video-bibliotekës arsimore është menduar që gjatë dy viteve të para për çdo njësi arsimore për shkollat fillore të krijohet një material multimedial. Ndërkaq gjatë vitit të tretë dhe të katërt të qeverisjes kjo bibliotekë do të kompletohet me të gjitha video-materialet e nevojshme për arsimin fillor dhe të mesëm.

## Forcimi i qeverisjes në sistem arsimor

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternativA do ta reformojë qeverisjen e sistemit arsimor për ta përsheptuar kështu modernizimin në të gjitha nivelet përmes përmirësimit të infrastrukturës, kurrikulave dhe kualifikimeve të mësuesve.

- **Portofoli arsimor nëpërmjet sistemit shtetëror për autentifikim dhe autorizim.** Me qëllim të optimizimit të proceseve administrative për ndjekjen e zhvillimit arsimor të qytetarëve, ky sistem do t'i pajisë të gjithë nxënësit dhe studentët me kredenciale të përdoruesit që do t'i përdorin gjatë të gjitha cikleve të procesit arsimor. Ky sistem, gjithashtu, do jetë i kapshëm edhe për shërbime tjera që lidhen me arsimin, si: bursat, radhitja e institucioneve, plagjiaturat, bibliotekat, subvencionet etj. Realizimi i tij do të kërkojë integrimin e sistemeve IT të Ministrisë së Arsimit dhe të Ministrisë së Shoqërisë Informativë dhe Administratës, gjë që do të zbatohen në dy vitet e para të qeverisjes sonë.
- **Letërnjoftimi për çdo institucion arsimor prej atij parashkollor deri tek ai universitar.** Në 100 ditët e para të qeverisjes sonë do të krijojmë një pasqyrë të qartë për gjendjen strukturore të shkollave për të krijuar një strategji për intervenime. Me formularë të veçantë do të evidentohet dhe pasqyrohet gjendja në çdo institucion shkollor, duke u nisur nga hapësirat ku realizohet mësimi, kabinetet, objektet sportive, koha e ndërtimit të objekteve, amortizimi, intervenimet e ndryshme pas ndërtimit, kuadri mësimor, numri i nxënësve nëpër paralele për tre vitet e fundit, mbrojtja nga zjarri dhe fatkeqësitë e ndryshme etj.
- **Tutorimi në arsimin fillor dhe të mesëm.** Sot mësimdhënësit obligohen me ligj që të mbajnë orë shtesë dhe orë plotësuese për nxënësit e talentuar dhe nxënësit me probleme në lëndë të ndryshme. Fatkeqësisht, kjo masë nuk dha rezultate praktikenë arsim. Futja e konceptit të tutorimit në arsimin fillor dhe të mesëm do ta ndihmojë shumë sistemin arsimor në disa këndvështrime. Ashtu do të mund të akreditoheshin për tutor ligjëruesit me përvojë pune dhe me performansa pozitive, por edhe profesionistët nga bota e punës, si dhe pensionistët që dëshirojnë të japin kontribut. Tutorët që do të punojnë me nxënës të talentuar do të duhet të marrin detyrimisht pjesë në gara me grupin e tyre, ndërsa tutorët që do të punojnë me fëmijë me vështirësi në lëndë do të maten në performansën e tyre në bazë të lehtësimit të materialit për këta fëmijë dhe kalueshmërisë pozitive.
- **Certifikimi i mësimdhënësve me certifikatë në IT.** Sot mësimdhënësit obligohen me ligj që të mbajnë orë të teknologjisë informative dhe të

komunikimeve, por në praktikë këto orë nuk shkojnë përtej prezantimeve Powerpoint, duke dështuar kështu në aftësimin e nxënësve. Certifikimi i mësimdhënësve me certifikatë ndërkombëtare për njohje të aftësive në IT do ta lehtësonte dukshëm këtë proces.

- **Studime universitare modulare.** Korniza ligjore për arsimin e lartë është jofunksionale dhe ajo duhet të ndryshojë urgjentisht për të lejuar më tepër fleksibilitet në universitete, duke krijuar kështu mundësi ligjore për studime modulare. Studimet modulare do të mundësojnë që ligjëruesit universitarë që i kemi në mërgatë të punojnë si profesorë me orar të pjesshëm në universitetet e vendit.
- **Fuqizimi i rolit të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit** në kuptim që të mbahet llogari deri në maksimum dhe pa asnjë tolerancë për cilësinë e arsimit.
- **Krijimi i Fondit për Zhvillimin e Shkencës** si fond special për hulumtime shkencore, për projekte shkencore dhe për botime shkencore.
- **Rritja e rrogës së punonjësve të arsimit dhe shkencës,** në mënyrë që rroga e tyre t'i përmbushë nevojat e standardit jetësor dhe të jetë e përafërt me rrogat që marrin punonjësit e arsimit në vendet tjera europiane.





## Rritja e përputhshmërisë midis arsimit dhe nevojave të tregut të punës

Mungesa e aftësive të duhura të fuqia punëtore zakonisht raportohet si një nga problemet kryesore me të cilën përballen punëdhënësit. Fakti që një të riu i duhen mesatarisht 31 muaj nga koha e diplomimit për të gjetur një punë të qëndrueshme e dëshmon këtë konstatim dhe flet për një problem të theksuar në kalimin nga arsimit në tregun e punës. Kjo gjë gjeneron një humbje të rëndësishme në PBV në plan afatshkurtër, si dhe në kapitalin njerëzor të vetë të rinjve në plan afatgjatë. Për ta adresuar mungesën e përputhshmërisë midis arsimit dhe nevojave të tregut të punës, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternativA angazhohet për masat në vijim:

- **Afirmimi i arsimit profesional.** Orientimi i nxënësve në shkolla të mesme duhet të jetë në shkollat profesionale, sepse në kushtet e BE-së, secili qytetar me shkollë të mesme dhe me një profesion të përvetësuar mund të gjendet në tregun e punës. Selektimi dhe orientimi i nxënësve duhet të bëhet sipas njohurive dhe aftësive të treguara në arsimin fillorë.
- **Riorganizimi i universiteteve.** Studimet universitare duhet të sistemohen dhe riorganizohen në drejtim të ngritjes së cilësisë dhe në drejtim të plotësisë të nevojave të shtetit për kuadro profesionale dhe të nevojshme për tregun e nevojshëm të punës. Synimi jonë është që arsimit të zhvillohet konform nevojave zhvillimore që do t'i ketë shteti.

- **Ndryshimi dhe plotësimi i legjislacionit për arsim të të gjitha niveleve** (arsimi parashkollor, fillor, i mesëm dhe sipëror).
- **Fuqizimi i Agjencisë së Shërbimit të Punësimit.** Do t'i forcojmë kapacitetet e Agjencisë, duke i rritur burimet e saj njerëzore dhe financiare, veçanërisht nëpër qendrat rajonale jashtë Shkupit. Do ta përmirësojmë sistemin informativ të tregut të punës së Agjencisë, duke përfshirë shkëmbimin e informacioneve për vendet vakante nëpër rajone dhe përmirësimin e kapaciteteve të monitorimit dhe vlerësimit. Do të inkuadrojmë standardizimin e profilizimit të punëkërkuësve për të përmirësuar kështu shënjestrimin dhe efikasitetin e kostos së Agjencisë. Gjithashtu, do të përfshijmë edhe ndjekjen sistematike të rezultateve në tregun e punës të punëkërkuësve pas kontaktit fillestar me Agjencinë.
- **Operacionalizimi i observatorit të tregut të punës** dhe aftësive ose krijimi i një sistemi informativ për tregun e punës, që do të jetë përgjegjës për monitorimin e evolucionit të kërkesës për aftësi dhe kompetenca të caktuara, si dhe identifikimi i aftësive deficitare.
- **Punë praktike për studentë në institucionet publike.** Çdo institucion i lartë shtetëror do të obligohet të ketë së paku dy praktikantë çdo vit me pagesë në nivel të rrogës minimale. 20 studentët më të mirë do të sistemohen për punë praktike në nivelet më të larta të administratës së shtetit, si p.sh. në Kuvend, në Presidencë, në Zyrën e Kryeministrit, nëpër ministri etj.
- **Lehtësimi i përvetësimit të përvojës profesionale gjatë shkollimit.** Një e treta e studentëve të arsimit profesional dhe të diplomuarve të arsimit të lartë nuk marrin pjesë në asnjë praktikë gjatë kohës së studimeve. Prandaj ne do të zbatojmë praktikantë detyrueshme për studentët e arsimit të lartë dhe profesional me masa shoqëruese të kontrollit të cilësisë. Gjithashtu do ta ndryshojmë ligjin që e ndalon punësimin formal me orar të plotë të studentëve gjatë viteve të arsimimit të rregullt dhe do të zbatojmë subvencione ose përfitime tatimore për ta stimuluar marrjen e praktikantëve nga punëdhënësit.
- **Përmirësimi i orientimit në karrierë për të rinjtë.** Do ta gjeneralizojmë krijimin e qendrave të orientimit në karrierë për të gjitha shkollat profesionale dhe do bëjmë ta detyrueshëm zbatimin e planit të karrierës për secilin student në arsimin profesional. Gjithashtu do t'i përmirësojmë shërbimet e karrierës nëpër universitare, duke siguruar qasje më të mirë në informacione në lidhje me nivelin e pagave dhe kushtet e punës për secilën veprimtari dhe profesion.
- **Subvencione për trajnime të avancuara në fushën e IT-së,** kjo me qëllim të përmirësimit të aftësive të të rinjve në fushën e teknologjive të informacionit

për ta përmirësuar kështu performansën e tyre dhe për ta rritur konkurrencën në tregun e punës. Për këtë qëllim do të krijohen paketa modulare me teknologji që i kërkon tregu dhe me aftësi të buta në IT, që ato janë kompatible me nevojat e tregut.

- **Krijimi i universiteteve aplikative.** Si shtet me resurse të limituara, Maqedonia e Veriut ka nevojë për zanatçinj me shkathtësi dhe dhunti aplikative, të cilët – për fat të keq – mungojnë ngase sistemi arsimor nuk e mundëson krijimin e këtyre profileve. Arsimimi i ofruar nga shkollat e mesme profesionale nuk mjafton në këtë drejtim dhe vendi ka nevojë për kompletim të ekosistemit të shkollimit, si dhe për përputhje më të madhe të aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës. Krijimi i universiteteve aplikative, potencialisht në formë të partneritetit publik privat, do të kompletojë këtë boshllëk. Paraprakisht do të nevojitet edhe ndryshimi i kornizës ligjore për arsimin e lartë dhe një analizë e tregut të punës për t'i definuar profesionet më të nevojshme në vend.
- **Krijimi i ekosistemit për inovacion në universitete.** Transferimi i teknologjive në universitete lë shumë për të dëshiruar. Edhe pse fondi për inovacion i ndihmon kompanitë spin-off, problemi kryesor është Ligji për arsim të lartë, ku nuk janë definuar qartë proceset për ta ndihmuar ekosistemin inovues në arsimin e lartë. Prandaj do të ndryshojë Ligji për arsimin e lartë, për të krijuar mundësi për definimin e portofolit të profesorëve universitarë (aplikativë, teorikë, aplikativë-teorikë), krijimin e akseleratoreve në çdo universitet dhe krijimin e parqeve teknologjike me konceptin e partneritetit publiko-privat.
- **Përfshirja e kompanive në hartimin e kurrikulave dhe orientimin profesional të të diplomuarve.** Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të iniciojë bashkëpunim permanent midis kompanive dhe institucioneve të arsimit të lartë dhe atij profesional në lidhje me hartimin e kurrikulave, vlerësimin permanent të nevojave të tregut të punës dhe informimeve studentëve për mundësi të zhvillimit të karrierës në sektorin privat. Do të krijojmë edhe një strukturë të qëndrueshme për përfshirjen e punëdhënësve në hartimin e kurrikulave në shkollat profesionale, siç janë tryezat e rregullta çdo gjashtë muaj ose konsultimi i domosdoshëm i punëdhënësve kur propozohen ndryshime në kurrikula. Një masë tjetër në këtë drejtim do të jetë riaktivizimi i këshillave ekonomike lokale, që do të përfshijnë përfaqësues nga sektori privat për të hartuar kurrikula të përshtatura me nevojat e sektorit privat.
- **Bursa profesionale.** Të rinjtë që regjistrohen në shkolla të mesme profesionale do të përfitojnë bursë mujore prej 3000 denarë për një periudhë prej 9 muajsh, me mundësi angazhimi part-time në ndërmarrjet e vendit.



## Shëndetësia

### Pa popullatë të shëndoshë s'ka as rritje ekonomike, as cilësi jetese.

Sfidat shëndetësore, me të cilat sot ballafaqohet vendi ynë, janë të ndërlidhura me një sërë faktorësh socialë, ekonomikë dhe mjedisorë, të cilët kërkojnë një analizë më të detajuar për përgatitjen e programeve dhe strategjive shtetërore gjithëpërfshirëse të sistemit tonë shëndetësor dhe sektorëve që ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në këtë sistem, me qëllim të rritjes së efikasitetit në përballjen me këto sfida dhe me synim për përmirësimin e shërbimit shëndetësor dhe mjekësor sa më cilësor të popullsisë për mirëqenie dhe ngritje të cilësisë së jetesës.

Ne do t'i përcaktojmë prioritetet dhe objektivat për realizimin e misionit dhe të vizionit tonë për shëndetësi në përputhje me Kornizën Europiane të OBSH-së për shëndetin dhe mirëqenien.

Koalicioni ynë synon një sistem shëndetësor, i cili do të jetë i përkushtuar ndaj shëndetit të popullit tonë si një e drejtë njerëzore dhe e mirë publike me ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve dhe cilësinë e jetës së tyre.

Ruajtja e shëndetit dhe parandalimi i sëmundjeve është përgjegjësi kolektive, por përsëri rolin udhëheqës e ka shteti. Ai, përmes veprimeve të organizuara, e shpërndan ndikimin në të gjitha grupet e popullatës, ndërsa institucionet mjekësore e bëjnë monitorimin e gjendjes shëndetësore të popullatës për t'i identifikuar problemet, faktorët e riskut, zhvillimin e politikave, përforcimin e ligjeve dhe rregulloreve për


mbrojtjen e shëndetit, informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e popullatës për problemet që lidhen me shëndetin.

Në këtë kuptim, pasojat e shkaktuara nga pandemia e infeksionit me virusin SARS COV2 dëshmuar se shteti, me institucionet shëndetësore, dështuan në menaxhimin e kësaj situate. Ky dështim erdhi si pasojë e neglizhencës dhe gabimeve konceptuale për të sotmen e shëndetësisë sonë dhe mungesës së vizionit për zhvillimin e saj në përputhshmëri me nevojat dhe objektivat që i kërkon e sotmja dhe e nesërmja e shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve tanë.

Nisur nga kjo, Koalicioni do të tregojë kujdes të veçantë duke ndërmarrë veprime shumëdimensionale për përmirësimin dhe ruajtjen e shëndetit të popullatës sonë.

Gjithashtu ne do të tregojmë kujdes të veçantë për edukimin shëndetësor të popullatës, parandalimin dhe kontrollin e përdorimit abuziv të produkteve të dëmshme për shëndetin, siç janë lëndët narkotike, duhani, alkooli etj., por edhe kontrollin e rreptë të ushqimeve për sigurinë e tyre dhe edukimin fizik. Koalicioni do t'i kushtojë vëmendje të veçantë shëndetit mjedisor, shëndetit në punë dhe do të sigurojë që të respektohen në përpikëri të gjitha rregulloret dhe ligjet për mosdëmtimin e shëndetit.

Gjatë qeverisjes së tij koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do t'i zbatojë masat në vijim.



## Masat për përballjen me pandeminë COVID-19 dhe situata te ngjashme

- **Do ta praktikojmë seroprevencën** – testime masive serologjike për të krijuar pasqyrë adekuate epidemiologjike të të infektuarve në nivel shtetëror.
- Përveç Spitalit të Qytetit “8 Shtatori” në Shkup, **edhe spitalet klinike në vend ose spitale të tjera, të cilët i plotësojnë normat, do t'i trajtojnë pacientët që janë pozitivë në SARS CoV 2.**
- Nga profesionistë të specializuar me program të përpiluar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë do të bëjmë **trajnimin e vazhdueshëm të personelit shëndetësor** në nivel të shtetit për t'u përballur me sëmundjet ngjitëse.
- **Do të evidentohen personat me rrezik të shëndetit mendor si pasojë e pandemisë** dhe do të konsultohen nga psikologu, punëtorët socialë ose psikiatri, ndërsa familjarët do të informohen se si mund t'i ndihmojnë njerëzit e tyre të afërt që kanë shqetësime të tilla.
- **Do të ofrojmë specializime që në çdo vendbanim urban të ketë minimum nga një epidemiolog, infektolog dhe anesteziolog, si dhe po ashtu të rritet numri i instituteve të shëndetit publik me kuadër adekuat sipas udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.**
- **Repartet infektive në Spitalin Klinik të Tetovës dhe spitaleve të tjera urgjentisht do të renovohen** dhe do të angazhohemi për kompletimin e tyre me kuadro adekuate. Po ashtu do të hapen reparte të reja infektologjike nëpër vendbanime që i plotësojnë protokollet e OBSH-së.
- **Do t'i rishikojmë dhe riorganizojmë rezervat shtetërore të mjeteve mbrojtëse** për personelin mjekësor dhe do ta stimulojmë prodhimin e tyre vendor.

## Reforma për qasje të barabartë dhe cilësi në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor publik

- **Do t'i bashkojmë shtëpitë e shëndetit me spitalet e përgjithshme të qytetit,**

**me përjashtim të Qytetit të Shkupit.** Kjo do të sigurojë funksionalitet më të mirë dhe ulje të shpenzimeve shëndetësore.

- **Është i domosdoshëm krijimi i qendrave mjekësore rajonale.** Do ta bëjmë analizën dhe do ta përgatisim dokumentacionin e nevojshëm për realizimin sa më të shpejtë të këtyre qendrave.
- **Në vitin e parë të qeverisjes sonë do të iniciojmë riorganizimin e klinikave universitare me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës së tyre,** e cila do të rezultonte edhe me kursimin e shumë mjeteve, duke i anuluar drejtorët organizativë, disa drejtorë mjekësorë dhe këshillat drejtues, që u treguan joefikasë në punën e institucioneve përkatëse.
- **Digjitalizimi i plotë i sistemit shëndetësor - Integrimi i sistemit shëndetësor** dhe zhvillimi i kartelës shëndetësore, në të cilën do të përfshihet dosja (historia) e pacientit dhe ajo do të shërbejë si dokument i vetëm që pacienti do ta përdor në gjithë sistemin shëndetësor, nga shërbimi të mjeku amë, në shërbimin sekondar, terciar, e deri të marrja e medikamenteve në barnatore.
- **Do ta rishikojmë zbatimin e partneriteteve publiko-private në shëndetësinë publike,** duke hapur debat publik e transparent rreth mënyrës së zbatimit të tyre dhe parimeve të futjes së kapitalit privat në institucione shëndetësore publike.

## Më tepër burime njerëzore të kualifikuara dhe përfaqësuese

- **Në 6-mujorin e parë të qeverisjes sonë do të hartojmë hartë elektronike të institucioneve shëndetësore publike,** ku në mënyrë transparente do të identifikohen dhe paraqiten vendet e lira të punës. Të gjithë mjekëve të rinj do t'u ofrohen vende pune, ndërsa kriteri kryesor do të jetë i bazuar në nevojat e sistemit shëndetësor dhe nivelin e përgatitjes së tyre profesionale.
- **Do të angazhohemi për rritje lineare dhe kolektive të pagave,** pa përjashtime, përfshirë edhe pagat e bashkëpunëtorëve shëndetësor, personelit teknik ndihmës dhe administratës së institucioneve shëndetësore publike.
- **Do të angazhohemi për stimulimin e mjekëve të sektorit primar për të punuar në rajonet rurale,** kjo me qëllim të mbulimit sa më të madh të popullatës me shërbime mjekësore cilësore dhe të arritshme.
- **Do të angazhohemi që fakultetet e mjekësisë t'i organizojnë "Ditën e**

**karrierës",** ku studentët e viteve të fundit të studimeve do të njoftohen me mundësitë e punësimit dhe përparimit brenda sistemit shëndetësor publik. Do të kërkojmë që 10 studentëve më të mirë të gjeneratës në fakultetet e mjekësisë t'u ofrohet punësim pa procedura në klinikat, institutet dhe qendrat e tjera spitalore.

- **Do të miratojmë Ligj për veprimtarinë e mjekut,** kjo me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës dhe sigurisë juridike dhe fizike. Ligji do të hartohet në bashkëpunim me Odën e Mjekëve, shoqatat e mjekëve dhe punëtorëve e bashkëpunëtorëve shëndetësorë.



- **Të gjithë mjekët e rinj do të punësohen dhe do të përpiqemi që sa më parë, varësisht nga kapacitetet e klinikave, edhe ata të specializohen.** Specializantëve privatë, pas përfundimit të specializimit, do t'u krijohen lehtësi punësimi në institucionet shëndetësore publike.
- **Stimulimin e mjekëve femra për të specializuar në fushën e gjinekologjisë.** Për shkak të nevojës së madhe të popullatës femra për gjinekologe të specializuara, do të insistojmë në veçanti në përsosjen dhe specializimin e mjekëve në fushën e gjinekologjisë.
- **Do të angazhohemi për edukimin permanent mjekësor (CME) brenda dhe jashtë vendit të personelit mjekësor në të gjitha nivelet e sistemit.** Do të kujdesemi në veçanti për edukimin e vazhdueshëm të kuadrove tanë, si dhe pjesëmarrjen e tyre në studime klinike dhe konferenca ndërkombëtare.



## Një infrastrukturë shëndetësore që u përgjigjet nevojave të pacientit.

- Do të angazhohemi për përshpejtimin e procesit të ndërtimit të qendrës së re klinike universitare “Nënë Tereza” në Shkup sipas standardeve ndërkombëtare, si institucioni më i rëndësishëm shëndetësor në vend.
- Në mandatin tonë qeverisës do të investojmë 30 milionë euro në Spitalin Klinik të Tetovës për ta sanuar gjendjen e rëndë në infrastrukturë dhe në ekipimin profesional, gjë që ka ardhur për shkak të nepotizmit dhe ndikimit të madh të politikës ditore në konkurset për punësim. Ky institucion i rëndësishëm në fushën e Pollogut, por edhe më gjerë, përveç shërbimeve shëndetësore, luan rol edhe në procesin edukativo-arsimor në nivelin e studim-shkollimit mjekësor universitar (Fakultetin e Shkencave Mjekësore në UT) dhe atë të mesëm, andaj si i tillë do të jetë prioritet i lartë i koalicionit Aleanca për Shqiptarët dhe AlternAtivA.
- Zhvillimi i Heliodromit në klinikën universitare, si dhe bashkëpunimi me klinikat në shtetet tjera në mënyrë që pacientët të mund të transportohen me helikopter nga vendet fqinje.
- Parkingu i klinikës do të kthehet në pronësi të Ministrisë së Shëndetësisë, nga të ardhurat e të cilës do të përfitoj Qendra Klinike Universitare. Do të

sigurohet organizimi dhe monitorimi efikas i tij, kjo me qëllim të parandalimit dhe shmangies së abuzimeve të mundshme korruptive.

- Gjatë tërë qeverisjes sonë do të investojmë në renovimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së vjetruar në spitalet e qyteteve në Kërçovë, Gostivar, Strugë, Dibër dhe Kumanovë.
- Do të hapim qendra për mjekësi urgjente në të gjitha vendbanimet e mëdha dhe do të investojmë më tepër burime financiare në preventivë dhe diagnostifikim të shpejtë.
- Krijimi dhe edukimi i të a.q. para medici, që do të punojnë në terren në suaza të ndihmës së shpejtë, kjo me qëllim të rritjes së efikasitetit të këtij shërbimi.
- Themelimi i një qendre për menaxhim-eliminimin e mbetjeve medicinale.

## Financimi i sistemit në përputhje me nevojat e pacientit dhe masa shtesë për një sistem më të drejtë dhe efektiv

- Do të krijohet sistem i drejtë dhe efikas për planifikimin dhe miratimin e buxhetit vjetor në institucionet publike shëndetësore, duke respektuar numrin e banorëve, gravitimin e pacientëve në spitalet përkatëse dhe nevojat e tjera reale që i kanë këto institucione.
- Do ta analizojmë punën e Fondit të Sigurimit Shëndetësor dhe të komisioneve shëndetësore dhe varësisht nga rezultati i analizës do të bëjmë ndryshimet e nevojshme me qëllim të rritjes së efikasitetit të tyre.
- Do të angazhohemi që lista pozitive të pasurohet me preparate inovatore, për ta rritur kështu mundësinë për barna cilësore, të sigurta dhe të efektshme.
- Te gjithë të sëmurët me sëmundje fatale për jetën do të lirohen nga participimi për shërbimet mjekësore në të gjitha institucionet publike.
- Adaptimi i ligjit dhe zhvillimi i bashkëpunimit me shtetet fqinje. Do të ndryshojë rregullorja e pagesave për shërbimet shëndetësore për shtetasit e shteteve të huaja, me të cilat nuk kemi marrëveshje bashkëpunimi, që ata për këto shërbime në vendin tonë të paguajnë njëllë si një shtetas i yni pa sigurim shëndetësor (privat). Kështu do të rritet edhe fluksi i pacientëve shtetas të huaj në institucionet shëndetësore publike.



- **Përgatitja e një ligji të ri për mbrojtje shëndetësore** sipas nevojave tona dhe standardeve bashkëkohore.
- **Të inicohen memorandum bashkëpunimi me klinika me renome**, në mënyrë që të sillen ekspertë që do të punojnë dhe edukojnë kuadrot tona mjekësore.
- **Do të ndërtojmë mekanizma efikasë për kthimin e dinjitetit të Odës së Mjekëve**, që është organizatë e pavarur profesionale për mbrojtjen dhe përparimin e profesionalizmit, për përmirësimin e cilësisë së mbrojtjes shëndetësore, monitorimin e marrëdhënies së punëtorëve shëndetësorë ndaj qytetarëve, si dhe për mbrojtjen e interesave të profesionit të mjekut.

Ne jemi të vetëdijshëm se shëndeti nuk është thjesht një e drejtë njerëzore, por ai është i domosdoshëm për rritjen ekonomike të një vendi. Si i tillë, ai është investim për të ardhmen. Prandaj, për ne do të jetë një nga prioritetet e qeverisë së bashku me sektorët e tjerë që kanë lidhshmëri me shëndetin.

## Një politikë bashkëkohore e punës dhe e çështjeve sociale

Sistemet e mbrojtjes sociale duhet të mbrojnë qytetarët nga rreziqet sociale dhe ta promovojnë mirëqenien e tyre. Të dhënat për Maqedoninë e Veriut flasin se sistemet e mbrojtjes sociale nuk janë mjaftueshëm efektive në trajtimin e niveleve të larta të pabarazisë në të ardhura dhe rrezikut për të rënë në varfëri. Sipas statistikave të vitit 2017, rreziku për të rënë në varfëri në vendin tonë ishte prej 22.2% në nivelin e popullsisë së përgjithshme, 9% për të punësuarit dhe 7% për pensionistët. Ndërkohë, sipas sindikatave të RMV-së, shporta e konsumatorit për një familje 4-anëtarëshe arrin vlerën prej 33000 denarë.


Niveli i ulët i transferave të ndihmës sociale drejt atyre që kanë më së shumti nevojë vazhdon të mbetet një problem serioz. Benefitet sociale janë aq të vogla, sa në shumicën e rasteve ato nuk ndikojnë në statusin e varfërisë së përfituesve. Një karakteristikë tjetër e sistemit të ndihmës sociale është mbulimi i dobët i popullatës për shkak të rregullave kufizuese për përfitime sociale. Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës, vetëm 12% e qytetarëve tanë të papunë pranojnë benefite të papunësisë.

Masat e marra nga qeveria në largim ishin të sipërfaqësore dhe të pamjaftueshme. Megjithatë shumica e ndihmës sociale për familjet në nevojë u përshtat me koston e jetesës, ajo është akoma e pamjaftueshme për t'i mbuluar kërkesat e tyre. Edhe pse u fillua një skemë e re e ndihmës sociale për personat me aftësi të kufizuara, ajo mbeti vetëm si pilot-projekt. Fëmijëve me aftësi të kufizuara vazhdon t'u mungojë mbrojtja e

duhur sociale dhe ata kryesisht jetojnë në institucione rezidenciale, ku kushtet janë shumë të dobëta. Marrë në përgjithësi, qasja në tregun e punës për njerëzit me aftësi të kufizuara mbetet marginale.

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do t'i përqendrojë përpjekjet e veta në ndërthurjen e skemave të asistencës sociale me politikat aktive të tregut të punës për të siguruar mbrojtje sociale efektive dhe për ta mbështetur punësimin. Ne do të promovojmë gjithashtu sisteme të benefiteve më progresive për të siguruar mundësi të barabarta dhe mobilitet më të madh social. Disa nga masat kryesore të politikës sociale që koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do t'i zbatojë gjatë qeverisjes së tij i përfshijnë këto:

- **Sigurimi i mjeteve financiare në formë të të ardhurave plotësuese për individët** që kujdesen për prindër mbi 70 vjeç në kushte familjare (shtëpi) – për 1 prind 30% nga rroga mesatare republikane.
- **Kthimi i normës së mbështetjes financiare për fëmijën e tretë.**
- **Adaptimi i sistemit të mbrojtjes sociale me ndryshimet në tregun e punës**, veçanërisht duke e adresuar mbulimin e punëtorëve të sektorit joformal dhe duke e rritur mbështetjen për prindërit e vetmuar dhe të moshuarit e izoluar, numri i të cilëve po rritet për shkak të emigrimit.
- **Eliminimi i barrierave për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha objektet me interes publik.** Do të angazhohemi që secili objekt shkollor të ketë shtigje dhe hapësira në të cilat mund të lëvizin persona me aftësi të kufizuara, kjo në përputhje me standardet ndërkombëtare të kushteve të jetesës për personat me nevojë të veçanta.
- **Transferimi i mbrojtjes sociale në kompetencën e njësive të vetëqeverisjes lokale.**



## Barazia gjinore

Diskriminimi dhe pabarazitë gjinore janë shumë të përhapura në të gjitha nivelet në Maqedoninë e Veriut.

Sipas UN Women, gratë përbëjnë vetëm 39.5% të krahut të punës. Ato fitojnë 17.9% më pak se burrat për një orë pune në sektorin privat dhe përbëjnë 64.2% të popullsisë ekonomikisht joaktive të vendit. Përfaqësimi i grave në administratën publike është mbi 50%, por përfaqësimi nuk është adekuat në gjithë sektorin publik dhe në të gjitha kategoritë e nëpunësve civilë.



Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje është e pamjaftueshme. Rritja e përfaqësimit të grave në Kuvend dhe në këshillat komunale është kryesisht për shkak të kuotave zgjedhore. Në organet ekzekutive përfaqësimi i grave është shumë i ulët – gjithsej vetëm 11% përfaqësim. Prej këtyre grave, 15% janë emëruar

si ministre, 7% si zëvendës ministre, 25% si sekretarë shtetërorë dhe 9% në mandate të tjera.

Gratë preken në mënyrë disproporcionale edhe nga dhuna në familje dhe nga dhuna në baza gjinore: 82% e të mbijetuarave nga dhuna në familje janë gra, ndërsa burrat përbëjnë 93% të dënimeve të dhunës në familje.

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të angazhohet për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave, si dhe në përmirësimin e përfaqësimit të tyre në jetën publike të vendit, duke i ndërmarrë masat në vijim.

- **Rritja e buxhetit të njësisë për barazi gjinore në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale** për t'i mundësuar asaj të luajë një rol më të fuqishëm koordinues e për të siguruar që normat ligjore dhe politikat relevante qeveritare të zbatohen në mënyrë efektive.
- **Adaptimi i kornizës ligjore me detyrimet e dala nga ratifikimi i Konventës së Stambollit për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.** Do të përkrahen më tepër hulumtime, si edhe mbledhja e të dhënave mbi dhunën mbi baza gjinore, kjo me qëllim të rritjes së shkallës së ndëshkueshmërisë dhe mbrojtjes së viktimave. Gjithashtu do të investohet në ndërtimin e kapaciteteve të reja për strehimin e viktimave të

dhunës seksuale, dhunës në baza gjinore dhe viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në të gjitha vendbanimet e mëdha të vendit.



## Fuqizimi i të rinjve

Të rinjtë janë një grup veçanërisht i marginalizuar në Maqedoninë e Veriut. Mungesa totale e përfshirjes së të rinjve në hartimin e politikave publike nga autoritetet rezulton me mosbesim të thellë të të rinjve në institucionet publike dhe në partitë politike. Për më tepër, vendi ynë e zë vendin e tretë në Europë për sa i përket papunësisë së të rinjve (me 48% e të rinjve të papunë), një përqindje kjo që është edhe më e lartë në rajonet ku jetojnë shqiptarët dhe ku rinia preket edhe më shumë nga papunësia afatgjate. Si rezultat, shumica e të rinjve tanë mendojnë të largohen nga vendlindja për të siguruar ashtu një jetë më të mirë.

Për vendin tonë ky është një skenar katastrofik, ngase e ardhmja jonë varet nga aftësia dhe motivimi i të rinjve për ta përmirësuar dhe forcuar demokracinë

dhe ekonominë e vendit. Të rinjtë janë liderët, politikanët, edukatorët, novatorët dhe punëdhënësit e ardhshëm të vendit dhe ne duhet t'u ofrojmë atyre një të ardhme në vendlindjen e tyre. Gjatë qeverisjes sonë, përveç masave për të lehtësuar hyrjen e të rinjve në tregun e punës, të detajuara më lartë në program, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të zbatojë edhe një numër masash shtesë për t'i adresuar sfidat më urgjente me të cilat përballen të rinjtë me qëllim të përmirësimit të situatës së tyre në shtet.



- **Reforma e Agjencisë për Rini dhe Sport (ARS).** Një ndër masat kryesore të koalicionit Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA në funksion të fuqizimit të të rinjve do të jetë reformimi i tërësishëm i Agjencisë për Rini dhe Sport, me qëllim të rritjes së transparencës, rritjes së investimeve në politikën rinore dhe përfaqësimin më të mirë të të rinjve në strukturën e Agjencisë. Brenda 100 ditëve para të qeverisjes së koalicionit Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA në ueb-faqen e sajdo të publikohen organogrami i plotë i Agjencisë dhe të gjitha aktivitetet dhe programet që janë ndërmarrë nga Agjencia për çdo vit.

Po ashtu do të rishikohet totalisht orientimi i fondeve të ARS, mes tjerash për të drejtuar 50% të këtyre fondeve në zbutjen e papunësisë dhe aftësimin dhe riaftësimin e të rinjve, ndërsa do të krijohen edhe mekanizma të kontrollit

të brendshëm për sa u përket shpenzimit të të hollave. Gjithashtu do të sigurohemi se infrastruktura rregullative e ARS-së të parashohë që drejtori dhe zëvendësdrejtori të mos jenë të moshës mbi 29 vjeç.

- **Qendra rinore në çdo komunë.** ARS do të angazhohet që në çdo komunë të krijohen hapësira pune në formë të kafe-inkubatorëve të biznesit, në të cilat të rinjtë do të kenë mundësi të punojnë dhe shoqërohen për shkëmbim të ideve. Kjo do të bëhet përmes partneritetit publiko-privat, duke i shfrytëzuar dhe modernizuar objektet vjetra, të cilat janë prona publike (p.sh. ish spitale, kazerma, dyqane etj.), ku ARS e ofron infrastrukturën dhe trajnimet, ndërsa partneri privat udhëheq me veprimtarinë dhe mirëmbajtjen.
- **Klube debati** në shkollat e mesme dhe në çdo universitet të vendit. Përmes fondeve të ARS-së do të angazhohen trajnerë debati dhe do të organizohet turne vjetore të debatit, ndërsa do të përkrahen dy ekipe debati (një shqiptar dhe një maqedonas) nga universitetet e vendit për të marrë pjesë në "World Universities Debating Championship".
- **Salla sporti në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në vend.** Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të angazhohet që të ndërtohen salla sporti në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në vend dhe të rinovohen fushat dhe sallat sportive ekzistuese, shumica e të cilave për momentin janë jofunksionale. Sallat e sportit do t'u jepen në shfrytëzim klubeve të ndryshme sportive lokale dhe, në ditë të caktuara, do të jenë të hapura për shfrytëzim rekreativ nga qytetarët.
- **Përkrahja institucionale për sportistët elitare.** Klubet sportive, të cilat arrijnë rezultate të larta në gara rajonale dhe ndërkombëtare, do të përfitojnë grante speciale për të siguruar funksionimin e tyre. Sportistëve të dalluar, të cilët arrijnë rezultate të larta në gara rajonale dhe ndërkombëtare, do t'u jepet rrogë minimale.

# PËR ZHVILLIM TË BARABARTË EKONOMIK DHE TERRITORIAL

Viti 2020 do të mbahet mendë si viti i COVID-19 që u manifestua përpos me probleme shëndetësore edhe me mbylljen e ekonomisë për disa muaj. Kjo shkaktoi krizë të madhe ekonomike që u shpreh te të gjitha indikatorët si rritje e papunësisë (21000 të papunë të rinjë Maj 2020), rritje e varfërisë (50,000 person, maj 2020), rënie ekonomike (-4% FMN, Prill 2020), zvoglim të eksportit dhe importit, probleme të likuiditetit të ndërmarrjeve (70% të ndërmarrjeve, Maj 2020), zvoglim i të hyrave buxhetore, rritje e transfereve sociale etj. Të gjitha këto sollën nevojën për huamarrje të re që rritën borxhin publik në 60% të GDP-së. Qeverisja e re do të ballafaqohet me sfidën më serioze pas viteve të para të tranzicionit, andaj duhet përgjigje po aq serioze. Përgjigja më e mirë është rritja solide ekonomike dhe shpërndarja e drejtë e saj, financa publike të qëndrueshme dhe në funksion të rritjes ekonomike, plan afatmesëm i rimëkëmbjes, përqëndrim më i madh në investime publike dhe private, mbështetjen e iniciativës private, etj.

Ekonomia e Maqedonisë së Veriut karakterizohet me performansë të pamjaftueshme zhvillimore krahasuar me vendet e rajonit, por edhe me potencialin e vet. Me normë mesatare të rritjes ekonomike prej 3% është i pamundur përmirësimi i serioz i standardit jetësor të qytetarëve. Arsyet e rritjes së pamjaftueshme ekonomike janë të shumta.

Konkurrenca dhe tregu i lirë pengohen nga monopolet, oligopolet dhe grupe oligarkike, veçanërisht në tregun e distribuesve të derivateve të naftës, të telekomunikimit, postës, në segmente të caktuara të shëndetësisë dhe furnizimit me produkte farmaceutike. Reformat strukturore zhvillohen ngadalë, madje në masë të



MUNDËSI TË  
BARABARTA  
ZHVILLIMORE

pamjaftueshme për shkak të kalkulimeve politike të qeverive dhe implikimeve sociale. Ristrukturimi i ndërmarrjeve private dhe publike, restrukturimi i tregut të punës, mungesa e përkrahjes për klimën e biznesit, institucionet joefikase të politizuara dhe të partizuara, korrupsioni, gjyqësori i kapur nga politika dhe politika e kapur nga gjyqësori, janë vetëm disa nga shkaqet e mungesës së investimeve të huaja dhe rritjes së pamjaftueshme ekonomike.

Problemet tjera serioze ekonomike, të cilat e destimulojnë rritjen ekonomike janë deficitin permanent tregtar (-17.4% të GDP-së para Pandemisë), papunësia (16% para Pandemisë) ekonomia joformale (30%), centralizimi i skajshëm fiskal dhe shpërndarje jo e drejtë e rritjes ekonomike, zhvillimi i pabarabartë rajonal dhe lokal që ka implikime në migrim edhe mobilitetin e brendshëm të qytetarëve etj. Viteve të fundit shfaqet edhe një fenomen i rrezikshëm: numri i ndërmarrjeve që mbyllen është shumë më i madh se i atyre që hapen.

Dëmi i politikave të gabuara ekonomike nuk përfundon me financimin e projekteve jozhvillimore ose rritjen e borxhit publik, por vazhdon edhe me dobësimin e shtyllës kryesore që e pengon zhvillimin dhe rritjen e standardit jetësor, pra stabilitetin e brendshëm politik.

Programi ekonomik i Koalicionit Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do t'i ndryshojë politikat joproductive ekonomike të qeverisë së deritanishme, që janë vazhdimësi edhe e qeverive të mëhershme. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA ,në programin

ekonomik, ka paraparë projeksione afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata. Gjatë 4 viteve të mandatit qeverisës koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA parasheh ballafaqim të guximshëm me problemet reale ekonomike të vendit, duke ofruar alternativë për ndryshime rrënjësore të politikave ekonomike, kjo me qëllim të rritjes së qëndrueshme dhe afatgjate ekonomike.

Kualiteti i politikave, mes tjerash varet, edhe nga synimet që dëshirojmë t'i realizojmë me aplikimin e tyre. Në këtë drejtim, gjatë përpilimit të politikave ekonomike zhvillimore do të merren parasysh vetëm kriteret e arsyeshmërisë ekonomike dhe financiare dhe jo kriteret etnike, të cilat – fatkeqësisht – kanë dominuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, veçanërisht në dekadën e fundit. Ky konstatim është i verifikueshëm lehtë nëse e shohim disproporcionin e madh investues e zhvillimor të pjesëve të banuara me shqiptarë dhe pjesëve të tjera të vendit. Edhe pse shqiptarët kanë një kontribut të konsiderueshëm në ekonominë e vendit, qoftë në të hyrat e përgjithshme buxhetore, qoftë në konsumin e përgjithshëm, remitenca dhe në rritjen e rezervave devizore, me çka kontribuojnë në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, që është parakusht themelor i funksionimit normal ekonomik të vendit, ata në vazhdimësi janë diskriminuar në aspekt ekonomik-financiar. Së këndejmi, në fokus të politikave tona ekonomike do të jetë zhvillimi i drejtë dhe i barabartë i rajoneve në vendin tonë.

Edhe pse paralajmërimet kishin për fokus mbistimulimin e rritjes ekonomike,

sot të gjitha parametrat tregojnë se kjo nuk u realizua as për së afërmi. Edhe sot ballafaqohemi me një ekonomi me deficite permanente buxhetore, planifikimet e të cilave viteve të fundit huqen me të madhe. Gjithashtu ballafaqohemi me dyfishim të borxhit publik i cili më arrinë në 60% të GDP-së, rritja e fundit e ndikuar nga kriza ekonomike si pasojë e COVID-19, trend jopremtues të tij bazuar edhe në strategjinë fiskale 2019-2021 para pandemike, por edhe me norma të larta të interesit (mbi mesataren e fitimit të biznesit), shkurtim të investimeve private nga kreditimi i sistemit bankar, shtrëngim të kriterëve për financimin e kredive konsumuese si rezultat i rritjes së kredive të këqija mbi 6.6% si pasojë e pamundësisë për shlyerjes së obligimeve, si dhe financim bankar të investimeve joproductive publike. Tregues të tjerë shqetësues për ekonominë e vendit janë edhe jolikuiditeti i sektorit privat i cili është përkeqësuar dukshëm nga kriza që po kalojmë (sipas të dhënave të fundit rreth 70% e ndërmarrjeve ballafaqohen me probleme të likuiditetit) vonesa e arkëtimit të kërkesave të sektorit privat nga sektori publik që ka ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin e likuiditetit të firmave dhe koston e afarizmit etj.

Prandaj është bërë nevojë e patjetërsueshme rishikimi i politikave ekzistuese dhe përpilimi i politikave kualitative që do të jenë në funksion të rritjes së qëndrueshme ekonomike.

Një çështje tjetër e rëndësishme së veçantë, përveç normave të rritjes ekonomike, është edhe shpërndarja e drejtë e të ardhurave shtetërore si mënyrë e vetme për uljen e varfërisë në vend. Ne do të përpilojmë politika ekonomike që nuk do të favorizojnë grupe të caktuara të interesit (shtresat e pasura), por do të jenë në funksion të rritjes së mirëqenies së të gjithë qytetarëve dhe zhvillim të të gjitha vendbanimeve në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.

Gjatë qeverisjes sonë do të angazhohemi për përmirësimin e performancës së përgjithshme zhvillimore ekonomike të vendit dhe zvogëlimin e pabarazive. Prioritetet tona kryesore do të jenë sjellja e një qeverisje kualitative dhe rritja e efikasitetit të institucioneve, përmirësimi i strukturës buxhetore në favor të shpenzimeve produktive dhe alokimi efikas i burimeve në sektorë me përparësi konkurruese, decentralizimi fiskal funksional dhe shpërndarja e drejtë e të ardhurave shtetërore, zvogëlimi i hendekut ndërmjet rajoneve zhvillimore, mbështetja e ndërmarrjeve vendore dhe inovacionit, rritja e investimeve të huaja dhe desegregimi i tyre etnik, zhbërja e monopoleve dhe rritja e efikasitetit të ndërmarrjeve publike. Programi ynë ekonomik do të garantojë:

- **Rritje ekonomike prej 4%-5%**
- **Ulje të papunësisë në 10% në mandatin 4-vjeçar**
- **Hapja e 25.000 vendeve të reja të punës në sektorin publik dhe privat.**
- **Rritja për 20% e rrogës mesatare**

## Për një politikë buxhetore zhvillimore

Në periudhën e kaluar, ekonomia e vendit është karakterizuar me politikë fiskale ekspansioniste dhe strukturë jo të favorshme të shpenzimeve publike me dominim të shpenzimeve joproductive vijuese. Kjo politikë shpeshherë ka imponuar politikë monetare restriktive, që ka rezultuar me ngritje të normave të interesit, që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e kostove të afarizmit dhe paraqesin element frenues për të. Kjo dëshmon për mungesën e koordinimit ndërmjet politikës fiskale dhe asaj monetare, që është parakusht bazë për politika të suksesshme makroekonomike.

Politika buxhetore është instrumenti më i rëndësishëm makroekonomik i qeverisë dhe ka rol thelbësor në dizajnimin e politikave zhvillimore. Roli i politikës buxhetore nuk duhet të kufizohet vetëm me grumbullimin e të hyrave dhe ofrimin e shërbimeve publike, por ajo do të jetë edhe në funksion të rritjes dhe zhvillimit ekonomik përmes stimulimit të sektorëve që kanë përparësi konkurruese dhe janë nën potencialin e shfrytëzimit të tyre. Gjithashtu, politika buxhetore duhet të dizajnohet për stimulimin e prodhimit, veçanërisht atij eksportues, krijimin e vendeve të reja të punës në sektorin privat dhe rritjen e investimeve. Politika më e mirë buxhetore është ajo që bën optimizimin e shpenzimeve buxhetore dhe alokimin efikas të tyre në favor të shpenzimeve kapitale.

Parimet mbi të cilat koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do ta bazojë dizajnimin e politikës buxhetore janë parimi i efikasitetit dhe parimi i shpërndarjes së drejtë, duke parandaluar kështu përdorimin e kriterit etnik, gjithë kjo në funksion të stimulimit të biznesit dhe krijimit të vendeve të reja të punës.

Politika buxhetore do të jetë prudente, duke mos e rrezikuar qëndrueshmërinë fiskale, mbajtjen e deficitit dhe borxhit publik në nivel optimal. Dinamika e borxhit publik do të jetë në pajtueshmëri me nevojat e shtetit, planet e rimëkëmbjes ekonomike bazuar në kriteret për maksimalizimin e dobisë nga borxhi përmes transparencës maksimale dhe alokimit efikas në projekte që do të rrisin të ardhurat kombëtare.

Duke qenë të vetëdijshëm për disproporcionin e madh zhvillimor ndërmjet vendbanimeve në Maqedoninë e Veriut, nuk do të lejojmë që të sakrifkohet mirëqenia dhe standardi jetësor i qytetarëve. Në funksion të realizimit të këtyre objektivave dhe frenimit të shfrytëzimit të politikës fiskale për nevoja të politikës ditore, si dhe parandalimin e shpërndarjes mbi parimin etnik dhe decentralizimin vendimmarrjes centraliste, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të angazhohet për masat në vijim.

- **Themelimi i Këshillit Fiskal.** Qëllimi i këtij këshilli është vlerësimi i drejtë dhe profesional i kondicionit buxhetor dhe politikave të shpenzimeve publike, borxhit publik, deficitit buxhetor, projekteve infrastrukturore dhe dhëniesë rekomandimeve për qeverinë mbi hartimin e këtyre politikave. Këshilli Fiskal

# VOTO



do të mbështetet financiarisht nga Qeveria, ndërsa përbërjen e tij do ta votojë Parlamenti me 2/3 e votave. Këshilli do të jetë i përbërë nga ekspertë të fushës së ekonomisë, që vijnë nga universitetet, sektori civil dhe odat ekonomike, duke garantuar edhe përfaqësim të drejtë dhe adekuat etnik. Këshilli Fiskal do të ketë rol në shpërndarjen e drejtë të mjeteve buxhetore në bazë të 3 kritereve kryesore: popullsia e vendbanimeve, niveli i tyre zhvillimor dhe ndarja proporcionale e buxhetit.

- **Politika tatimore proporcionale që mundësojnë rritje dhe zhvillim ekonomik, punësim, zhvillim të ndërmarrësisë dhe rishpërndarje të drejtë të ardhurave shtetërore.** Duke pasur parasysh vështirësitë me të cilat ballafaqohet sektori i biznesit në vend, siç janë likuiditeti i dobët i ndërmarrjeve, kreditë me norma relativisht të lartatë interesit, ngarkesa e lartë jofiskale dhe produktiviteti i ulët, ne do të angazhohemi të përpilojmë politika tatimore që do t'i ndihmojnë subjektet ekonomike në tejkalimin e këtyre pengesave, duke e përmirësuar klimën e biznesit dhe ndikuar në inkurajimin e investimeve, përdorimin e efikas të resurseve, rritjen e efikasitetit ekonomik dhe krijimin e mundësive për biznese të reja. Do të angazhohemi veçanërisht për tatim proporcional, kjo për shkak të përparësive që i ka ky lloj i normave tatimore, si: zgjerimi i bazës tatimore, zvogëlimi i prirjes marginale për evazion fiskal dhe zvogëlimi i kostove të punës, të cilat ndikojnë në mënyre direkte edhe në zvogëlimin e kostos së bërjes së biznesit.
- **Politika efikase e shpenzimeve publike.** Shpenzimet publike në Maqedoninë e Veriut kanë rritje të vazhdueshme. Me këtë rritje vazhdimisht rritet edhe joefikasiteti i tyre. Efektet e rritjes së të gjitha llojeve të shpenzimeve publike, matur sipas multiplikatorit, janë larg nga pritjet, në to dominojnë multiplikatorët me shenjë negative, ndërsa më shqetësues është multiplikatori i investimeve kapitale, që po ashtu ka shenjë negative (ASHAM, 2017). Kjo është kështu për arsye se rritja e shpenzimeve ishte e fokusuar kryesisht në projekte njëetnike të promovimit kulturor dhe historik, siç ishte Shkupi 2014 dhe shpenzime të tjera kryesisht për agjenda politike. Literatura ekonomike është kundër shpenzimit të këtyre mjeteve buxhetore veçanërisht në kohë të recesionit dhe në vendet në zhvillim me papunësi të lartë, ku ka nevojë për projekte me prioritet ekonomike. Përkundrazi, në kohë të recesionit preferohen rritje të shpenzimeve kapitale produktive (infrastrukturë, energjetikë, shëndetësi etj.), të cilat e stimulojnë rritjen ekonomike. Investimet kapitale në Maqedoninë e Veriut ngecin në krahasim me investimet kapitale në vendet e Ballkanit Perëndimor. Përveç kësaj, Qeveria e Maqedonisë së Veriut ka dështuar edhe në nivelin e realizimit të shpenzimeve kapitale të projektuara. Realizimi mesatar sillet rreth 75% nga projeksionet fillestare. Prandaj ne do të angazhohemi për rritjen e efikasitetit të shpenzimeve publike duke i vlerësuar drejt edhe politikat e stimulimeve buxhetore për degë të caktuara e duke u dhënë prioritet

kritereve ekonomike dhe financiare mbi alokimin e shpenzimeve buxhetore. Bazuar në rëndësinë e investimeve kapitale, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternativA do të përpilojë për konceptimin e politikës zhvillimore të shpenzimeve publike, duke e përmirësuar strukturën e shpenzimeve publike në dobi të investimeve kapitale.

- **Rritja e përqindjes së investimeve kapitale deri në masë prej 4% deri 5% të BPV-së ose 2 miliardë euro investime kapitale në mandatin 4-vjeçar** do të ndikojë në rritjen e kapacitetit prodhues të ekonomisë, respektivisht mundësisë së rritjes së BPV-së potenciale. Niveli i ulët i realizimit të investimeve kapitale nxit nevojën për rishikim të procesit të planifikimit të tyre, definimine drejtë të prioritetëve dhe rritje të efikasitetit në realizim. Do të jemi shumë të vëmendshëm që niveli i investimeve kapitale mos të ndikojë në shkurtimin e investimeve private përmes rritjes së normave të interesit. Kjo implikon nevojën për një politikë fiskale shumë të kujdesshme, veçanërisht pas ritmeve shqetësuese të rritjes së borxhit publik dhe trendit të tij.
- **Hartimi i Planit për revitalizimin e vendbanimeve prej 500 milionë eurosh do ta përmirësojë standardin jetësor dhe mirëqenien e qytetarëve.** Me këtë iniciativë do të hartohet një program i investimeve publike për nevojat elementare jetësore, si ujë për pije, kanalizim, asfaltim dhe ndriçim të vendbanimeve. Me këtë do të mundësojmë kushte më të mira dhe standard normal jetësor. Ky plan do të realizohet nga ndërmarrjet vendore, me çka do të stimulohet edhe punësimi.



## Forcimi i ndërmarrësisë

Bartës të rritjes ekonomike në Maqedoninë e Veriut janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). Nga gjithsej 72,315 subjekte afariste, pjesën më të madhe (79.1%) e përbëjnë subjektet afariste me 1 deri në 9 të punësuar. Më pas vijojnë subjektet afariste me 10-19 të punësuar, që përbëjnë 11.4% të numrit të përgjithshëm, dhe ato me 20 deri 49 punonjës që përbëjnë 4.3% të numrit të përgjithshëm.

Nëse i forcojmë ndërmarrjet dhe ndërmarrësinë, do ta dinamizojmë edhe rritjen ekonomike. Andaj koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA është i përkushtuar që politikat ekonomike gjatë qeverisjes sonë të jenë në funksion të fuqizimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të NVM-ve dhe përmirësimit të kushteve dhe rrethanave për ndërmarrje të reja. Këtë do ta bëjmë duke krijuar lehtësira tatimore, duke e përmirësuar mjedisin e ndërmarrësisë dhe duke i mbështetur financiarisht bizneset vendore.

## Lehtësira tatimore

- **Tatim personal zero në rrogën minimale.** Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do ta zbatojë këtë masë në mënyrë që të zvogëlohet ngarkesa tatimore për shtresat e varfra dhe që të ullet varfëria të të punësuarit me rrogë minimale, duke ndikuar kështu në zvogëlimin e pabarazisë në shpërndarjen e të ardhurave. Kjo masë do të ketë efekte në buxhet në vlerë prej 25 milionë eurosh në vit.

- **Skema e TVSH-së në bazë cash.** Në të gjitha raportet e Komisionit Europian potencohet se një ndër problemet kryesore të NVM-ve është mungesa e likuiditetit dhe qasja në financa. Prandaj, në këto kushte, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA mendon se është e padrejtë që biznesi të paraqitet si kreditor parapagues i shtetit. TVSH-ja në bazë cash nënkupton se të ardhurat regjistrohen kur ato pranohen dhe shpenzimet regjistrohen në periudhën që janë paguar.
- **Lirimi nga tatimi në fitim për themelimin e bizneseve në pjesët rurale dhe të pazhvilluara në periudhë prej 5 vitesh.**
- **Lirimi nga tatimi në pronë për tokat të cilat do të përpunohen.**
- **Një paketë fiskale për ta lehtësuar qasjen në mjete transportuese:** kthimi i TVSH-së për veturat me rrymë dhe me benzinë me kilometrazh zero për firmat; ulja e taksës rrugore për 50%, përcaktimi i kartonit të gjelbër me pagesë prej 1 euro dhe lirimi i homologimit për automjetet e reja.
- **Përfshirja e TVSH-së nga produktet ushqimore bazë.**
- **Eliminimi i tarifës industriale të energjisë elektrike.**
- **Rishikimi i tërësishëm i politikës së shpenzimeve parafiskale dhe diferencimi i bizneseve të vogla, të mesme dhe të mëdha ndaj tyre.** Do të krijojmë një qendër koordinuese për racionalizimin e shpenzimeve parafiskale, si taksat, lejet e ndryshme, licencat dhe kontributet. 86 % e dokumenteve ende shkojnë në letër, gjë që duhet të ndryshojë për të shkuar drejt digjitalizimit.

## Përkrahja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

- **Krijimi i Qendrës për Transformim Digjital (QTD) të NVM-ve** për të ofruar kështu mundësi për transformimin digjital të ndërmarrjeve përmes ekspertëve të QTD me kosto zero për ndërmarrjet, duke mundësuar rritjen e produktivitetit, uljen e kostove të afarizmit, depërtimin në tregje të reja, përmirësimin e shërbimeve dhe rritjen e konkurrueshmërisë.
- **Mbështetja e inovacioneve teknologjike përmes lehtësirave tatimore për inkubatorë teknologjikë dhe përmes subvencioneve direkte në vlerë prej 5 milion eurosh** që do të realizohet nëpërmjet Bankës së Maqedonisë për Mbështetje dhe Zhvillim.



- **Krijimi i ekosistemit për përkrahje të kompanive start-up.** Fondi për Inovacion tanimë disa vjet është aktiv në subvencionimin e kompanive start-up. Një problem themelor ka të bëjë me përkufizimin e kompanive start-up në ligjin për inovacion, i cili mundëson manipulime dhe nuk ka të bëjë asgjë me konceptin e kompanisë start-up. Do të propozojmë që kompania start-up të ridefinohet me ligj si: "Start-up është biznes rinovues, i cili ka potencial për rritje të shpejtë, me biznes modelskalabildhe me potencial për kthimin e investimeve për kohë relativisht të shkurtër". Ky ridefinim do t'i ndalojë abuzimet me fondet për kompanitë start-up, siç kemi pasur rast deri më tani. Krijimi i sistemit për "investitorë të kualifikuar" do të ndihmojë në përmirësimin e klimës së kompanive start-up dhe ngritjen e performansës R&D të NVM-ve, por edhe në mundësitë për punësimin në rinjë në vend. Legjislacioni vendor momentalisht mundëson forma për investime, por në anën tjetër ai i limiton format e investimit. Në fakt, në momentin kur paraqitet një investitor, me ligjin aktual ai bëhet edhe pjesë e strukturës pronësores të kompanisë. Me përkufizimin e sakte të formave për investime në kompani start-up do të mundësohet edhe krijimi i rrjeteve të investitorëve, me çka do të përmirësohet dukshëmedhe klima për investime në vend. Veç kësaj, kompanitë e reja start-up do të lirohen nga të gjitha detyrimet tatimore në fitim ndaj shtetit në dy vitet e para.
- **Kthimi i pragut të tatimpaguesve të TVSH-së nga 2.000.000 në 3.000.000 denarë**
- **Reduktimi ose eliminimi i tarifave doganore për lëndët e para dhe materialet që importohen e që nuk prodhohen në vend;**
- **Me qëllim të ndalimit të emigrimit të rinisë, për çdo të punësuar deri në moshën 30-vjeçare subjektet afariste do të lirohen nga kontributet në afat prej 3 viteve, me kusht që paga neto mos të jetë nën pagën mesatare shtetërore;**
- **Nxitja dhe ruajtja e artizanateve;**
- **Tatim në fitim zero për ndërmarrjet në sektorin e teknologjisë informative për dy vite pas themelimit.**
- **Firmat e reja me rritje të shpejtë në punësim dhe të ardhura do të përfitojnë stimulime financiare (Gazelle). Për këtë masë do të ndajmë 10 milion euro grante të bazuara në biznes plane.**
- **Ulja në 50% e kapitalit fillestar prej 5.000 euro për të rinjtë e moshës 18-29 vjeç, që duan të hapin biznese private.**
- **Lirimi nga kontributet për dy vite për kompanitë që punësojnë studentë brenda 6 muajve pas diplomimit.**
- **Program mbështetës për integrimin e NVM-ve në tregjet europiane përmes Bankës së Maqedonisë për Mbështetje dhe zhvillim.**
- **Programe trajnimi dhe mbështetje të NVM-ve për shitje online.** Aktualisht, vetëm 3% të NVM-ve në vend i shesin produktet e tyre online, që është niveli më i ulët në Ballkanin Perëndimor. Në kuadër të Qendrës për Transformim Digjital do të krijohet mekanizëm i veçantë që do të mundësojë këtë transformim.
- **Administrata tatimore miqësore ndaj NVM-ve.** Administrata tatimore do të jetë në funksion të lehtësimit dhe kanalizimit të afarizmit në sistem, duke ofruar shërbime, por ajo nuk do të funksionojë vetëm si organ ndëshkues. Për të gjitha lëshimet gjatë afarizmit së pari do të dërgohet vërejtje me shkrim në afat prej 30 ditësh për përmirësimin e parregullsisve.
- **Shërbimi elektronik për dokumentet e nevojshme për biznes. Sportelet të zëvendësohen me e-biznes.** Synimi ynë është që nevoja për dokumente hard-copy brenda mandatit nga 86% sa është aktualisht të zvogëlohet në minimumin e patjetërsueshëm.
- **Përshtatja e dënimeve mbi bazën e fuqisë financiare të ndërmarrjeve me kriter fitimin e deklaruar në vitin paraprak.**
- **Rregullimi i veprimtarisë së kazinovave dhe lojërave të fatit.** Kjo veprimtari do të kontrollohet në mënyrë më të rreptë dhe operatorët e vetëm të licencuar për kazino dhe lojëra tjera të fatit do të jenë hotelet me 5 vje.
- **Linje kreditore prej 100 milionë euro me norma të interesit të subvencionuara nga Qeveria e cila do të realizohet nga BMZH me finansim nga Banka Europiane për Investime. Normat e interesit për ndërmarrjet e reja do të subvencionohen nga qeveria dhe nuk do të jenë më të larta se 1%.**
- **Lirim nga tatimi në fitim për ndërmarrjet eksportuese.**

## Decentralizimi fiskal funksional

Procesi i ndërtimit të një sistemi demokratik është i lidhur ngushtë me procesin e decentralizimit. Sa më i decentralizuar të jetë pushteti, aq më i demokratizuar është vendi dhe qytetarët janë më aktivë në vendimmarrje.

Decentralizimi, sipas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, duhet të sigurojë mekanizma, me anë të të cilëve ndërpritet diskriminimi ndaj shqiptarëve nga ana e institucioneve shtetërore. Një decentralizim i modelit skandinav, sipas të cilit pjesa më e madhe e tatimeve që i paguajnë qytetarët do t'i mbeteshin komunës, ishte objektiv i Marrëveshjes Kornizë. Qasja e këtillë do t'i ndihmonte zhvillimit të komunave. Kjo formë do ta bënte më të përballueshme edhe plotësimin e nevojave elementare të qytetarëve.

Megjithatë, gjithë këtyre viteve vazhdoi dominimi i logjikës së eksploatimit dhe të centralizimit ekstrem. Maqedonia e Veriut është vendi më i centralizuar në Europë me vetëm 4.8% të PBV-së të të ardhurave lokale, krahasuar për shembull me Danimarkën me 36.4%, Slloveninë me 9.6%, Poloninë me 13.1% dhe Suedinë me 25.3%, ndërsa mesatarja e vendeve të OECD-së është 14%. Sa i përket raportit ndërmjet të ardhurave lokale dhe të ardhurave të përgjithshme publike, Maqedonia e Veriut përsëri është e fundit me 17.2%, krahasuar – për shembull – me Danimarkën me 63.8%, Slloveninë me 18,1%, Poloninë me 31,1% dhe Suedinë me 47,4%. Edhe në nivel rajonal vendi ynë ngec. Të ardhurat e përgjithshme të komunave në Republikën e Maqedonisë janë 4.8% e BPV-së, që është më pak se në Serbi me 6,3%, në Kosovë me 6,8%, në Mal të Zi me 6,0%, në Rumani me 8,6%, në Bullgari me 6,6%, si dhe shumë nën mesataren e BE-së prej 10,7% (NALAS 2017). Ky model i decentralizimit ka krijuar pabarazi shumë të madhe ndërmjet komunave të mbështetura në kriterin e të ardhurave për kokë banori. Si pasojë, komunat në Maqedoninë e Veriut janë të nënfinancuara në krahasim me vendet e BE-së dhe ato të Ballkanit Perëndimor dhe me një gamë të gjerë të kompetencave të transferuara, që nuk kanë mbulesë të mjaftueshme financiare.

Anashkalimi i interesave të qytetarëve dhe vazhdimi i diskriminimit të hatashëm që e karakterizon vendin, mbi të gjitha në baza etnike dhe rajonale, mund të shkaktojë kriza të reja për vendin. E kaluara dhe e tanishmja e imponojnë domosdonë e bërjes së reformave, pasi vite me radhë institucionet shtetërore kanë dëshmuar se nuk kanë gatishmëri të përballen me nevojat e qytetarëve.

Andaj, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & Alternativa propozon një model të mirëfilltë decentralizimi, që do të mundësojë menaxhim efikas të komunave, që do të jenë në gjendje t'i plotësojnë nevojat e qytetarëve duke mos qenë të shantazhuara dhe të kushtëzuara nga Qeveria qendrore përmes dotacioneve.

- **Synimi ynë kryesor është që të ardhurat e komunave nga 16%, sa janë tani, të arrijnë në 30% të të ardhurave të përgjithshme në periudhën 4-vjeçare**

**të mandatit tonë, duke mundësuar autonomi fiskale të qëndrueshme për qeverisjen lokale.**

Për arritjen e këtij synimi, gjatë qeverisjes sonë, ne do të angazhohemi për masat në vijim.

- **Model i decentralizimit funksional.** Decentralizimi aktual institucional është bazë për krijimin e pabarazisë në të ardhura për kokë banori. Ky model decentralizimi e lidhë bartjen e kompetencave me ekzistimin e institucioneve në sektorë përkatës. Duke marrë për bazë faktin e dezinvestimit historik në rajonet shqiptare, tani ballafaqohemi me mungesë të institucioneve gjegjëse. Kjo pamundëson alokimin e mjeteve nga bllok-dotacionet (grantet) në nivel lokal, që është formë e padrejtë dhe burim diskriminimi. Kalimi në modelin funksional mundëson financimin e nevojave të qytetarëve dhe jo të objekteve.
- **Barazimi fiskal.** Komunat tona kanë diferencë enorme në të ardhurat për kokë banori, kjo si rezultat i modelit të decentralizimit politik, ndarjes etnike territoriale dhe kapacitetit të pamjaftueshëm të komunave për gjenerimin e të ardhurave të tyre dhe nivelit zhvillimor të pabarabartë të komunave. Barazimi fiskal mund të arrihet përmes alokimit të 3% të TVSH-së ose përmes një lloji të ri dotacioni enkas për barazim fiskal. Kriter për barazim do të jetë pragu i mesatares së të ardhurave për kokë banori të komunave në nivel prej 90%.
- **Ndryshimi i formulës për shpërndarjen e TVSH-së dhe rritja e përqindjes së TVSH-së që do t'u kthehet komunave në 10%.**
- **Rritja e përqindjes së tatimit personal në të ardhura, që do u mbetet komunave deri në masën 10%.**
- **Eliminimi i dotacioneve të pakushtëzuara.**
- **Krijimi i një institucioni qeveritar financiar për kreditimin e komunave me kushte të volitshme (norma e interesit 1%),** që do të shërbente si mbikëqyrës i financave komunale, por edhe si burim i financimit të komunave. Huamarrjet e komunave do të jenë të kushtëzuara vetëm për investime kapitale lokale.
- **Rritja e kompetencave së komunave në menaxhimin e pasurive natyrore,** si uji, pyjet, dhe minierat. Do të bëhet ndarja e të ardhurave ndërmjet pushtetit qendror dhe atij lokal në raport 80/20.



## Zhvillimi i barabartë rajonal

Pabarazitë financiare dhe fiskalenë Maqedoninë e Veriut, për sa u përket komponentëve të zhvillimit, janë shumë të larta dhe ato e kanë thelluar hendekun midis komunave rurale dhe urbane, poredhe midis rajoneve.

Rajonet e banuara me shqiptarë, si ai Jugperëndimor, Verilindor dhe Pollogu ngecin dukshëm në krahasim me rajonet e tjera, gjë që është shprehje e dezinvestimit permanent nga qeveria qendror dhe e nënfinancimit të institucioneve të vetëqeverisjes lokale.

Faktet flasin se qeveritë kanë dështuar në ndarjen e drejtë të fondeve financiare për investime publike kapitale dhe me këtë qeveria ka kontribuar drejtpërdrejt në thellimin e pabarazive në nivelin lokal dhe ndër-rajonal ndërmjet vendbanimeve, qyteteve e rajoneve. Këto veprime të qëllimshme rezultojnë në diskriminim politik dhe etnik dhe ato i degradojnë edhe më shumë këto nivele të ulëta të decentralizimit fiskal në komunat me shumicë shqiptare.

Diskriminimi më i lartë në fushën e investimeve kapitale, në nivelin e rajoneve, aplikohet në rajonin e Pollogut me 1,032 denarë për kokë banori investime kapitale, që ndiqet nga rajoni Juglindor me 1,693 denarë për kokë banori, Vardari me 1,947 denarë për frymë e kështu me radhë. Si rastet më ekstreme të diskriminimit brenda rajonit të Shkupit është proporcioni prej 5.309 denarësh për frymë në komunën urbane të Qendrës përkundër investimit të vetëm 85 denarëve për frymë banori në komunën rurale të Haraçinës, që paraqet një ndryshim për 62 herë (6,150%).

Këto të dhëna argumentojnë thellimin e pabarazisë si rezultat i politikave diskriminuese të zbatuara nga qeveria, që vijnë si pasojë e mosrespektimit të ligjit

për zhvillim të barabartë rajonal. Pavarësisht rajoneve të diskriminuara, në rajonin e Shkupit realizohen 65% më shumë investime kapitale për kokë banori në krahasim me nivelin mesatar të realizuar në Maqedoni ose 356% më shumë investime kapitale për kokë banorinë krahasim me rajonin e Pollogut. Kjo, natyrshëm, ndikondrejtpërdrejt në forcimin e mëtutjeshëm të pabarazisë në zhvillimin lokal dhe rajonal, duke dëshmuar tendencë për eksploatim të shqiptarëve. Këtë argument e forcojnë edhe mjetet e ndara në vitin 2020 për zhvillim të barabartë rajonal prej vetëm 18 milionë eurosh, kjo përkundër detyrimit ligjor prej 1% të PBV-së.

Andaj, në funksion të parandalimit të diskriminimit të mëtejshëm dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik të rajoneve, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & Alternativa gjatë qeverisjes së tij do të angazhohet për masat në vijim.

- **Shndërrimi i rajoneve aktuale planore në Qendra të Avancuara Administrative**, gjegjësisht pasqyrimi dhe shtrirja e të gjitha niveleve të pushtetit ekzekutiv (ministri, ndërmarrje publike, agjenci, drejtori, shoqëri aksionare) dhe gjyqësor (gjykata dhe prokurori të apelit) do të bëhet sipas modelit të rajoneve e jo si modeli aktual që shkakton disbalancë.
- **Zhvillimi i barabartë i zonave ekonomike, si në përkrahje financiare të shtetit për ndërtimin e infrastrukturës për këto zona, ashtu edhe në shpërndarjen e investitorëve.** Do të sigurohet statusi i veçantë për zonën e Vizbegut, ku parashihet centralizimi i kompetencave urbanistike dhe infrastrukturore në një institucion shtetëror. Po ashtu, në zonën e Vizbegut do të sigurohet gjithashtu ndërtimi i rrjetit të kanalizimit, ujësjellësit dhe infrastrukturës rrugore. Përveç kësaj, do të bëhet edhe barazimi ligjor dhe financiar-investues i zonave të lira ekonomike të Strugës, Kërçovës, Tetovës dhe Likovës me zonat e tjera ekonomike, siç janë investimet në infrastrukturën rrugore, elektrike, kanalizimin dhe ujësjellësin.
- **Fondi për zhvillimin e rajoneve më pak të zhvilluar prej 100–200 milionë eurosh (1%-2% të PBV-së) gjatë mandatit që të eliminohet dispariteti në zhvillimin e komunave. Vlera e këtij fondi do të revidohet mbi bazën e trendeve të rimëkëmbjes ekonomike!**
- **Niveli mesatar i investimeve kapitale për kokë banori në Maqedoninë e Veriut të jetë kriter për shpërndarjen e fondeve shtesë të investimeve kapitale nga fondi prej 1% -1,5% të PBV-së me proporcione adekuate vetëm në komunat dhe rajonet e pazhvilluara.**
- **Fondet e investimeve prej 1%-1,5% të PBV-së, në përputhje me mekanizmin e barazimit, të transferohen drejtpërdrejt në menaxhimin e komunave të pazhvilluara brenda rajoneve,** ndërsa qeveria qendrore vetëm ta monitorojë dhe kontrollojë shkallën e realizimit dhe shkallën e performansës, pa të drejtë

për rialokimine investimeve të fondeve, siç ka qenë praktika e deritanishme.

- **Do të angazhohemi për përgatitjen e strategjisë gjithëpërfshirëse për zhvillim të ekuilibruar rajonal sipas modelit zviceran ose belg, kjo me ndihmën e institucioneve ndërkombëtare.**
- **Rritja e kompetencave të Zyrës për Zhvillim Rajonal dhe e Këshillit për Zhvillim të Rajoneve Planore.**
- **Fuqizim i bashkësive lokale për aplikim me projekte (buxhet participativ 50/50).**
- **Krijimi i mundësive ligjore që 5 këshilltarë komunalë të propozojnë projekte në Zyrën për Zhvillim Rajonal.**

## Nxitja e investimeve të huaja dhe nga mërgata

Qeveritë e kaluara kanë ngecur në shkallë të madhe edhe në tërheqjen e investimeve të huaja, përfshirë tërheqjen e kapitalit të mërgimtarëve tanë në ekonominë e vendit. Gjatë qeverisjes së tij, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të ndërmarrë një sërë masash për të tërhequr investimet e huaja dhe për t'u mundësuar mërgimtarëve të bëhen forcë e rëndësishme në zhvillimin ekonomik të vendit. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të angazhohet gjithashtu për ta mobilizuar fuqinë ekonomike të mërgatës sonë, duke ndërmarrë masa për t'i informuar mërgimtarët rreth mundësive për investime në vend si, dhe për t'ua lehtësuar investimet.

- **Ligj për industrinë "Outsourcing".** Industria "outsourcing" në Maqedoninë e Veriut është në rritje e sipër dhe ajo fokusohet kryesisht në shërbime të teknologjisë informative, qendra për kujdes ndaj klientit, qendra për përpunimin e të dhënave ose seli rajonale për bizneset. Në vitin 2018 kjo industri kontribuoi me 2.1% në BPV-në e vendit ose me 150.3 milionë euro. Fitimi neto i kësaj industrie në vitin 2018 arriti në 13.2 milionë EUR, ndërkaq deri në vitin 2022 pritet që qarkullimi në këtë industri të dyfishohet dhe të arrijë në 288.1 milionë euro. Industria Outsourcing më 2018 ka punësuar 5,713 punonjës me orar të plotë ose 1,174 më shumë sesa në vitin 2017. Sot kjo industrinë njihet si një industri e veçantë në Maqedoninë e Veriut. Si rezultat i mosdiferencimit nga industritë tjera, nuk ka mekanizma adekuatë mbështetës dhe legjisllacion të duhur, me qëllim të hapjes së mundësive më të mëdha të tregut jashtë vendit. Në 100-ditëshin e parë do të miratohet ligji që do ta njohë këtë industri si të veçantë dhe do të krijojë mekanizma për

mbështetjen e saj, ndërsa brenda dy viteve do të krijohet ekosistem me qëllim të përkrahjes së kësaj industrie, si në aspekt të resurseve njerëzore, ashtu edhe në aspekt të ekspertizave që do të jepen nga ekspertë të profileve të ndryshme. Kjo do të krijojë një klimë pozitive për zhvillimin e kësaj industrie dhe për përshtetimin e saj, duke e pozicionuar vendin si një vend potencial në hartën e industrisë outsourcing në rajon, por edhe më gjerë.

- **Zgjidhja e çështjeve pronësore-juridike mbi tokën dhe lehtësimin e procedurave burokratike për aprovimin dhe dhënien e lejeve të ndërtimit, që është barriera kryesore ndaj investimeve të huaja.**
- **Ligj të ri për dogana me të cilin do të rregullohen barrierat administrative me qëllim lehtësimin e lëvizjes së mallrave dhe kapitalit.**
- **Lirimi nga dogana i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në importin e repromaterialeve nëse ato janë të destinuara për eksport.**
- **Agjencia për Investime nga Mërgata dhe Investime të Huaja.** Agjencia për Investime të Huaja do të riformatohet në Agjenci për Investime të Diasporës dhe Investime të Huaja, që ka për mision lehtësimin e komunikimit dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për investitorët potencialë nga mërgata.
- **Ditët e mërgatës.** Do të organizohet një panair vjetor ku institucionet



vendore do t'i prezantojnë mundësitë për investime nga mërgata.

- **Lirimi nga të gjitha tatimet në fitim për investimet nga mërgata në dy vitet e para.**
- **Subvencionimi i investimeve në turizëm.** Maqedonia e Veriut ka potencial real për zhvillimin e turizmit si degë e rëndësishme ekonomike, në të cilën deri më tani është investuar pak nga ana e shtetit. Ne e shohim mërgatën si një mundësi për zhvillimin e kësaj dege, për shkak të potencialit të saj financiar dhepërvojës në hotelieri dhe gastronomi në vendet më të zhvilluara të botës. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të angazhohet që qeveriat i mbulojë 30% të investimeve të tilla në formë të lehtësimeve tatimore dhe financiare për çdo investim nga mërgata në Kodrën e Diellit, në Mavrovë dhe në Strugë nëse investimi siguron 50 të punësuar për një periudhë 5-vjeçare.
- **Krijimi i fletobligacioneve për mërgatën në vlerë prej 50 milionë euro në vit.**
- **Anulimi i detyrimeve doganore dhe tatimeve të tjera për makineritëe angazhuara në procesine prodhimit,** të importuara nga mërgimtarët në kuadër të projekteve të tyre investuese.
- **Ofrimi i lehtësimeve administrative,** si thjeshtëzimi i procedurave për marrjen e lejes së ndërtimit dhe procedurave për marrjen e tokës publike në shfrytëzim.

dekada dhe afinitet të ulët të likuiditetit. Prandaj, funksionimi i këtyre ndërmarrjeve varet nga alokimet buxhetore.

Për të përmirësuar ekonomizimin e ndërmarrjeve publike koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të angazhohet për masat në vijim.

- **Ngritja e një organi të veçantë në nivel shtetëror (mbikëqyrës) për auditimin e punës së ndërmarrjeve publike të themeluara nga komunat.** Kjo do ta parandalojë praktikën e keqe të krijuar për më shumë se tre dekada me ndërmarrje të zhytura në kaos, keqpërdorime, borxhe dhe të paafta për ta kryer funksionin e dhënë.
- **Aplikimin e IPSA-s (Standardet Ndërkombëtare të Sektorit Publik) në ndërmarrjet publike.**
- **Revizioni privat nga një prej katër kompanive më të mëdha revizore** (me 500 nënshkrime nga qytetarët).
- **Ristrukturimi menaxherial i ndërmarrjeve publike** për të garantuar,mes tjerash, autonominë e plotë në menaxhimin e tyre.
- **Ndalimi i praktikave të pagesës së fitimit në buxhetin e shtetit,** që rrezikon ciklin e zhvillimit të investimeve dhe likuiditetin e ndërmarrjeve publike.
- **Eliminimi i alokimit të mjeteve buxhetore në ndërmarrjet publike** përmes amendamentimit të Ligji për buxhet.

## Ndërmarrje publike fitimprurëse

Ndërmarrjet publike qendrore dhe lokale janë përbërës shumë të rëndësishëm të sistemit ekonomik në vend me afër 30,000 të punësuar dhe me qarkullim vjetor mbi 750 milionë euro. Sipas definicionit, ndërmarrjet duhet të gjenerojnë vetëmjaftueshmëri financiare dhe akumulim të kapitalit për investime në funksion të zgjerimit të kapaciteteve, përmirësimit të cilësisë së produkteve, shërbimeve etj.

Megjithatë, duke u mbështetur në kriteret financiare dhe ekonomike,analizat e institucioneve relevante flasin për një situatë të pakënaqshme të ndërmarrjeve publike. Shumica e ndërmarrjeve viteve të fundit ballafaqohen me zvogëlimin e të ardhurave, normë të ulët të profitabilitetit, qëështë e pamjaftueshme për dinamizimin e ripërtëritjes së mjeteve, kohë shumë të gjatë të arkëtimit të kërkesave dhe kohë edhe më të gjatë për shlyerjen e obligimeve. Kjo dëshmon për performansën e ulët të ekonomizimit të tyre. Disa ndërmarrje publike kanë borxhe të akumuluar disa

## MENDOJMË DHE VEPROJMË GJELBËR

## PËR SHTET ZHVILLIMOR TË GJELBËR DHE TË DIGJITALIZUAR

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të promovojë avancimin e shtetit zhvillimor, të bazuar në mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe në bujqësinë e qëndrueshme, në të cilin qytetarëve u ofrohet infrastrukturë cilësore dhe shërbime publike të digjitalizuara dhe inovuese. Kjo qasje do ta bëjë vendin më të mirë për qytetarët, duke e afruar atë, në të njëjtën kohë, më afër BE-së, ku fokusi kryesor i institucioneve europiane është zhvillimi i një kontrate sociale europiane për mjedisin ("Green Deal"), duke përfshirë përgatitjen e një agjende të gjelbër europiane për vendet e Ballkanit Perëndimor

Prioritetet kryesore të koalicionit Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA për shtet zhvillimor të gjelbër dhe të digjitalizuar do të fokusohen në eliminimin e shpejtë dhe efikas të ndotjes së mjedisit jetësor, rritjen e burimeve alternative dhe të pastra të energjisë, bujqësi të qëndrueshme si sektor themelor për zhvillimin ekonomik dhe territorial, rritjen e ndërlidhjes së brendshme dhe rajonale, avancimin dhe modernizimin e infrastrukturës komunale, si dhe krijimin e një administrate të digjitalizuar dhe inovuese në shërbim të qytetarit.

## Adresimi i menjëhershëm i emergjencës mjedisore

Maqedonia e Veriut përballet me një emergjencë mjedisore të paparë. Vendi ynë e ka cilësinë më të dobët të ajrit në kontinent dhe regjistron nivele të vdekshmërisë nga ndotja e ajrit – dy deri në tri herë më të larta se mesatarja europiane. Sistemet e ngrohjes joefikase, emetimet nga automjetet dhe industritë e rënda, si dhe energjia e bazuar kryesisht në thëngjill, janë fajtorët kryesorë për këtë gjendje. Kostoja sociale e mosadresimit të sfidave mjedisore dhe ndryshimit klimatik është e qartë, duke ndikuar drejtpërdrejt në shëndetin dhe sigurinë e përgjithshme të qytetarëve, në veçanti në zonat ku këto ndryshime do t'i shkatërrojnë fermerët tashmë të varfër të vendit.

Edhe përkundër kësaj emergjence mjedisore, mjedisi dhe ruajtja e tij nuk ka qenë prioritet i asnjërës nga qeveritë e deritanishme në Maqedoninë e Veriut. Buxheti i dedikuar për mbrojtjen e mjedisit në nivel vendi është jashtëzakonisht i ulët, ndërkohë që nuk stimulohet vetëdijesimi mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe domosdoja e monitorimit dhe ndëshkimit të ndotësve. Përkundër ekzistimit të infrastrukturës ligjore, zbatimi efikas i saj është në shkallë të ulët.

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA, me fillimin e qeverisjes së tij, do ta shtyjë miratimin e një plani për veprim gjithëpërfshirës dhe shumë-sektorial për adresimin e emergjencës mjedisore, si dhe masa konkrete për adresimin e problemeve akute që e rëndojnë mjedisin jetësor, duke filluar nga përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe ujit, menaxhimi dhe trajtimi i mbeturinave, mbrojtja tokave bujqësore nga degradimi i lumenjve e pyjeve, e deri te ndotja e shkaktuar nga aktivitetet industriale. **Plani i veprimit për adresimin e emergjencës mjedisore** do të përfshijë, mes tjerash, masat konkrete në vijim.

- **Përshejtimi i harmonizimit të ligjeve vendore me legjislacionin e BE-së.** Do të bëjmë transpozimin dhe do të fillojmë zbatimin e legjislacionit europian në lidhje me ndryshimet klimatike dhe ato të mjedisit, veçanërisht në monitorimin dhe raportimin e emetimeve, Sistemin e Tregtimit të Emetimeve të BE-së dhe ndarjen e barrës. Po ashtu do ta kompletojmë kornizën legjislative mbi ndotjen industriale dhe menaxhimin e rrezikut, duke siguruar zbatim të plotë. Kjo do të përfshijë transpozimin e legjislacionit vendor të Direktivës SEVESO III për reduktimin e rrezikut nga katastrofat teknologjike, të rregulloreve për Eko-labele të BE-së dhe të Skemës së Eko-Menaxhimit dhe Auditimit të BE-së (EMAS).
- **Miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse dhe shumë-sektoriale për veprimin kundër ndryshimeve klimatike** për të zbatuar Marrëveshjen e Parisit, kjo në përputhje me “Kornizën e BE-së për klimën dhe energjinë 2030”.

- **Miratimi i një plani shtetëror për energjinë dhe ndryshimin klimatik,** kjo në përputhje me detyrimet e dala nga Komuniteti i Energjisë, i cili i adreson pesë dimensionet e Unionit të Energjisë rreth sigurisë, solidaritetit dhe mirëbesimit, tregut të brendshëm energjetik plotësisht të integruar, efikasitetit të energjisë, dekarbonizimit të ekonomisë, si dhe hulumtimit, inovacionit dhe konkurrencës.
- **Përmirësimi i cilësisë së ajrit,** duke avancuar një koordinim efikas midis autoriteteve qendrore dhe atyre lokale dhe duke siguruar burime adekuate financiare. Masat për përmirësimin e cilësisë së ajrit do të zhvillohen për të gjitha zonat ku nivelet e ndotësve i tejkalojnë vlerat kufitare, veçanërisht në Shkup, Tetovë dhe Manastir. Prandaj do të krijojmë një regjistër qendror për matjen e cilësisë së ajrit me pika fikse në nivel të shtetit dhe do t'irrisim kapacitetet njerëzore, teknike dhe financiare të rrjetit shtetëror për monitorim të cilësisë së ajrit. Masa shtese për përmirësimin e cilësisë së ajrit do të përfshijnë uljen e akcizës për makinat e reja, subvencionimin e makinave elektrike, rritjen e numrit të shtigjeve për biçikleta dhesubvencione për punëtorët që shkojnë në vendin e punës me biçikletë, si dhe subvencione për mbjelljen e drurëve me rritje të shpejtë dhe me kapacitete të larta të pastrimit të ajrit.
- **Vendosja e një sistemi të integruar rajonal për menaxhimin e mbeturinave.** Shumica e deponive komunale nuk janë të licencuara dhe gjithandej vendit ekziston një numër i madh i deponive ilegale. Për më tepër, vendi numëron shumë toka të kontaminuara nga industria. Prandaj ne do t'i operacionalizojmë strukturat rajonale për menaxhimin e mbeturinave dhe do t'ifuqizojmë kapacitetet e tyre administrative dhe financiare. Gjithashtu do të vendosim një sistem të integruar të menaxhimit të mbeturinave dhe do t'i rrisim investimet për ndarjen dhe riciklimin e mbeturinave. Në fokusin do të jetë edhe fuqizimi i stimujve ekonomikë për riciklimin dhe krijimin e një skeme të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit për tapërforcuar ashtu tregun e riciklimit. Në nivel komunal synimi ynë është që secila komunë të ketë më së shumti tre vende (gropa të mëdha) me lokacion të caktuar nga autoritetet komunale.
- **Një politikë shtetërore për riciklimin e mbeturinave.** Do të miratojmë një politikë shtetërore koherente për riciklimin e mbeturinave dhe do t'i rrisim investimet për krijimin e infrastrukturave të nevojshme në nivelin komunal dhe rajonal. Kjo do të përfshijë sisteme për mbledhjen e klasifikuar të mbeturinave dhe riciklimin e paketimeve, shpërndarjen e koshave për ndarjen e mbeturinave dhe kontejnerëve “të mençur” të destinuar për riciklimin. Masat e tjera do të përfshijnë ndalimin e qeseve plastike për një përdorim dhe, në vend të tyre, futjen e qeseve për përdorim të shumëfishtë, si dhe organizimin e sistemeve të grumbullimit dhe riciklimit të automjeteve të dala

nga përdorimit (17,500 tonë në vit sipas Eurostat), baterive, akumulatorëve, gomave të makinave dhe vajit motorik.

- **Tolerancë zero për ndotjen industriale.** Mbetjet e rrezikshme dhe industriale zakonisht depozitohen në deponitë industriale, por shpeshherë ndodh që ato të hidhen në deponitë komunale, së bashku me mbeturinat tjera. Vlerësohet se rreth 5,000 tonë mbeturina jo të rrezikshme industriale dhe rreth 500 tonë mbeturina të rrezikshme industriale depozitohen çdo vit në deponitë komunale. Kjo situatë nuk mund të vazhdojë. Prandaj do ta kompletojmë kornizën ligjore mbi ndotjen industriale dhe menaxhimin e rreziqeve dhe do të sigurojmë zbatimin e përpiktë të ligjit, duke investuar më shumë burime për zbatimin e legjislacionit sipas parimit të ndotësit pagues.
- **Impiante të reja ko-incinerimi.** Maqedonia e Veriut që nga viti 2000 ka në veprim vetëm një incenerator me një kapacitet maksimal prej një ton në ditë. Kjo nuk është e mjaftueshme. Prandaj do të investojmë në impiante të reja ko-incinerimi në nivel komunal me kapacitete të ndryshme dhe varësisht nga nevojat e komunave.
- **Rritja e efijencës energjetike të ndërtesave.** Do të stimulojmë amvisëritë që ta reduktojnë konsumin e energjisë përmes masave të rritjes së efijencës dhe izolimit të shtëpive dhe objekteve banesore. Ndërtesat private do të kenë prioritet të lartë në masat për efijencë energjetike, kjo karshi ndërtesave publike dhe institucioneve arsimore dhe shëndetësore.
- **Bashkimi i Qendrës për Menaxhim me Kriza dhe Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim** në një organ të ri dhe të pavarur të administratës shtetërore, për të krijuar kështu një sistem të ri të integruar strategjik më efikas dhe efektiv për menaxhim me kriza.



## Bujqësia dhe zhvillimi rural - sektorë themelorë të zhvillimit ekonomik dhe territorial

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të zbatojë një vizion afatgjatë për zhvillimin bujqësisë dhe zhvillimit rural, duke i identifikuar resurset dhe potencialin për prodhim të produkteve në të gjithë sektorët e bujqësisë. Do të sigurojmë një planifikim buxhetor në mënyrë më të drejtë dhe adekuate, do të bëjmë rritjen e punësimin dhe aktivitetin ekonomik në të gjithësektorë bujqësisë (në agrobiznes, agro-përpunim, pylltari dheagro-turizëm), duke synuar rritjen e prodhimit vendor dhe të aftësisë për të eksportuar prodhime ushqimoreqë i plotësojnë kriteret e cilësisë dhe sigurisë ushqimore. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA ,gjatë qeverisjes së tij, do të zbatojë masat prioritare në vijim.

- **Zhvillimi i qëndrueshëm rural.** Zhvillimi rural në vendin tonë është i dobët dhejo i qëndrueshëm, kjo për shkak të mungesës së theksuar të investimeve, për shkak të një infrastrukture të dobët ruraleqë e gjejmë në veçanti në pjesën veri perëndimore dhe për shkak të mosshfrytëzimit të resurseve natyrore. Për ta avancuar zhvillimin e qëndrueshëm rural, përveç bujqësisë, do të promovojmë aktivitete alternative ekonomike, veçanërisht përmes mbështetjes së agro-turizmit, mbështetjes së produkteve tradicionale, bimëve mjekësore e aromatike, si dhe frutave malore, duke i certifikuar ato si produkte organike.
- **Një strategji për konsolidimin e tokave bujqësore.** Shumica e fermerëve në Maqedoninë e Veriut, në veçanti në pjesën perëndimore të vendit, kanë



produktivitet të ulët, kjo për shkak të ndarjes së tokave bujqësore pa kriter dhe politika subvencionuese të gabuara, gjë që e pengon zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor. Prandaj ne do të ndërtojmë një strategji për konsolidimin e tokave bujqësore me qëllim të rritjes së parcelave, përdorimin më racional të tokës bujqësore, rritjen e të ardhurave të fermerëve, përfshirë rishikimin e subvencioneve dhe nxitjen e punimit të tokës, gjithë kjo me qëllim të përmirësimit të përgjithshëm të jetës së popullatës që jeton në zona rurale.

- **Rregullimi i kontesteve pronësore.** Në kuadër të strategjisë së konsolidimit të tokave bujqësore një kujdes i veçantë do t'i kushtohet rregullimit të çështjeve pronësore dhe tjetërsimit të pronave, duke krijuar një portal përmes të cilit të gjithë qytetarët, veçanërisht mërgimtarët, do të kenë mundësi t'i realizojnë të drejtat e tyre pronësore që mohohen nga mungesa e titujve të pronësisë dhe paqartësitë pronësore në kadastrën e tokave.
- **Krijimi i një harte shtetërore për parcelat bujqësore me detaje për strukturën e tyre (E-bujku).** Maqedonia e Veriut nuk ka asnjë sistem të centralizuar për mapimin e parcelave bujqësore me detaje për strukturën përbërëse të tyre. Prandaj ne do të krijojmë një portal (e-bujku), i cili mundëson definimin e mbjelljeve dhe kohën e mbjelljes në përputhshmëri me motin, vendin e parcelës, strukturën e saj dhe nevojat e shtetit.
- **Menaxhimi i drejtë dhe i duhur i subvencioneve bujqësore.** Gjatë dekadës së fundit është ndarë një shumë e konsiderueshme e buxhetit për subvencionimin e fermerëve, por rezultati është dëshpërues, sepse nga viti në vit ulët numri i fermerëve dhe kemi zëvendësimin e prodhimeve vendore me ato të importit. Për këtë arsye do të rishikohet në tërësi sistemi i subvencionimit, duke u bazuar në cilësinë e prodhuar të lëndëve të para me origjinë bimore e shtazore e jo vetëm pagesat bazuar në sasi. Me qeverisjen tonë subvencionimi do të bazohet në produktivitetin e fermerëve në vitin pas subvencionimeve, sidomos sa i përket eksportit dhe do të shqyrtohen disa risi, siç është ndryshimi i politikave të çmimit për cilësi dhe eksport. Risi e veçantë mbështetëse për sektorët e bujqësisë do të jetë çmimi bazë për lëndët e para me origjinë bimore e shtazore. Do të ketë, po ashtu, subvencionim mujor për prodhime ditore (qumështi i freskët) dhe subvencionim sezonal para fillimit të sezonit të prodhimit. Koalicioni do të ofrojë mbështetje për fermerëve në shërbimet veterinerë (ulja e TVSH-së nga 18 në 5%, subvencionim i insiminimit artificial, subvencionimi i plotë i gjurmimeve për sëmudjet me direktivë vjetore nga organet kompetente). Gjithashtu do të ketë subvencionim për certifikimin e prodhimeve organike, si dhesubvencionim për modernizimin e makinerisë bujqësore.
- **Rritja e kapaciteteve të industrisë së përpunimit të ushqimit.** Aktualisht

kapacitetet e përpunimit të prodhimeve ushqimore në Maqedoninë e Veriut janë në nivele shumë të ulëta, kryesisht për shkak të mungesës së investimeve publike në infrastrukturën prodhuese dhe kontrollit të mangët të sigurisë ushqimore, veçanërisht sa u përket produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe marketingut të dobët. Si pasojë, një numër shumë i vogël i kompanive janë konkurruese dhe të afta për të eksportuar në vendet e BE-së, por edhe për t'i zëvendësuar produktet e importuara në tregun vendor. Gjatë qeverisjes sonë, do të përqendrohemi në përmirësimin dhe ngritjen e njësive të reja të kapaciteteve përpunuese dhe marketingun e produkteve ushqimore, si dhe në standardizimin e prodhimeve vendore, ndërsa do ta forcojmë dhe decentralizojmë kontrollin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore, duke e ndërlidhur më mirë zinxhirin prodhim-përpunim-shitje-eksport. Kjo do ta rrisë potencialin e prodhimit bujqësor dhe vlerën e ekonomisë së vendit.

- **Rritja e kapaciteteve të qendrave këshilluese në gjuhën amtare të prodhuesve,** kjo me qëllim të trajnimit dhe informimit rreth subvencioneve dhe fondeve europiane në fushën e bujqësisë, të cilat vazhdojnë të shfrytëzohen në nivel shumë të ulët. Angazhimi jonë është në eliminimin e procedurave burokratike për qasjen e fermerëve dhe prodhuesve të ushqimit në fondet e bashkimit Europian.
- **“Fshatra të mençur”** (“smart villages”) është një koncept relativisht i ri në kuadrin politikave europiane për zhvillim rural, përmes të cilit fermerëve u mundësohet qasje dhe aftësim në përdorimin e teknologjive informatike me qëllim të zhvillimit të zonave rurale. Ky koncept u mundëson bizneseve rurale që të zhvillojnë modele të reja të biznesit dhe të lidhen dhe bashkëpunojnë më mirë me bizneset urbane. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & Alternativa do të zbatojë projekte për fshatra “të mençur” në komunat rurale të vendit, kjo si ndihmesë për fermerët për t'i promovuar produktet lokale, turizmin rural, si dhe aktivitetet kulturore rurale, gjë që do të kontribuojë në zhvillimin e sektorit të agrobiznesit, rritjen e eksportit dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Po ashtu do punojmë në krijimin e fermave eksperimentale, të cilat do të jenë në shërbim të fermerëve dhe shkollave profesionale për trajnim dhe inovacion.
- **Rishikimi i politikave të shfrytëzimit dhe menaxhimit të kullotave.** Si rezultat i keqmenaxhimit të kullotave, sipërfaqja e tyre është zvogëluar, duke ndikuar kështu edhe në dobësimin e sektorit të blegtorisë. Prandaj do të bëjmë inventarizimin e kullotave dhe do t'i rishikojmë politikat për menaxhimin e tyre, gjithë kjo me qëllim të rritjes së prodhimeve të realizuara, duke përkrahur, mes tjerash, projekte të fermave në kullota dhe prodhimin e ruajtjen e produkteve tradicionale si resurs potenciali zonës.

- **Përmirësimi i rrjeteve të ujit dhe modernizimi i sistemeve të ujitjes.** Resurset ujore janë lënë pas dore, ndërsa menaxhim i rrjeteve të ujitjes është bërë pa kriter, duke ndikuar kështu në shkatërrimin e infrastrukturës ujitëse. Ne do të fokusohemi në sanimin e infrastrukturës ekzistuese dhe zgjerimin e rrjeteve, duke përfshirë edhe thithjene fondeve të donatorëve dhe promovimin e decentralizimit në kontroll dhe menaxhim.
- **Hapja e zyrave lokale të Ministrisë së Bujqësisë në komunat rurale në lokacionet ku mungojnë** për një shërbim më të afërt me nevojat e bujqve.
- **Investimi në infrastrukturë për mbështetjen e aktiviteteve bujqësore,** që do të përfshijnë krijimin e pikave grumbulluese, depove për ruajtjen e prodhimeve dhe ngritjen e kapaciteteve përpunuese në pjesën veriperëndimore të Maqedonisë së Veriut.
- **Mbështetja financiare e programeve bujqësore në televizionet nacionale.**
- **Bursa për stimulimin e studentëve** që të studiojnë në fakultetin e bujqësisë, veterinarisë, zooteknisë, agrobiznesit dhe ushqimit.

## Infrastrukturë cilësore për të gjithë

Niveli i investimeve në infrastrukturë në Maqedoninë e Veriut ka qenë mjaft i ulët dhe diskriminues në dekadën e fundit, veçanërisht në pjesën perëndimore, duke rezultuar në një zhvillim infrastrukturor të pamjaftueshëm krahasuar me vendet e rajonit. Sipas BE-së, 39% e rrugëve në Maqedoninë e Veriut janë jashtëzakonisht të pasigurta, që është një infrastrukturë jashtëzakonisht e pabarabartë ndërmjet rajoneve, kryeqytetit dhe qyteteve tjera të vendit, si dhe mes komunave urbane dhe atyre rurale. Investimet kapitale infrastrukturore financohen kryesisht nga qeveria, ndërsa vërehet një qasje diskriminuese për zonat e banuara me shqiptarë. Ato investime, po ashtu, janë shpesh viktimë e korrupsionit institucional.

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të përqendrohet në trajtimin e problemeve kryesore në këtë fushë, si dhe në modernizimin dhe adresimin e pabarazisë në sektorët e komunikacionit, rrugëve, infrastrukturës komunale, planifikimit hapësinor, tokës ndërtimore, urbanizmit dhe energjisë. Prioritete të veçanta do të kenë rritja e konektivitetit të brendshëm dhe atij rajonal, si dhe avancimi dhe modernizimi i infrastrukturës lokale, veçanërisht sa i përket ujit të pijshëm, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza. Për këtë qëllim gjatë qeverisje katërvjeçare koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do t'i ndër marrë masat në vijim.

## Rritja e konektivitetit rrugor të brendshëm dhe rajonal

- Intensifikimi i proceseve për realizimin e projektit "Rruga e Arbërit" – Ura e Boshkut-Dibër.
- **Hapja e Terminalit doganor në Jazhincë.**
- **Një plan i ri hapësinor 2020-2040.** Plani hapësinor është dokument strategjik i miratuar nga Kuvendi që e përcakton destinimin dhe mënyrën e shfrytëzimit të hapësirës në nivel shtetëror, rajonal dhe lokal, si dhe politikat ekonomike, sociale, infrastrukturore dhe ambientale për zhvillim territorial. Plani hapësinor aktual (2002-2020) është diskriminues për zonat dhe rajonet me shumicë shqiptare, sepse i jep rëndësi primare lidhjes veri-jug me infrastrukturë të kompletuar rrugore, energjetike, telekomunikative, hekurudhore dhe ajrore, ndërsa e anashkalon tërësisht lidhjen lindje-perëndim, duke paraparë vetëm rehabilitim të infrastrukturës ekzistuese. Prandaj ne do të angazhohemi për një plan të ri hapësinor 2020-2040, që korrigjon këtë disbalancë dhe promovon zhvillim të barabartë territorial bazuar në nevojat konkrete të rajoneve planore.
- **Përfundimi i Korridorit Pan-europian VIII (autostrada Kërçovë - Strugë - Qafë Thanë).** Gjatë qeverisjes sonë do të përfundojë segmenti Trebenishte-Strugë (7 km), ndërsa gjatë periudhës së ardhshme prioritet do të ketë ndërtimi i segmentit Gostivar-Kërçovë (43 km), zgjerimi i segmentit Tetovë-Gostivar dhe ndërtimi i qarkores së Tetovës në drejtimin Shkup-Tetovë-Jazhincë.
- **Kompletimi i autostradës Shkup - Bllacë.** Gjatë qeverisjes sonë do të kompletohet ndërtimi i tërësishëm i seksionit prej 12.5 km që e ndajnë Shkupin nga kufiri me Kosovën në Bllacë.
- **Rruga Tetovë - Prizren.** Një prioritet i veçantë do të jetë përpilimi i



dokumentacionit teknik për ndërtimin e rrugës Tetovë-Prizren dhe nisja e ndërtimit të këtij segmenti të rëndësishëm rajonal, kjo në bashkëpunim me autoritetet e Kosovës.

- **Magjistranja Dibër - Bllatë.** Rruga rajonale ekzistuese do të modernizohet dhe niveli i kategorizimit të saj do të ngrihet nga një rrugë rajonale në magjistrale, me qëllim të shkurtimit të kohës së udhëtimit dhe rritjes së shkëmbimit tregtar midis Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë.
- **Rishikimi i modelit të pagesës së autostradave.** Do të bëhet një analizë e modelit aktual të pagesës së autostradës dhe do të zhvillohet një model i ri më barazitar për shfrytëzuesin dhe më i qëndrueshëm financiarisht, pasi që modeli aktual është shumë i shtrenjtë dhe nuk është aspak i përshtatshëm për qytetaret.
- **Regjistri i rrjetit rrugor komunal dhe rajonal.** Do t'i evidentojmë nevojat për ndërtimin e rrugëve të reja lokale, rajonale dhe magjistrale, si dhe për rehabilitimin e rrugëve ekzistuese. Ky regjistër i rrjetit rrugor komunal dhe rajonal do të jetë udhërrëfyes për punën e qeverisë gjatë qeverisjes së koalicionit Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA .
- **Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit hekurudhor.** Përveç elektrifikimit të rrjetit ekzistues dhe rritjes së sigurisë në komunikacionin hekurudhor, do të fillojmë ndërtimin e hekurudhës Kërçovë-Lin (Shqipëri) dhe do ta përfundojmë ndërtimin e asaj Shkup-Kriva Pallankë-Deve Bair (Bullgari).
- **Fuqizimi i kapacitetit operacional dhe administrativ të organeve të inspektimit** dhe zhvillimi i aftësive zbatuese për ta zvogëluar numrin e viktimitave përgjatë infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore.

## Avancimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale

- **Ujë të pijshëm dhe kanalizime për të gjitha vendbanimet.** Sipas raporteve të BE-së, Maqedonia e Veriut gjendet në vendin e parafundit në Europë sa i përket mbulimit të vendbanimeve me infrastrukturë themelore të ujit të pijshëm, kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të zeza. Ky problem është edhe më i theksuar në vendbanimet shqiptare. Prandaj, gjatë qeverisjes sonë 4-vjeçare, do të zhvillojmë një plan veprimi për investime në fushën e infrastrukturës komunale me fokus në ndërtimin e sistemeve për furnizim me ujë të pijshëm, kanalizim dhe stacione për trajtimin e ujërave të zeza, duke

u dhënë përparësi projekteve rajonale ndërkomunale dhe rritjes së investimit të donatorëve në këtë sektor themelor të mirëqenies njerëzore.

- **Rritja e investimeve në qendrën turistike “Kodra e Diellit” dhe teleferiku Tetovë-Kodra e Diellit.** Do të rriten investimet në këtë aset të turizmit dhe zhvillimit të rajonit të Pollogut, do të zgjidhet statusi dhe pronësia e qendrës turistike “Kodra e Diellit” dhe ajo do të rindërtohet dhe lëshohet në përdorim brenda dy viteve të para të qeverisjes sonë.



- **Transporti publik cilësor në çdo qytet.** Me përjashtim të kryeqytetit, transporti publik në qytetet kryesore të vendit është thuajse joekzistues. Qytetarët duhet të kenë mundësi të qarkullojnë drejt dhe brenda qyteteve të tyre përmes një sistemi të integruar të transportit publik. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do ta avancojë transportin publik në çdo qytet dhe drejt çdo qyteti nga zona rurale, me qëllim të zvogëlimin të numrit të automjeteve në trafik.
- **Ndryshimi i Ligjit për trajtimin e objekteve pa leje ndërtimi (ligji për legalizim).** Legalizimi i objekteve nën ligjin aktual ka krijuar një kaos urbanistik dhe ka shkaktuar dëme të pariparueshme në planifikim hapësinor dhe në financat komunale, duke reflektuar negativisht edhe në zhvillimin e komunave. Ne do ta rishikojmë kornizën përkatëse legjislative, në veçanti Ligjin për legalizim, me qëllim të sanimit të gjendjes së krijuar nga sistemi aktual i bazuar në klientelizëm dhe anarki.

## Një energji e ripërtëritshme dhe përbalueshme për qytetarin

Modeli energjetik i vendit është i paqëndrueshëm nga perspektiva ekonomike, sociale e mjedisore. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të përqendrohet në diversifikimin e burimeve energjetike, kjo bazuar në kapacitetet e jashtëzakonshme të vendit për energji diellore, ujore dhe energji të erës, si dhe në qasjen universale në energji të përbalueshme për të gjithë, duke i ndërmarrë masat në vijim.

- **Rritja e kapaciteteve prodhuese nga burime të ripërtëritshme, me theks të veçantë në burimet energjetike nga dielli dhe era.** Do ta rishikojmë strategjinë dhe politikat e energjisë, me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve të reja termo-energjetike me kosto të përbalueshme dhe padëme për mjedisin jetësor. Prandaj do të investohet në diversifikimin e burimeve të energjisë dhe në masat e efikasitetit të energjisë brenda një kornize institucionale të pavarur, që do të sigurojë se këto investime e rrisin cilësinë e shërbimit të produkteve energjetike. Gjithashtu, do të ndërmerren masa nxitëse dhe asistencë për prodhuesit individualë që të mund të instalojnë kapacitete të vogla të prodhimit të energjisë nëpër shtëpitë e tyre dhe ta plasojnë energjinë e tyre në rrjet me çmim të garantuar.
- **Liberalizimi dhe decentralizimi i tregut energjetik si garantues i qasjes në energji.** Do të ndërmerren masa për ta integruar dhe liberalizuar edhe më tej tregun energjetik për t'u mundësuar konsumatorëve liri të plotë në zgjedhjen e operatorit të tyre dhe transparencë të plotë në koston finale të energjisë së konsumuar. Po ashtu do të inkurajohen prodhuesit e vegjël dhe do të garantohet çmimi blerës, ndërkohë që qeverisja jonë do t'i rishikojë politikat e masivizimit të prodhimit dhe të vetë-konsumit të vogël, kjo me qëllim të uljes së kërkesës së përgjithshme për energji.
- **Vazhdimi i gazifikimit të vendbanimeve në drejtim të Dibrës, Kërçovës dhe Strugës dhe krijimi i rrjetit sekondar për gaz natyror.** Do të angazhohemi për vazhdimin e punimeve për vendosjen e linjës së gazifikimit në pjesën veri-perëndimore të vendit, gjë që do të ndikojë pozitivisht në buxhetin e qytetarëve, uljen e ndotjes së mjedisit jetësor dhe në zhvillimin ekonomik lokal.
- **Përpilimi i hartës së pasurive natyrore të mineraleve.**
- **Transparenca në prokurimet publike gjatë ndarjes së koncesioneve për eksploatim të mineraleve.**

- **Institucionet arsimore (shkollat, universitetet, çerdhet) dhe objektet fetare do të hiqen nga trajtimi si objekte afariste,** që është shumë e rëndësishme në këndvështrimin e furnizimit me energji elektrike dhe tarifa që zbatohen për këtë kategori.



## E-Qeverisja

Administrata shtetërore është strukturë bazike e sektorit publik, e cila i pasqyron vlerat e vendit dhe nga e cila varen proceset demokratike dhe zhvillimore të shtetit. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të punojë për reformimin e saj, për përmirësimin e proceseve administrative dhe ngritjen e vlerave, gjithë kjo me qëllim të zhvillimit social dhe ekonomik në vend, gjithnjë të vetëdijshëm se reformat në administratën publike janë një proces i vazhdueshëm që kërkon riorganizim institucional në gjithë sektorin publik dhe përmirësimin e aftësive administrative me qëllim të krijimit të një strukture moderne organizative.

Deri tani Maqedonia e Veriut, me kërkesë të BE-së, i ka miratuar tri strategji për reforma në administratën publike: strategjia e parë është miratuar në vitin 1999, e dyta në vitin 2010 dhe e treta në vitin 2018. Secila prej tyre ka dhënë kontribut në përmirësimin e proceseve administrative, por – për fat të keq – cilësia e shërbimeve administrative për qytetarët dhe bizneset është e pamjaftueshme. Si rrjedhojë, në çdo raport të KE-së kërkohen qartë reforma të mëtutjeshme të administratës publike të vendit.

Digjitalizimi i administratës publike dhe i shërbimeve që ofrohen nga institucionet shtetërore do ta përmirësojë dukshëm cilësinë e shërbimeve. Shërbimet që mbështeten në teknologjitë moderne janë më të shpejta, më efikente dhe më të qasshme. Digjitalizimi, gjithashtu, e përmirëson efikasitetin e menaxhimit të institucioneve dhe ofron shërbime më cilësore, sipër qytetarët, ashtu dhe përkomitetin e biznesit.

Qeverisja elektronike ose e-qeverisja, përveç se ndihmon në efikasitet, ajo i ulë edhe kostot, duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK). Përvojat e ndryshme ndërkombëtare dëshmojnë se në vendet ku qeveritë kanë zbatuar e-qeverisje aty është ulur dukshëm edhe niveli i korrupsionit përmes rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, duke kontribuar gjithashtu edhe në forcimin e qeverisjes së mirë.

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të angazhohet fuqishëm për krijimin e një infrastrukture të integruar për e-qeverisje nëkatër shtyllat kryesore të saj: nga qeveria te qytetarët (government-to-citizen, G2C), nga qeveria te bizneset (government-to-business, G2B), nga qeveria te punonjësit (government-to-employee, G2E) dhe nga qeveria te qeveria (government-to-government, G2G). Kjo platformë do të jetë e lehtë për menaxhueshme dhe për shfrytëzim, si nga ana e qytetarëve dhe ndërmarrjeve, ashtu edhe nga ana e institucioneve shtetërore.

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA beson se kjo qasje do të ndihmojë në afrimin e shërbimeve deri te qytetarët dhe do të jetë një mjet efektiv në luftën kundër korrupsionit, duke ofruar më shumë transparencë, informacion të hapur dhe rritje të llogaridhënies. Më konkretisht, gjatë qeverisjes sonë do të angazhohemi për zbatimin e masave në vijim:

- **Portali “Regjistri elektronik”.** Regjistri elektronik amë ekzistues është një bazë e mirë që ofron aplikim online për certifikata të gjendjes civile (lindje, martesë, vdekje etj.), por gjithë procesi për aplikim është shumë pak i qasshëm për përdoruesin dhe, si rezultat i kësaj, ai përdoret shumë pak nga qytetarët dhe bizneset në vend. Po ashtu sistemi është vetëm në gjuhën maqedonase. Shpenzimet për marrje të një certifikatë elektronike sot paguhet me tarifa të njëjta si procesi tradicional, andaj qytetarët nuk stimulohen për ta përdorur atë. **Në 100 ditët e para** të qeverisjes sonë do të modernizohet regjistri elektronik dhe ai do të bëhet edhe në gjuhën shqipe. Shërbimi online do të jetë pa pagesë për t'i stimuluar kështu qytetarët që të bëjnë aplikime online. Në këtë mënyrë do të ulen numri i qytetarëve që presin radhë në sportele për dokumente dhe punonjësit administrativë do të jenë më të lirë për të kryer punë të tjera. Në portal do të kenë qasje edhe institucionet shtetërore me autorizim nga personi të cilit i referohet dokumenti ose konfirmim me urdhër të gjykatës që e justifikon kërkesën për një dokument.
- **Portali “e-konsultime”.** Zhvillimi i shoqërisë civile është një nga shtyllat themelore të demokracive moderne, që realizohet – mes tjerash –përmes

dialogut të hapur, bashkëpunimit dhe partneritetit midis qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, publikut në përgjithësi dhe institucioneve publike dhe shtetërore. Ne do të miratojmë një strategji dhe plan veprimi për qeverisje të hapur, përfshirë adaptimin e kornizës normative dhe ligjore për debat publik dhe konsultim me publikun, e cila do të harmonizohet me Ligjin për të Drejtën e Qasjes në Informacion.

- **Edukimi digjital (“digital citizenship”).** Qytetarët e Maqedonisë së Veriut janë shumë pak janë të informuar për proceset digjitale dhe digjitalizimin, si dhe avantazhet dhe disavantazhet që i sjell digjitalizimi në shoqëri, veçanërisht moshat e mesme dhe ato më të larta. **Në 100 ditët e para** të qeverisjes sonë do të krijojmë një platformë online për edukimin e qytetarëve rreth digjitalizimit, kjo në përputhshmëri me modelin e Këshillit të Europës për zhvillimin e kompetencave digjitale. Po ashtu do të përkthehen materialet nga baza e BE-së, Agjenda Digjitale 2020 dhe do të trajnohen shërbyesit civilë dhe mësimdhënësit e të gjitha niveleve arsimore.
- **Ueb-portali informues, interaktiv dhe transaksional për mërgatën.** Do të krijohet një portal për lehtësimin e procedurave administrative për mërgatën, i cili do të sigurojë qasje në informata rreth procedurave të ndryshme administrative në vend, përfshirë informata për institucionet dhe agjencitë shtetërore, për punën e tyre dhe shërbimet që ato i ofrojnë, për aktet ligjore rregullative, sidhe për procese tjera në interes të qytetarëve. Interaktiviteti i portalit do të mundësojë gjenerimin e kërkesave për informata ose dokumente personale në institucionet shtetërore. Qytetarët do të kenë, gjithashtu, mundësi për të paguar taksat dhe tarifat shtetërore, gjobot dhe shërbimet komunale.
- **Qendrat për inkuadrim nga distanca.** Do të ngrihen zyra me infrastrukturë të nevojshme për inkuadrim nga distanca që do të përdoren për mbledhje të qeverisë (kur të ketë nevojë), për konsultime me organet shtetërore, për trajnime, prezantime ose edhe për inkuadrimin e mërgimtarëve në proceset politike në vend.
- **Digjitalizimi i trashëgimisë kulturore.** Deri më tani nuk ekziston një sistem qendror për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore në vend. Prandaj do të ngritet një sistem i tillë me qëllim të krijimit të kushteve për popullarizimin e kulturës dhe vlerave tradicionale, si në vend, ashtu edhe jashtë vendit. Kjo do të mundësojë krijimin e kanaleve komunikative të qëndrueshme kulturore dhe arsimore me mërgimtarët. Digjitalizimi do të ndihmojë që këto kontakte të bëhen reale dhe lehtë të zbatueshme.
- **Studio qendrore 3D.** Nuk ka informata për printera 3D në institucionet

arsimore të vendit. Me ngritjen e një zyre qendrore “Studio 3D” do të mund të printohen forma tredimensionale për nevoja të silabuseve dhe lëndëve në shkollat fillore dhe të mesme, si dhe në fakultete. Skaneri3D do të mundësojë skenimin e artefakteve me vlera kulturore dhe krijimin e bazës (muze elektronik) për nevojat e institucioneve arsimore.



- **Krijimi i qendrave për inovacion (“Innovation Hubs”) në çdo qytet.** Këto qendra do të themelohen në partneritet publiko-privat dhe do të shërbejnë si trampolina për ide dhe inovacione të reja, duke ndihmuar kështu shoqërinë dhe ekonominë që të përballet me sfidat e ardhshme dhe aspiratat e të rinjve.
- **Krijimi i Parkut Teknologjik Shtetëror.** Koalicioni Aleanca për Shqiptaret & AlternAtivA do të angazhohen për përshejtimin e proceseve për krijimin e parkut teknologjik shtetëror, i cili do të përmirësojë dukshëm ekosistemin për inovacion dhe kërkime shkencore aplikative.
- **Databaza e ekspertëve në mërgatë.** Sot kemi një numër shumë të madh të mërgimtarëve që japin kontribut intelektual në botë. Për këtë qëllim në 100 ditët e para të qeverisjes sonë do të krijohet një databazë centralizuar në Ministrinë e Shoqërisë Informativë dhe Administratës, e cila do të mundësojë angazhimin e tyre në proceset zhvillimore në vend. Për çdo projekt, i cili do të kërkojë ekspertizë, shteti do të bëjë thirrje për shprehje të interesimit dhe Ministria do të detyrohet t’i informojë të gjithë anëtarët e regjistruar në databazë për thirrjen publike.
- **Biblioteka Digjitale Shqiptare.** Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA do të angazhohet për formimin e një biblioteke shqiptare online, e cila do të ofrojë shërbime të reja dhe të përditësuara, duke mundësuar kërkim të kryqëzuar në katalogun e bibliotekave kombëtare dhe ndërkombëtare, me

theks të veçantë bibliotekat e Kosovës dhe Shqipërisë. Kjo bibliotekë online do të mundësojë shkëmbim informacionesh për bibliotekat, do ta lehtësojë qasjen në botime dhe do të përmirësojë dukshëm cilësinë e arsimit në përgjithësi.

- **Digjitalizimi i përfaqësive diplomatike dhe konsullore.** Caktimi i terminëve do të bëhet përmes një kalendari elektronik për të shmangur kështu pritjet dhe radhët e gjata. Në këtë mënyrë do të rritet komunikimi, transparenca dhe azhurnimi i ueb-faqeve të përfaqësive diplomatike dhe konsullore, të cilat gjithashtu do të standardizohen.
- **Një platformë unike online për njësitë e vetëqeverisjes lokale.** Kjo platformë do të përfshijë edhe ndërmarrjet publike përkatëse, sidomos ujësjellësin dhe kanalizimet, me çka do të garantohet shfrytëzimi i të gjitha shërbimeve elektronike (informacione, kërkesa, parashtresa, ankesa, denoncime, leje, pagesa elektronike të taksave dhe tatime lokale).



## PËR SHTET TË INTEGRUAR NË RAJON, EUROPË DHE BOTË

Si parti decidivisht pro-europiane, Aleanca për Shqiptarët dhe AlternAtivA besojnë se integrimi i Maqedonisë së Veriut në Bashkimin European (BE) është AlternAtivA e vetme për të ardhmen e vendit dhe garanci për paqe, siguri, stabilitet, integrim të brendshëm të vendit, adresim të sfidave strukturore, siç është shteti i së drejtës, përmirësim të qeverisjes ekonomike, rritje të konkurrencës dhe të kapitalit njerëzor, përmirësim të mjedisit biznesor dhe të klimës së investimeve, rritje të qëndrueshme ekonomike dhe krijim të vendeve të punës.

Integrimi european duhet të jetë objektiv kryesor i politikës së jashtme të vendit. Politika e jashtme do të bazohet në parimet e paqes, marrëdhënieve të mira fqinjësore, rritjen e bashkëpunimit rajonal, multilateralizmin aktiv dhe respektimin e plotë të së drejtës ndërkombëtare.

Maqedonia e Veriut, së bashku me Kroacinë, dikur ishte vend lider në integriminevropian. Siç e dimë, në prill të vitit 2001 asaj iu dha privilegji nga BE-ja që të bëhet shteti i parë në Ballkanin Perëndimor, i cili nënshkroi marrëveshje për stabilizim dhe asocim, kjo si një stimulim për të lëvizur nga politika e vjetër shoviniste, e cila e kishte çuar vendin drejt një konflikti të armatosur. Maqedonia e Veriut e dorëzoi kërkesën e saj për anëtarësim në BE në vitin 2004, por shumë shpejt ajo u shndërrua në nxënësin e keq të politikave euro-atlantike, duke dështuar në hapjen e negociatave për anëtarësim në BE për një dekadë e gjysmë, pavarësisht se zyrtarisht ishte vend kandidat për anëtarësim që nga viti 2005 me dhjetë rekomandime pozitive për hapje të negociatave nga Komisioni European, si dhe duke ngecur me anëtarësimin në NATO për më shumë se një dekadë. Ndërkohë fqinjët kanë lëvizur me hapa të përshpejtuar.

TË INTEGRUAR  
NË EUROPE  
DHE BOTË

Kroacia u bë anëtare e plotë e NATO-s në vitin 2009 dhe e BE-së në vitin 2013, Shqipëria u bë anëtare e NATO-s në vitin 2009, ndërsa Mali i Zi dhe Serbia, të cilat kanë nënshkruar marrëveshje për stabilizim dhe asocim gjashtë vjet pas Maqedonisë së Veriut, i kanë filluar negociatat për anëtarësim në BE në vitin 2012, respektivisht më 2013. Mali i Zi u bë anëtar i Aleancës Veri-Atlantike më 2017.

Arsyet për këtë vendnumërim tashmë janë të njohura. Së pari, vazhdimi i politikës shoviniste, si jashtë ashtu edhe brenda vendit, e ka penguar përparimin në bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, gjë që ka ndikuar te vendet anëtare të BE-së dhe NATO-s për t'i bllokuar proceset integruese të vendit. Kjo pengesë është tejkaluar pjesërisht pas rënies së regjimit VMRO-BDI dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës me Greqinë, si dhe të Marrëveshjes së Miqësisë me Bullgarinë. Megjithatë, nuk mund të përjashtohen mosmarrëveshjet e ardhshme në lidhje me zbatimin e këtyre traktateve, gjë që do të ndikonte negativisht edhe në procesin e anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në BE, duke pasur parasysh të drejtën e vetos të shteteve anëtare të BE-së. Së dyti, ndoshta më e rëndësishmja, rruga e integritit të Maqedonisë së Veriut në BE është bllokuar nga vetë qeveritë e njëpasnjëshme të vendit, të cilat e kanë instaluar kapjen e shtetit dhe kanë zbatuar politika thellësisht të korruptuara për gati dy dekada, e të cilat mbizotërojnë edhe në ditët e sotme, siç është konfirmuar nga raportet e njëpasnjëshme të progresit të BE-së, si

dhe nga refuzimi i Këshillit European të qershorit 2018 dhe të tetorit 2019 për të hapur negociatat për anëtarësim me Maqedoninë e Veriut.

Politika e jashtme dhe agenda e integritimeve euro-atlantike, në fakt, janë manipuluar nga politikanë autoritarë dhe të korruptuar të qeverive të kaluara dhe të asaj aktuale për ta legjitimuar veten, për ta betonuar fuqinë e tyre dhe për ta kontrolluar shoqërinë dhe ekonominë në favor të tyre, duke i vënë interesat e tyre të personale dhe klanore mbi ato të qytetarëve. Kjo dëshmohet më së miri nga lënia në harresë e mërgatës, mungesa e investimeve në kapacitetet administrative për integrim në BE, që rezulton me një kapacitet të vogël absorbues të fondeve të BE-së, si dhe për shkak të një politike të jashtme që jo rrallë është në kundërshtim me synimet strategjike të BE-së.

Logjikisht, megjithëse procesi i integritit european ka qenë një burim i rëndësishëm i stabilitetit nga jashtë, ai deri më tani ka dështuar tërësisht në materializimin e narracionit thelbësor të europianizimit brenda – një transformim shoqëror, politik dhe ekonomik i nxitur nga perspektiva e anëtarësimit në BE.

Pas miratimit të strategjisë së re nga BE-ja për "Një perspektivë të besueshme për zgjerimin dhe përforcimin e angazhimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor" (2018) dhe me modernizimin e politikës së zgjerimit nën udhëheqjen franceze, të cilat kanë vendosur një fokus të ri në mbështetjen e reformave themelore dhe të pakthyeshme, si dhe në marrëdhëniet e mira fqinjësore, koalicioni Aleanca

për Shqiptarët & AlternAtivA është i bindur se e ardhmja europiane e Maqedonisë së Veriut varet më shumë se kurrë nga rezultatet dhe të arriturat konkrete të vendit tonë. Rreziku, natyrisht, është se politikanë të korruptuar, të cilët kanë fare pak interes për anëtarësimin e vendit në BE, dhe që e kanë manipuluar këtë proces për ta ndërtuar legjitimitetin e tyre dhe për ta konsoliduar fuqinë personale dhe klanore, do të punojnë kundër çdo ndryshimi politik që do ta kërcënonte modelin e reformave kozmetike, i cili u ka mundësuar që ta kapin shtetin në emër të integritit evropian, ndërsa i kanë siguruar favoret e Brukselit si faktorë stabiliteti.

Kjo situatë kërkon që të gjitha forcat progresive dhe të gjithë qytetarët të angazhohen në ndërtimin e konsensusit të brendshëm dhe vullnetit politik për t'i adresuar nevojat urgjente të transformimit të vendit. Europianizimi i Maqedonisë së Veriut nuk është proces i reformave teknike në letër. Europianizimi nënkupton transformim radikal demokratik, pa të cilin perspektiva e anëtarësimit do të mbetet vetëm një objektiv i largët dhe i paarrtshëm. Për më tepër, projekti i integritit të Maqedonisë së Veriut në BE duhet të pasqyrohet patjetër në standardin e jetesës së qytetarëve, në ndërtimin dhe afirmimin e vlerave shoqërore evropiane, si dhe në funksionimin e institucioneve shtetërore. Përndryshe, nëse kjo nuk ndodhë, procesi i integritit rrezikon të sjellë zhgënjim dhe rënie të mbështetjes së qytetarëve për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Bashkimin European. Ky transformim demokratik, me qytetarët dhe për qytetarët, është garancia vetmja për një jetë më të mirë për të gjithë, për zhvillim të qëndrueshëm, për shtet të së drejtës, për demokraci dhe stabilitet afatgjatë.

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA angazhohet që Maqedonia e Veriut të udhëheqë një politikë pro-europiane në proceset globale dhe ta forcojë pozitën e saj në NATO, BE, në bashkëpunimet rajonale, në mbështetjen e Republikës së Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran, si dhe në integritimin e mërgatës në shtet.

**Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA angazhohet për hapje të negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në BE që në vitin e parë të qeverisë së saj dhe për përmbylljen e negociatave deri në vitin 2025, kur vendi do të bëhet anëtar i plotë i Bashkimit European.**

Gjatë qeverisjes sonë, Maqedonia e Veriut **do ta promovojë integritimin në paketë të 6 shteteve të Ballkanit Perëndimor**, siç ka qenë praktikë në shumicën e zgjerimeve të deritanishme, kjo si garanci për bashkëpunim të mirëfilltë rajonal kundër bllokadave dhe vetove eventuale të ndonjë vendi ndaj të tjerëve dhe bazuar në rrethanat gjeopolitike, kontestet e kundërthëniet historike, si dhe interesat ekonomike e sociale që e ndjekin rajonin nga e kaluara. Më konkretisht, koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternAtivA zotohet për masat në vijim:



## Komunikimi strategjik rreth përfitimeve dhe detyrimeve të anëtarësimit

- Në 100 ditët e para të qeverisjes sonë Sekretariati për Çështje Europiane do të iniciojë një fushatë informimi dyvjeçare për ta adresuar dezinformimin (shpeshherë të përhapur nga vetë qeveria në ikje – për shembull, gjatë fushatës për referendumin mbi Marrëveshjen e Prespës) dhe për të shpjeguar se si duhet të përkthehet procesi i europianizimit në politikat qeveritare dhe promovimin e vlerave dhe praktikave të BE-së.

## Një plan veprimi për ta përsheptuar integrimin evropian

- Në 100 ditët e para të qeverisjes sonë Sekretariati për Çështje Europiane do të përgatisë një plan veprimi për t'iu përgjigjur kërkesave të mbetura të Këshillit Europian të qershorit 2018, për ta rishikuar kornizën institucionale integruese, me theks të veçantë në grupet punuese për anëtarësim, si dhe për të ngritur kapacitetet institucionale e për ta përmirësuar mbikëqyrjen e Qeverisë nga ana e Kuvendit dhe koordinimin midis pushteteve. Në këtë drejtim prioritetet themelore të koalicionit Aleanca për Shqiptarët & AlternativA do të jenë përmirësimi i mbikëqyrjes së Qeverisë nga ana e Kuvendit dhe koordinimi permanent midis dy pushteteve, ngritja e kapaciteteve administrative të institucioneve për harmonizim të legjisllacionit vendor me legjisllacionin evropian, të njohur si “acquis communautaire”, si dhe transparencë plotë e negociatave për të mundësuar mbikëqyrje të procesit nga shoqëria civile e qytetarët, si dhe llogaridhënia nga qeveria.

## Integrimi evropian në mbështetje të zhvillimit socio-ekonomik dhe territorial barazitar

- Në vitin 2020 Qeveria do të sigurojë fokusim më të madh të mbështetjes nga Instrumenti për Asistencë të Para-anëtarësimit (IPA) III 2021-2027 dhe

programete tjera të BE-së në zhvillimin socio-ekonomik, duke përfshirë zhvillimin e barabartë territorial dhe rajonal, kjo në përputhje me prioritetet e Fondit Europian për Zhvillim Rajonal, Fondit për Kohezion, Fondit Social Europian Plus dhe Fondin Bujqësor Europian për Zhvillim Rural. Ngritja e kapaciteteve administrative për të siguruar absorbim të plotë të fondeve nga IPA III dhe Programi i Para-anëtarësimit për Zhvillim Rural (IPARD II) do të jetë ndër prioritetet kryesore në këtë rrafsh.

- Në vitin 2020 Qeveria do të përgatisë një plan veprimi për pjesëmarrje më të madhe dhe më të barabartë të vendit në iniciativat dhe programet tjera europiane, duke përfshirë Kornizën Investuese për Ballkanin Perëndimor (WBIF), Programin për Bashkëpunim Ndërkufitar (CBC), si dhe programet tjera europiane në fushën e transportit dhe lidhjeve, energjisë, arsimit dhe aftësisë profesionale, punësimit dhe reformave sociale, por edhe ato që kanë të bëjnë me hulumtimin shkencor dhe zhvillimor. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternativA do të angazhohet gjithashtu për ngritjen e një zyre permanente pranë Sekretariatit për Çështje Europiane për trajnim të vazhdueshëm të kuadrit të komunave dhe agjencive shtetërore dhe rajonale për thithjen e fondeve europiane

## Marrëdhënie të mira fqinjësore dhe bashkëpunim rajonal

- Në 100 ditët e para të qeverisjes sonë Qeveria do t'iu kërkojë vendeve të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) përfshirjen e tyre në mekanizmat ndërqeveritare për zbatimin e Marrëveshjes së Prespës dhe të Marrëveshjes së Miqësisë me Bullgarinë për të shmangur tensionet e mundshme dhe për të ndihmuar në adresimin e implikimeve të tyre të brendshme për marrëdhëniet ndëretnike.
- Në vitin 2020 Qeveria do të fillojë një bashkëpunim strategjik të Maqedonisë së Veriut me Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë, veçanërisht në fushën e integriteteve europiane, drejtësisë, sigurisë dhe mbrojtjes, diplomacisë, ekonomisë, arsimit, artit dhe kulturës, gjuhës, lirisë së lëvizjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Një kujdes i veçantë do t'iu kushtohet fuqizimit të Republikës së Kosovës si shtet sovran dhe i barabartë në të gjitha proceset rajonale ku merr pjesë Maqedonia e Veriut. Ky bashkëpunim strategjik, i bazuar në praktikën evropiane, siç janë Beneluxi, strukturat e bashkëpunimit midis vendeve skandinave dhe atyre baltike ose Grupi i Vishegradit, do të

mundësojë që qytetarët e këtyre vendeve të fillojnë t'i shohin perspektivat progresive të bashkëpunimit fqinjësor, gjë që do të kontribuojë në uljen e tensioneve politike dhe etnike nga e kaluara.

## Një politikë të jashtme pro-europiane

- **Ministria e Punëve të Jashtme do të sigurojë përputhshmëri të plotë me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së** në të gjitha fushat, veçanërisht në lidhje me sanksionet e BE-së, luftën kundër terrorizmit, sulmet kibernetike, ruajtjen e kufijve të përbashkët dhe migrimin. Harmonizimi i politikës së jashtme të vendit me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe proceset e tjera multilaterale dhe rajonale është kriter i anëtarësimit në BE. Megjithatë, sipas Raportit të Progresit 2019, ky harmonizim nuk është i plotë dhe, madje, sipas Komisionit Europian, Maqedonia e Veriut ka refuzuar ta harmonizojë qëndrimin e saj me deklaratat dhe vendimet e BE-së në 13 raste nga gjithsej 87 kur i është kërkuar ose në 14% të rasteve, në veçanti në lidhje me sanksionet europiane kundër Rusisë për agresionin në Ukrainë. Orientimi strategjik i vendit nuk guxon të vihet në mëdyshje në proceset globale dhe rajonale.

## Një politikë e jashtme në funksion të integritetit të mërgatës në shtet

**Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i shqiptarëve në rrjetin diplomatik** do të arrihet duke siguruar përputhje të strukturës etnike të misioneve diplomatike me atë të mërgatës në vendet pranuese, si në aspektin e përfaqësimit politiko-diplomatik, ashtu edhe në atë të personelit administrativ, ndër të tjera, në funksion të kujdesit për nevojat e mërgimtarëve dhe garantimit komunikimit zyrtar në gjuhën shqipe në të gjitha nivelet me ambasadat dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme.

- **Personalitete të veçanta nga jeta publike dhe sipërmarrësve të mërgatës do të emërohen në pozitën e Konsullit të Nderit** në vendet përkatëse, për të ndikuar kështu në përmirësimin e imazhit të vendit dhe komunikimit gjithëpërfshirës të mërgatës sonë me shtetet përkatëse.

- **Koalicioni Aleanca për Shqiptarët & AlternativA do të promovojë, gjithashtu, krijimin e përfaqësive të përbashkëta diplomatike me Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë** në territoret ku kjo kontribuon në shtrirjen e ndikimit diplomatik, pastaj për fuqizimin e Kosovës si shtet sovran, por edhe për kujdesin ndaj mërgimtarëve.



## Shteti që prodhon paqe dhe siguri

- **Maqedonia e Veriut, si shtet anëtar i NATO-s, do ta respektojë udhëzimin për të shpenzuar 2% të Prodhimit Bruto Vendor në kapacitetet mbrojtëse** dhe do të angazhohet pa ekuivokë për forcimin e shtyllës së Sigurisë, Paqes dhe Bashkëpunimit, sigurisht duke e rritur kontributin në misionet dhe operacionet paqeruajtëse të BE-së në botë dhe duke e forcuar rolin e saj në strukturat rajonale të sigurisë.
- **Një kujdes i veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit rajonal me shtetet e tjera të NATO-s dhe me Republikën e Kosovës** në rrafshin e mobilitetit akademik dhe atë të stërvitjeve të përbashkëta.
- **Ministria e Mbrojtjes dhe Armata do të reformohet dhe racionalizohet**, kjo sipas rekomandimit të NATO-s për 650–700 të punësuar në administratë dhe 6,800 trupa, duke u kujdesur gjithashtu edhe për arritjen e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat.



## SHTET PËR TË GJITHË

PROGRAMI ZGJEDHOR 2020-2024

I KOALICIONIT ALEANCA PËR SHQIPTARËT & ALTERNATIVA

QERSHOR 2020

# Tash

*ēshtë Koha!*

[www.tasheshtekoha.com](http://www.tasheshtekoha.com)